



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 550 Akti

Nr. 664 Vendimi  
Tiranë, më 24.5.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 22.5.2023, mori në shqyrtim, mbi bazën e dokumenteve të administruara, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Petrit Hysa**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Petrit Hysa

në seancë dëgjimore dhe, pasi shqyrtoi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Petrit Hysa, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 3 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Z. Petrit Hysa, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Alma Faskaj dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar<sup>1</sup> (në vijim DSIK), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016; nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 15.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Alma Faskaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 2.7.2020, përmes postës elektronike<sup>2</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, gjithashtu, i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Më tej, trupi gjykues i zgjedhur me short në mbledhjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 17.2.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së komisioneres Suela Zhegu për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2023. Anëtari zëvendësues i trupit gjykues është z. Olsi Komici, i zgjedhur me short me vendimin e Komisionit, datë 15.6.2020. Subjekti u njoftua përmes postës elektronike<sup>3</sup> lidhur me

---

<sup>1</sup> Aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

<sup>2</sup> Email datë 2.7.2020, ora 10:48, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

<sup>3</sup> Email datë 23.3.2023, ora 10:51, “Njoftim mbi zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues dhe kërkesë për deklarim konflikti interesi”.

këtë zëvendësim, duke deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarin e ri të trupit gjykues<sup>4</sup>.

**7.** Trupi gjykues, me vendimin datë 13.4.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Petrit Hysa, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, mbi të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe, po në të njëjtën datë, më 14.4.2023, përmes postës elektronike<sup>5</sup> i njoftoi subjektin e rivlerësimit vendimin mbi përfundimin e hetimit paraprak.

**8.** Subjekti i rivlerësimit u ftua të paraqesë prova dhe shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit brenda datës 27.4.2023. Në datën 18.4.2023, subjekti i rivlerësimit për arsye shëndetësore kërkoi zgjatjen e këtij afati në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht administrativ deri më 20.5.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni vendosi të zgjasë afatin deri në datën 10.5.2023.

**9.** Në datën 10.5.2023, subjekti i rivlerësimit paraqiti me anë të postës elektronike<sup>6</sup> shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht dhe, njëkohësisht, paraqiti këto shpjegime dhe prova në zyrën e protokollit pranë Komisionit, administruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2023.

**10.** Bashkë me prapësimet me shkrim, subjekti i rivlerësimit kërkoi të pyeten si dëshmitarë shtetasit Xh. C., L. C. dhe Sh. D., me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ. Trupi gjykues ka refuzuar kërkesën e subjektit për thirrjen e këtyre dëshmitarëve, pasi ajo nuk plotëson kushtet e një kërkesë të mirëfilltë procedurale dhe se marrja e këtyre provave është e panevojshme për vendimmarrjen, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, për aq kohë sa dëgjimi i tyre nuk do të paraqesë asnjë të dhënë të re për procesin e rivlerësimit, pasi këta shtetas kanë shprehur vullnetin e tyre nëpërmjet deklaratave noteriale të administruara gjatë hetimit. Nën dritën e zbatueshmërisë së parimit të mbrojtjes efektive, për sa i përket të drejtës për të thirrur dëshmitarë dhe pranueshmërisë së dëshmive, në rastin konkret, trupi gjykues arrin në përfundimin se dëshmia e personave të kërkuar për t'u thirrur si dëshmitarë nuk kishte asnjë relevancë në marrjen e vendimit dhe, për rrjedhojë, nuk ka shkelje të parimeve të procesit të rregullt, për sa i përket refuzimit të marrjes së provës me dëshmitarë.

**11.** Më tej, në lidhje me kërkesën e subjektit për riçeljen e hetimit administrativ për çdo barrë prove të kërkuar nga ana e Komisionit, subjekti i rivlerësimit u informua se provat, shpjegimet dhe

---

<sup>4</sup> Email datë 23.3.2023, ora 14:29.

<sup>5</sup> Email datë 14.4.2023, ora 10:43, “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit”.

<sup>6</sup> Email datë 10.5.2023, ora 13:50 dhe 14:15.

deklarimet në seancë dëgjimore do të vlerësohen nga trupi gjykues para marrjes së vendimit përfundimtar lidhur me procesin e rivlerësimit.

**12.** Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike<sup>7</sup> se trupi gjykues, me vendimin e datës 17.5.2023, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 19.5.2023, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

**13.** Më anë të postës elektronike<sup>8</sup>, subjekti kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për arsye shëndetësore. Në këto kushte, Komisioni caktoi seancën dëgjimore në datën 22.5.2023, ora 10:00 dhe njoftoi subjektin përmes postës elektronike<sup>9</sup>.

**14.** Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Hysa, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**15.** Në datën 22.5.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqiti personalisht në seancë.

**16.** Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

**17.** Subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

**18.** Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Hysa, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

**19.** Seanca dëgjimore e datës 22.5.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 24.5.2023, ora 09:45, për shpalljen e vendimit.

**20.** Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 22.5.2023, subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

---

<sup>7</sup> Email datë 17.5.2023, ora 10:00, "Përgjigje kërkesave dhe ftesë për seancë dëgjimore në kuadër të procesit tuaj të rivlerësimit".

<sup>8</sup> Email datë 17.5.2023, ora 14:41.

<sup>9</sup> Email datë 18.5.2023, ora 14:29, "Ftesë nga Komisioni – seanca dëgjimore për procesin tuaj të rivlerësimit".

**21.** Subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

**22.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**23.** Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

**24.** Referuar vendimit nr. 2/201710 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**25.** ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Petrit Hysa, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

---

<sup>10</sup> Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

**26.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

## **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**27.** Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë: (i) shtetasi K. D. (kunati/vëllai i bashkëshortes së subjektit), si rezultat i dhënies së huas në vlerën 27.000 euro; (ii) shtetasi L. C. (mik i subjektit) – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i dhënies së huas në vlerën 14.000 euro; (iii) shtetasit M. e Xh. C. (motra dhe kunati i subjektit) – konsiderohen persona të tjerë të lidhur si rezultat i investimit në dy kate në pronën e subjektit.

**28.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI dhe në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**29.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**30. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit si vijon:**

### **1. Godinë banimi 3 kate + 1 kat nën tokë, e ndodhur në \*\*\*, Tiranë**

**1.1.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar godinë banimi 3 kate + 1 kat nën tokë, me sipërfaqe ndërtimi 114.4 m<sup>2</sup>, sipërfaqe totale ndërtimi për banim 447.1 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe totale të truallit 405 m<sup>2</sup>, me adresë Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*, \*\*\*, Tiranë, legalizuar me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 22.9.2015, certifikatë vërtetim pronësie nr. \*\*\*.

Vlera e katit përdhe dhe atij nën tokë - 1.786.230 lekë. Vlera e katit të dytë dhe të tretë (papafingo) karabina 1.613.280 lekë. Pjesa takuese: kati i parë dhe bodrumi në pronësinë e subjektit dhe të familjarëve të tij, sipas certifikatës së gjendjes familjare. Kati i dytë dhe i tretë – investim i motrës M. C. (H.) dhe bashkëshortit të saj Xh. C.

**1.2.** Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar: (i) kati nën tokë dhe kati përdhe<sup>11</sup>, ndërtuar prej tij me të ardhurat nga puna si avokat (profesion i lirë), si hetues për periudhën 1985 – 1991, nga punësimi pranë Bashkisë Burrel, pranë Uzinës së Ferrokromit Burrel, si dhe të ardhurat (pjesërisht) nga shitja e një shtëpie të përfutur nga privatizimi i banesave shtetërore së bashku me prindërit, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 15.11.2001 (kontratë kjo e hartuar me vonesë, ndërsa shitja në fakt është realizuar në vitin 1997); (ii) kati i dytë dhe i tretë (papafingo) karabina (e papërfunduar), me vlerë të investuar prej 1.613.280 lekësh nga e motra, M. C. (H.) dhe bashkëshorti i saj Xh. C., me të ardhurat nga puna si emigrantë në shtetin grek prej vitit 1998 e në vijim. Për vërtetimin e deklaramëve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>12</sup>.

**1.3.** Komisioni konstaton se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar se posedon banesë private 3+1, e papërfunduar plotësisht. Vlera: 3 milionë lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit janë kursimet familjare të punës ndër vite, pjesërisht nga shitja e një apartamenti (3+1) në Burrel, përfutur me ligjin për privatizimin e banesave shtetërore. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Në banesën në ndërtim e sipër me adresë në Sh., Tiranë, të deklaruar më parë, për periudhën 2009 e në vijim, nga ana e motrës M. (H.) C., me banim në Greqi familjarisht, është bërë një investim në shumën 1.613.280 lekë për ndërtimin e një kati me papafingo, në fazën e ndërtimit që është bërë mbi banesën time dhe për efekt legalizimi ky ndërtim figuron në emrin tim (s qaruar edhe më parë pranë atij institucioni)”*. Në deklaratën Vetting, subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë nr. \*\*\*, datë 25.8.2016, sipas së cilës ka të regjistruar në emrin e tij pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit truall me sip. 405 m<sup>2</sup>, nga e cila sip. ndërtese 114.4 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Tiranë. Kjo pronë është përfutur me anë të kontratës kalim pronësie të parcelës ndërtimore nr. \*\*\*, datë 12.9.2015, në bazë të VKM-së Nr. \*\*\*, datë 7.7.2010.

**1.4.** Nga hetimi i Komisionit, referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja<sup>13</sup>, në emër të subjektit të rivlerësimit Petrit Hysa figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, lloji i pasurisë truall me sip. 405 m<sup>2</sup> + ndërtesë me sip. 114,4 m<sup>2</sup>. Në kartelën e pasurisë, tek rubrika “Përshkrim i veçantë”, godina e banimit 3 kate +1 kat nën tokë ka këto sipërfaqe: kati nën tokë 40.3 m<sup>2</sup>; kati përdhe 114.4 m<sup>2</sup>; veranda 24.2 m<sup>2</sup>; kati i parë 146.2 m<sup>2</sup> dhe kati i dytë 122 m<sup>2</sup>.

---

<sup>11</sup> Nënkuptohe kati i parë.

<sup>12</sup> Leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 22.9.2015; certifikatë për vërtetim pronësie datë 25.8.2016, në emër të z. Petrit Hysa; kartelë pasurie me datë regjistrimi 25.8.2016, në emër të z. Petrit Hysa; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 6.9.2006; prokurë e posaçme nr. \*\*\*, datë 3.2.2005; preventiv i punimeve për ndërtimin e katit përdhe; planimetria e katit nën tokë; planimetria e katit përdhe; pamje fotografike të katit; situacion i punimeve për banesë 2 kate mbi 1 kat ekzistues; planimetria e katit të parë; planimetria e katit të dytë; pamje fotografike të ndërtesës; certifikatë pronësie datë 15.11.2001 për apartamentin me sip. 90.8 m<sup>2</sup> në M.; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.11.2001; format vetëdeklarimi datë 24.10.2014; vërtetim nga kompania greke “\*\*\*\*\*” ltd; deklaratë e Xh. C.; vërtetim nr. \*\*\*, datë 22.2.2016, i Dhomës së Avokatisë; certifikatë avokatie nr. \*\*\*, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

<sup>13</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 26.8.2020.

**1.5.** Subjekti figuron aplikues në procesin e legalizimit dhe është pajisur me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2015, për godinën e banimit 3 kate + 1 kat nën tokë, Tirana Veri.

**1.6.** Lidhur me origjinën e kësaj prone (toka mbi të cilën është ndërtuar objekti) – në deklaratën *Vetting* – subjekti ka paraqitur kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 6.9.2006, sipas së cilës shitësi B., H., M. dhe M. D.<sup>14</sup> deklarojnë se në bazë të AMTP-së nr. \*\*\*, viti 1993, janë pronarë të një sipërfaqeje toke prej 17 hektarësh e 960 m<sup>2</sup>, të ndodhur tek \*\*\* dhe nga kjo tokë një sipërfaqe prej 400 m<sup>2</sup> ia kanë shitur subjektit të rivlerësimit Petrit Hysa në datën 9.6.1995, me çmim 500 lekë/m<sup>2</sup>, në total 200.000 lekë. Pagesa është bërë në dorë, jashtë zyrës noteriale, në datën 9.6.1995. Në këtë tokë është ndërtuar një shtëpi 1-katëshe.

**1.7.** Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ZVRPP Tiranë<sup>15</sup> ka informuar se në emër të subjektit është emetuar leja e legalizimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2015, pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor, kualifikimit të objektit informal, shlyerjes së detyrimeve financiare dhe lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore. Bashkëlidhur gjendet kontrata nr. \*\*\*, datë 12.9.2015, e lidhur ndërmjet palës shitëse ALUIZNI dhe palës blerëse Petrit Hysa, për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me sip. 405 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z.k. \*\*\*, me nr. pasurie nr. \*\*. Në bazë të VKM-së Nr. \*\*\*, datë 7.7.2010, “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”, është vendosur kalimi në pronësi i parcelës ndërtimore me sip. 405 m<sup>2</sup>, mbi të cilën është ngritur një ndërtesë trikatëshe dhe një kat nën tokë me sip. 114.4 m<sup>2</sup>, sipas dosjes së vetëdeklarimit nr. \*\*\*<sup>16</sup>. Çmimi i shitjes është 192.900 lekë. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se me anë të mandatit të lëshuar nga “Credins Bank”, datë 18.8.2015, është bërë pagesa e vlerës 72.900 lekë, si dhe në po të njëjtën datë pagesa e shumës prej 120.000 lekësh me bono privatizimi<sup>17</sup>.

**1.8.** Komisioni kërkoi administrimin e dosjes së procedurës për legalizimin e kësaj godine dhe, në përgjigje, ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri<sup>18</sup> informoi se subjekti i rivlerësimit është deklarues i ndërtimit informal nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2006 dhe nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2014, me funksion banimi, me adresë rruga “\*\*\*\*”, Njësia Administrative Nr. \*\*, Tiranë, i pajisur me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 22.9.2015.

**1.9.** Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e legalizimit, konkretisht fotove datë 9.6.2006 dhe ortofotove datë 14.4.2007, rezulton se deri në këtë datë objekti ka qenë godinë 1 kat + 1 kat nën tokë. Në formularin e vetëdeklarimit “Për legalizimin e objektit”, shtojca \*\*\*, nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2006, subjekti ka deklaruar se viti i ndërtimit është 1.1.2000 dhe tek të dhënat ndërtimore pasqyrohet 1.5 kate mbi tokë dhe lartësi 4 m. Më tej, në deklaratën për përfshirje në

<sup>14</sup> Të përfaqësuar nga shtetasi Q. D. me anë të prokurës së posaçme nr. \*\*\*, datë 3.2.2005.

<sup>15</sup> Dosje e ILDKPKI-së: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.10.2017.

<sup>16</sup> Pala shitëse deklaroi se do të lëshojë lejen e legalizimit të objektit nëse dokumentacioni i paraqitur nga blerësi është në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Sipas kontratës, të gjitha shumatat e cituara janë pranuar dhe nënshkruar nga palët para lidhjes së kësaj kontrate, si dhe kanë plotësuar të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor për legalizimin e objektit, që ndodhet në këtë parcelë ndërtimore.

<sup>17</sup> Arkëtuar nga ALUIZNI me faturat nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, datë 21.7.2015.

<sup>18</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2023.



procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje, nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2014, subjekti ka deklaruar se ndërtimi është ngritur në periudhën janar 1999 – qershor 2008.

**1.10.** Për sa i përket kohës së ndërtimit të objektit, në pyetësonin standard subjekti deklaroi se, sikurse ka sqaruar në deklaratën *Vetting* dhe në procesverbalin e deklarimit të datës 26.2.1997<sup>19</sup>, nga 1 janari i vitit 2000 deri në fund të vitit 2006 ka banuar familjarisht në një banesë pjesërisht të përfunduar në rrugën \*\*\*, Tiranë. Ndërtimi është në zonë informale të pazhvilluar dhe ka filluar rreth vitit 1995 me blerjen e një trualli, gjërmimet dhe hedhjen e themeleve në vitin 1996. Punimet janë ndërprerë gjatë vitit 1997 për shkak të krizës që përfshiu vendin dhe më pas kanë vazhduar në vitet 1998 – 1999, duke përfunduar jo plotësisht ndërtimi i katit përdhe (kati I) në fund të vitit 1999. Më tej deklaroi se në janar të vitit 2000 ka përfunduar ndërtimin pjesërisht të katit përdhe (kati I) dhe është futur për të banuar (në një dhomë e kuzhinë dhe tualet). Vlera e ndërtimit është 1.786.230 lekë, ndërtuar nga skuadra pune dhe jo nga firma ndërtuese. Sipas subjektit, një sërë punimesh gjërmimi e sistemimi i ka kryer vetë apo me të afërm të tij. Vlera e kësaj ndërtese në vitin 2003 do të ishte 3.000.000 lekë. Në vitin 2006 janë kryer punime shtesë në banesë, si ndërtimi i murit rrethues të banesës, rregullimi i rrugës për në garazh, vendosja e portës hyrëse për në banesë dhe asaj të garazhit, rregullimi i garazhit (shtrim dhe suvatim), të cilat kapnin vlerën 900.000 – 1.000.000 lekë. Subjekti ka paraqitur preventivin e punimeve të hartuar nga ing. Sh. Gj., sipas të cilit punimet përlllogariten në vlerën 974.004 lekë. Këto punime janë kryer nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator shtetasin N. P.. Punimet janë kryer me gjendjen *cash* të ndodhur në banesë dhe janë paguar pranë shoqërisë pas lëshimit të faturës përkatëse, të cilën nuk e disponon për shkak të kohës së gjatë të kaluar, rreth 14 vjet. Në përfundim, subjekti deklaroi se me miratimin e tij, në vitet 2008 – 2009, mbi katin përdhe ka investuar familja e motrës së tij M. C. (H.) dhe bashkëshorti i saj Xh. C., të cilët që prej vitit 1998 jetojnë familjarisht në Greqi (të rrezikuar seriozisht nga qëndrimi në shtetin grek për shkak të krizës ekonomike që po kalonte ai vend dhe duke mos pasur banesë në Shqipëri). Investimi i tyre sipas preventivit të ing. A. M. kap shumën 1.613.280 lekë. Investimi ka mbetur i papërfunduar, duke qenë se ata nuk u kthyen përfundimisht në Shqipëri. Edhe punimet e bëra prej tyre janë kryer me skuadra pune.

**1.11.** Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, datë 26.2.2016, subjekti ka deklaruar: *“Në datën 9.6.1995 kam blerë një tokë truall me sip. 400 m<sup>2</sup>, në vlerën 200.000 lekë. Mbi këtë truall në vitin 1995 ka filluar të ndërtohet banesa e deklaruar nga ana ime, së bashku me babain dhe vëllain tim, duke u hedhur vetëm themelet për banesë 3 kate. Për shkak të arsyeve familjare, ndërtimi i banesës u pezullua pas ndërtimit të themeleve. Në vitin 1998 kam ndërtuar katin e parë, të cilin e kam deklaruar në vitin 2003, me burim kursimet e mia si avokat, nga punësimi pranë Bashkisë Burrel, pranë Komisionit të Pronave, Privatizimit të Banesave dhe si këshilltar i kryetarit të Bashkisë, si dhe me të ardhurat nga shitja e një shtëpie të përfituar nga privatizimi, me kontratën nr.\*\*\*, datë 15.11.2001. Theksoj se kontrata është hartuar me vonesë, por shitja faktike është kryer në vitin 1997. Në vitin 2009, motra ime, e cila jeton në Greqi prej 20 vitesh, për shkak të krizës ekonomike atje, erdhi dhe investoi për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë vetëm si karabina,*

---

<sup>19</sup> Në përgjigje të pyetësonit nr. 1, subjekti sqaroi se ky deklarim ka lidhje me procesverbalin e datës 26.2.2016 dhe se viti 1997 i deklaruar është lapsus/gabim, por i referohet vitit 2016.

*në shumën 1.613.280 lekë. Pra, aktualisht në shtëpi është përfunduar kati i parë, ndërsa kati i dytë dhe i tretë janë karabina. Realisht, në këtë shtëpi unë zotëroj katin e parë me sip. 146.2 m<sup>2</sup> të ndërtuar në vitin 1995 e, në vijim, edhe bodrumin me sip. 40 m<sup>2</sup> në total, ndërsa motra zotëron katin e dytë dhe të tretë (papafingo). Vetëdeklarimi për legalizimin është bërë në emrin tim, pasi, duke qenë se kisha aplikuar për legalizim të karabinasë, bëra dhe vetëdeklarimin për legalizimin e pjesës së motrës, si shtesë në përputhje me ligjin për legalizimin”.*

**1.12.** Për sa i përket periudhës së jetesës në këtë banesë, në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se ka jetuar aty nga 1 janari i vitit 2000 deri në fund të vitit 2006<sup>20</sup>. Në DIPP-të e viteve 2003 – 2006, subjekti ka deklaruar adresën “Bashkia nr. \*\*\*, Tiranë”, ndërsa në atë të vitit 2007 ka deklaruar adresën “Njësia Bashkiake Nr. \*\*\*”. Subjekti paraqiti dokumentacion nga FSHU-ja<sup>21</sup> dhe UKT-ja Tiranë<sup>22</sup> për kontratat e lidhura për furnizimin me energji dhe ujë.

**1.13.** Sa më lart, Komisioni shqyrtoi të dhënat e dala nga aktet e administruara dhe deklarimet e subjektit për të përcaktuar: (i) periudhën e ndërtimit të këtij objekti; (ii) koston e ndërtimit të tij. Duke analizuar deklarimet e subjektit në mënyrë kronologjike, konstatohet se:

- Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 ka deklaruar banesë private 3+1, e papërfunduar plotësisht, në vlerën 3.000.000 lekë.
- Në formularin e vetëdeklarimit “Për legalizimin e objektit”, shtojca \*\*\*, nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2006, subjekti ka deklaruar se objekti i banimit është ndërtuar më 1.1.2000<sup>23</sup>.
- Në deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me lejen nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2014, vërehet se subjekti ka deklaruar se ndërtimi është ngritur në periudhën janar 1999 – qershor 2008<sup>24</sup>.
- Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, datë 26.2.2016, subjekti ka deklaruar se banesa ka filluar të ndërtohet në vitin 1995, së bashku me babain dhe vëllain, duke u hedhur vetëm themelet për banesë 3-katëshe dhe se, për shkak të arsyeve familjare, ndërtimi i banesës u pezullua pas ndërtimit të themeleve. Më tej ka deklaruar se në vitin 1998 ka ndërtuar katin e parë. Në vitin 2009, motra e tij investoi për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë vetëm si karabina, në shumën 1.613.280 lekë.
- Në DIPP-në e vitit 2015, në deklaratën e dorëzuar në datën 18.3.2016 është deklaruar se për periudhën 2009 e në vijim nga ana e motrës është bërë një investim në shumën 1.613.280 lekë.
- Në deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar kohën e fillimit dhe të përfundimit, ndërsa lidhur me koston e ndërtimit ka deklaruar vlerën 1.786.230 lekë për katin e parë (përdhe) dhe atë nën tokë 1.613.280 lekë, të investuar nga motra për katin e dytë dhe të tretë (papafingo) karabina.

<sup>20</sup> Në vitin 2019, me kontratën e qirasë nr. \*\*\*, datë 1.4.2019, një pjesë të banesës e ka dhënë me qira deri në datën 31.12.2019 me çmim 13.000 lekë/muaj.

<sup>21</sup> Librezë e energjisë elektrike, kontrata nr. \*\*\*, rruga \*\*\*.

<sup>22</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2003, lëshuar nga UKT-ja Tiranë dhe librezë e kontratës nr. \*\*\*.

<sup>23</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2023, ASHK Tirana Veri.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2023, ASHK Tirana Veri.

- Në pyetësonin standard, subjekti ka deklaruar se ndërtimi ka filluar rreth vitit 1995 me blerjen e një trualli, gërmimet dhe hedhjen e themeleve në vitin 1996. Punimet janë ndërprerë gjatë vitit 1997 për shkak të krizës që përfshiu vendin dhe më pas kanë vazhduar në vitet 1998 – 1999, duke përfunduar jo plotësisht ndërtimi i katit përdhe (kati I) në fund të vitit 1999. Më tej ka deklaruar se në janar të vitit 2000 ka përfunduar ndërtimin pjesërisht të katit përdhe (kati I) dhe është futur për të banuar (në një dhomë e kuzhinë dhe tualet). Vlera e ndërtimit është 1.786.230 lekë. Me miratimin e tij, në vitet 2008 – 2009, mbi katin e parë (përdhe) ka investuar familja e motrës së tij në shumën 1.613.280 lekë. Gjithashtu, në këtë pyetësor, subjekti ka deklaruar se në vitin 2006 ka kryer punime në vlerën 974.004 lekë<sup>25</sup>.

**1.14.** Për sa i përket vlerës së kostos së ndërtimit, në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur dy dokumente, ku pasqyrohen tabelat me emërtim: (i) preventiv, objekti kati përdhe kuota +/-00.00, pronar Petrit Hysa, me vlerë 1.786.230 lekë, hartuar nga ing. A. M shoqëria ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k.; (ii) situacion, banesë 2 kate mbi 1 kat ekzistues, investitor M. (H.) C. e Xh. C., me vlerë 1.613.280 lekë, hartuar nga ing. A. M.

**1.15.** Me anë të pyetësorit nr. 1<sup>26</sup>, subjektit iu kërkua të sqarojë mospërputhjet në deklaratimet e tij lidhur me kohën e ndërtimit të këtij objekti, të përcjellë koordinatat gjeografike, si dhe të specifikojë llojin e punimeve të kryera dhe vlerën e shpenzuar për secilin vit kalendarik.

**1.16.** Në përgjigje<sup>27</sup>, subjekti deklaroi se trualli është blerë në vitin 1995 dhe në vitin 1996 është bërë gërmimi dhe hedhja e themeleve. Punimet janë ndërprerë dhe kanë rifilluar në vitin 1998 me ndërtimin e katit përdhe (kati I), që ka përfunduar në vitin 1999. Subjekti deklaroi se vlera e investimit është 1.786.230 lekë dhe burimet e të ardhurave janë ato të deklaruara që në deklaratën e parë, nga puna si avokat dhe jurist. Në vitin 2008, mbi ndërtimin ekzistues, motra dhe bashkëshorti i saj kanë bërë ndërtimin e katit të dytë e të tretë/papafingos vetëm si karabina. Në vitin 2006 janë kryer punime shtesë në banesë nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. në vlerën përafërsisht 1.000.000 lekë. Këto punime janë kryer me gjendjen *cash* të ndodhur në banesë dhe subjekti nuk disponon fatura për shkak të kohës së gjatë të kaluar.

**1.17.** Subjekti deklaroi se për përcaktimin e kostos totale të këtij ndërtimi Komisioni duhet t’i referohet kostos mesatare të EKB-së në qytetin e Tiranës (për zonën e quajtur \*\*\*), duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën e përcaktuar për vitet 1993 – 1.1.2000<sup>28</sup>.

### **Përcaktimi i kohës së ndërtimit të banesës, referuar fakteve më lart**

**1.18.** Komisioni vëren se subjekti në DPV/2003 ka deklaruar “një banesë private 3+1 e papërfunduar plotësisht”, por, nëse i referohemi vetëdeklarimit që subjekti ka bërë pranë ALUIZNI-t në datën 7.9.2006, rezultoi se në pesë fotot e paraqitura, të cilat mbajnë datën 6.9.2006, vërehet një objekt i përfunduar me tarracë, i përbërë nga 1 kat dhe bodrum. Në kushtet që gjatë

<sup>25</sup> Ndërtimi i murit rrethues të banesës, rregullimi i rrugës për në garazh, vendosja e portës hyrëse për në banesë dhe asaj të garazhit, rregullimi i garazhit (shtrim dhe suvatim).

<sup>26</sup> Email datë 23.1.2023, ora 10:45.

<sup>27</sup> Email datë 3.2.2023, ora 14:23.

<sup>28</sup> Sipas strukturës së përcaktuar për llogaritjen e kësaj kostoje, bazuar në manualin e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit.

procedurës së legalizimit konstatohet se fotot e administruara kanë të stampuar datën dhe orën e fotografimit (datë 6.9.2006, ora 07:26, 07:27, 07:28 dhe 07:29), krijohet bindja se në vitin 2006 objekti ka qenë i ndërtuar deri në katin e parë<sup>29</sup>. Për rrjedhojë, deklarimi i subjektit në vitin 2003 se ka një banesë private 3+1 nuk qëndron, në raport me provat e administruara gjatë hetimit.

**1.19.** Më tej, nga vëzhgimi i objektit në platformën *Google Earth*, vërehet se pamjet më të hershme datojnë në qershor 2002 e, për rrjedhojë, nuk mund të japin informacion për momentin e fillimit të punimeve. Po kështu, lidhur me investimin në katin e dytë dhe të tretë, evidentohen pamje në muajt qershor 2007, qershor 2009 dhe prill 2012, nga ku nuk është e mundur që të përcaktohen ekzaktësisht fazat e punimeve.

**1.20.** ASIG-u<sup>30</sup> bën me dije se territori ku ndodhet kjo pasuri përfshihet në ortofoton e pjesshme të vitit 1999, por jo në atë të vitit 2001. Nga këqyrja e pamjeve imazherike të përcjella, pra ato të vitit 1999, vërehet tarraca e një banese<sup>31</sup>.

**1.21.** Në kushtet që nuk mund të arrihet në një përfundim nëpërmjet këqyrjes së pamjeve imazherike, për të përcaktuar periudhën e ndërtimit, Komisioni iu referua pikërisht deklarimit të subjektit gjatë kryerjes së procedurave të legalizimit, se ndërtimi është kryer gjatë periudhës janar 1999 – qershor 2008. Kjo për arsye se: (i) vetëdeklarimi për legalizim është më pranë periudhës së ndërtimit, ndërkohë që deklarimet e subjektit pranë ILDKPKI-së për periudhat e ndërtimit fillojnë vetëm në procesverbalin e vitit 2016; (ii) ky vetëdeklarim për legalizim është kryer pranë institucioneve përkatëse, të cilat ishin përgjegjëse për kontrollin dhe lëshimin e lejes së legalizimit.

**1.22.** Sa më lart, Komisioni përcaktoi periudhat e ndërtimit të banesës si në vijim:

- i. në vitin 1999 – germim dhe hedhje e themeleve për të tria katet, si dhe përfundimi i katit nën tokë dhe katit të parë (përdhe);
- ii. në vitin 2008 – ndërtimi karabina i katit të dytë dhe të tretë (papafingo).

### **Kostoja e ndërtimit të banesës, sipas përcaktimeve më sipër**

**1.23.** Komisioni analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti (me emërtim preventiv/situacion) dhe vëren se ato nuk përfaqësojnë akte teknike të përpiluara në kohën e ndërtimit të banesës.

**1.24.** Në këto kushte, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, përlllogaritja e vlerës së kostos së ndërtimit u krye duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej EKB-së, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër, që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi.

**1.25.** Komisioni vëren se EKB-ja ndër vite ka publikuar kostot e ndërtimit për objekte të përfunduara dhe nuk ka referime për kostot e ndërtimit në fazën e themeleve apo të karabinasë<sup>32</sup>.

<sup>29</sup> Gjithashtu, referuar vetëdeklarimit, është aplikuar për një objekt 1.5 kate lartësia e përgjithshme e objektit 4 metra.

<sup>30</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2023.

<sup>31</sup> Objekti i dytë pas atij në formë “L”-je. Për të kuptuar pozicionin e këtij objekti u krahasua pozicioni i tij në *Google Earth*.

<sup>32</sup> Në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, në nenin 12/1 përcaktohet se: “*Karabina është objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturën e plotë të objektit*”.

**1.26.** Duke iu referuar sërish jurisprudencës së Kolegjit<sup>33</sup>, konstatohet se kostoja e një objekti të ndërtuar deri në fazën e karabinasë varion nga 40-42% e çmimit referues sipas EKB-së.

**1.27.** Në aktet e përcjellja nga subjekti, vërehet se punimet deri në fazën e karabinasë zënë 44.6% të vlerës totale<sup>34</sup>, përqindje e cila është e përafërt me atë të përdorur nga Kolegji. Më tej, duke u bazuar sërish në aktet teknike të paraqitura nga subjekti, pesha specifike në përqindje e gërmimeve dhe themeleve përlllogaritet në masën 19.78 % të totalit<sup>35</sup>.

**1.28.** Sa më lart, Komisioni përlllogaritit për gërmimet dhe themelet një peshë specifike prej 19.78% të koston dhe një peshë specifike prej 44.6% për karabinanë.

**1.29.** Në vijim të arsytimit lidhur me periudhën e ndërtimit, Komisioni kreu përlllogaritjet bazuar në koston e ndërtimit për sipërfaqe ndërtimi, për vitet përkatëse, konkretisht: (i) për vitin 1999, kostoja në vlerën<sup>36</sup> 20.033 lekë/m<sup>2</sup>; (ii) për vitin 2008, kostoja në vlerën<sup>37</sup> 27.439 lekë/m<sup>2</sup>.

**1.30.** Më tej, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>38</sup>, Komisioni zbriti vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8.83 % nga kostoja totale e ndërtimit për vitin 1999, si dhe në masën 8.55% për vitin 2008.

**1.31.** Për rrjedhojë, Komisioni kreu përlllogaritjet duke shumëzuar: sipërfaqe ndërtimi x kosto ndërtimi x peshë specifike e llojit të punimeve dhe, më tej, nga vlera e rezultuar nga shumëzimi i këtyre 3 elementeve, zbriti përqindjen përkatëse për fondin rezervë dhe fitimin, konkretisht:

i) për vitin 1999, gërmimi dhe hedhja e themeleve për të tria katet u përlllogarit:  $447.10 \text{ m}^{239} \times 20.033 \text{ lekë/m}^2 \times 19.78 \%^{40} = 1.772.066 \text{ lekë}$ . Duke i zbritur 8.83 % kësaj vlere, rezultoi një kosto totale prej 1.615.592 lekësh.

ii) për vitin 1999, përfundimi i katit nën tokë dhe katit të parë (përdhe) u përlllogarit:  $178.90 \text{ m}^{241} \times 20.033 \text{ lekë/m}^2 \times 80.22\%^{42} = 2.874.840 \text{ lekë}$ . Duke i zbritur 8.83% kësaj vlere, rezultoi një kosto totale prej 2.620.991 lekësh.

iii) për vitin 2008 – vlera e karabinasë së katit të dytë dhe të tretë (papafingo) u përlllogarit:  $268.2 \text{ m}^{243} \times 27.439 \text{ lekë/m}^2 \times 24.82\%^{44} = 1.826.194 \text{ lekë}$ . Duke i zbritur 8.55% kësaj vlere, rezultoi një kosto totale prej 1.670.054 lekësh.

**1.32.** Në përfundim, nga këto përlllogaritje rezultoi një vlerë totale e banesës prej 5.906.638 lekësh, e cila, për efekt të analizës financiare, u shpërnda si në vijim: (a) një vlerë prej 4.236.584 lekësh për punimet deri në përfundimin e katit të parë, e ndarë respektivisht në shumën 3.262.584 lekë në

<sup>33</sup> Shihni vendimet e Kolegjit nr. 34/2022 (JR), datë 21.9.2022; nr. 35/2021 (JR), datë 23.11.2021; nr. 22/2020 (JR), datë 16.9.2020.

<sup>34</sup> Shuma e zërave (a), (b) dhe (c) të preventivit është e barabartë me 796.525 lekë, pra 44.6 % e vlerës totale 1.786.230 lekë.

<sup>35</sup> Shuma e zërave (a) dhe (b) të preventivit është e barabartë me 353.400 lekë, pra rreth 19,78% e vlerës totale 1.786.230 lekë.

<sup>36</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 28.4.1999.

<sup>37</sup> Udhëzim nr. \*\*\*, datë 20.8.2008 (referuar koston/sipërfaqe ndërtimi në qytetin e Tiranës).

<sup>38</sup> Vendim nr. 06-2022 (JR), datë 17.3.2022, subjekti H. K., paragrafët 14.8 dhe 16.6.

<sup>39</sup> Kati nën tokë (40.3 m<sup>2</sup>) dhe kati përdhe (146.2 m<sup>2</sup>).

<sup>40</sup> Ekzaktësisht 19.78%.

<sup>41</sup> Kati nën tokë (40.3 m<sup>2</sup>) dhe kati përdhe (146.2 m<sup>2</sup>).

<sup>42</sup> Përqindja që rezulton pasi zbritet pesha specifike e punimeve për gërmime dhe themele (100% – 19.78% = 80.22%).

<sup>43</sup> Kati i dytë (146,6 m<sup>2</sup>) dhe kati i tretë (122 m<sup>2</sup>).

<sup>44</sup> Përqindja që rezulton pasi zbritet pesha specifike e punimeve për gërmime dhe themele (44.60% – 19.78% = 24.82%).

vitin 1999 dhe në shumën 974.004 lekë për punime të kryera në vitin 2006; (b) një vlerë prej 1.670.054 lekësh për karabinanë e katit të dytë dhe të tretë në vitin 2008.

**1.33. Burimi financiar i krijimit të kësaj pasurie** – në vijim, Komisioni mori në analizë elementet përbërëse të analizës financiare, sipas të gjitha burimeve të deklaruara nga subjekti ndër vite dhe gjatë hetimit, konkretisht: (i) të ardhurat si avokat; (ii) të ardhurat si hetues për periudhën 1985 – 1991, jurist pranë Bashkisë Burrel dhe pranë Uzinës së Ferrokromit Burrel; (iii) të ardhurat nga kursimet familjare të prindërve dhe vëllait S. H.; (iv) të ardhurat (pjesërisht) nga shitja e një shtëpie të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore; (v) shpenzimet për jetesë<sup>45</sup>; (vi) blerja e truallit në vitin 1995<sup>46</sup>.

#### **i. Të ardhurat nga avokatia në vlerën 5.000.000 lekë**

**1.34.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se të ardhurat e përfituara nga avokatia në vlerën 5.000.000 lekë, për periudhën 1.6.1993 – 30.11.1997, rezultojnë të padokumentuara. Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues si në vijim: (i) certifikata e titullit të Avokatisë nr. \*\*\* dhe vërtetimin nr. \*\*\*, datë 22.2.2016, lëshuar nga Dhoma e Avokatisë, sipas të cilit subjekti Petrit Hysa ka fituar titullin “Avokat”, është mbajtes i licencës së avokatisë nr. \*\*\* prej vitit 1993 dhe ka ushtruar profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Dibër deri në vitin 1997. Prej këtij viti e në vazhdim ka kaluar në regjistrin e avokatëve pasivë<sup>47</sup>. Gjatë periudhës së ushtrimit të profesionit të avokatit ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj Dhomës<sup>48</sup>; (ii) vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2016, i lëshuar nga ISSH Dibër, nga ku rezulton se lidhur me ushtrimin e aktivitetit të avokatisë në Mat, në arkivin e ASSH-së Mat, në regjistrin e personave fizikë, subjekti rezulton i regjistruar me nr. dosjeje \*\*\*, me datë fillimi 1.6.1993, por nuk janë derdhur kontribute për sigurime shoqërore; (iii) sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2020, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër<sup>49</sup>, nuk rezulton dokumentacion ligjor provues për periudhën maj 1993 – nëntor 1997 për ushtrimin e aktivitetit tatimor si avokat nga ana e subjektit Petrit Hysa dhe se për këtë periudhë kohore një pjesë e dokumentacionit tatimor është shkatërruar gjatë trazirave të vitit 1997.

**1.35.** Komisioni vëren se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti nuk i ka deklaruar këto të ardhura si burim për ndërtimin e banesës. Për herë të parë, këto të ardhura përmenden në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 26.2.2016.

**1.36.** Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor për të provuar aktivitetin e kryer dhe të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet, konkretisht: (i) vendimin e gjykatës për regjistrim si person fizik privat; (ii) kopjen e certifikatës së regjistrimit në organin tatimor, ku pasqyrohet kodi fiskal; (iii) mandatarkëtime për shumat e paguara për Tatim-Taksat Dibër; (iv) mandatarkëtime për shumat e paguara për Drejtorinë e Sigurimeve Shoqërore për vitet

<sup>45</sup> Shpenzime jetike të përllogaritura: (i) 66% e të ardhurave për periudhën deri në vitin 1999; (ii) bazuar në shkresën nr. \*\*\*, datë 4.3.2019, për periudhën 2000 – 2016, të ILDKPKI-së. Në mungesë të të dhënave për vitin 2001, u konsiderua vlera e vitit paraardhës (108.000 lekë/vit për person), ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. \*\*\*, datë 27.5.2008, së INSTAT-it drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person).

<sup>46</sup> Në kontratën nr. \*\*\*, datë 6.9.2006, është cituar se pagesa është bërë në dorë, jashtë zyrës noteriale, në datën 9.6.1995.

<sup>47</sup> Certifikata “Avokat”, e lëshuar në emër të subjektit Petrit Hysa, mban nr. e licencës \*\*\*, datë 28.12.2000.

<sup>48</sup> Paraqitur në deklaratën *Vetting*.

<sup>49</sup> Paraqitur në pyetësorin standard.

1993 – 1997; (v) fletënjoftim të tatimit, si dhe çdo dokument tjetër që disponon lidhur me realizimin e të ardhurave të deklaruara. Në përgjigje, subjekti deklaroi se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhurat nga aktiviteti i avokatisë, duke kërkuar të merren në konsideratë disa rrethana bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sikurse koha e hershme e krijimit të tyre, mungesa e detyrimit të kohës për të ruajtur dokumentacionin provues, realiteti i zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vitet 1997 – 1998, si dhe fakti se DRT-ja Dibër nuk posedon dokumentacion për shkak të mungesës së një sistemi unik dokumentar apo elektronik për atë periudhë.

**1.37.** Subjekti deklaroi se ka marrë provimin e avokatisë sipas rivlerësimit të kryer në vitin 1995 – 1996 nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe për rivlerësimin e kësaj licence, ndër të tjera, kërkohej edhe pagesa e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore, çka tregon indirekt se ka qenë i regjistruar si person fizik privat tregtar dhe ka paguar kontribute të sigurimeve të detyrueshme shoqërore për periudhën 1.6.1993 – 30.11.1997<sup>50</sup>. Më tej, subjekti u referohet *indicieve* të tjera, si shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2016, nga DRSSH-ja Dibër, sipas së cilës subjekti rezulton i regjistruar në regjistrin e personave fizikë me dosjen nr. \*\*\*, me datë fillimi 1.6.1993, por nuk janë derdhur kontribute për sigurime shoqërore; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016, lëshuar nga DRSSH-ja Dibër, për pagesën e kontributeve për periudhën gjatë së cilës ka punuar në Uzinën e Ferrokromit Burrel; akti datë 23.2.2016 i Bashkisë Mat; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2020, e DRT-së Dibër<sup>51</sup>, si dhe kopje e shkresës së marrë nga regjistri i regjistrimit të çështjeve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat (me nr. rendor \*\*\*, datë 1.6.1993), sipas së cilës ka filluar aktivitetin si avokat që nga data 1.6.1993.

**1.38.** Subjekti shton se vërtet rezulton e paprovuar sasia e të ardhurave të pretenduara, por duhet të merret parasysh fakti se avokatia ka nisur të zhvillohet pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”. Sipas parashikimit të këtij ligji, avokatia presupozohet të zhvillohet në formën e një aktiviteti privat fitimprurës<sup>52</sup> dhe se subjekti e ka ushtruar aktivitetin në mënyrë të ligjshme, duke qenë i regjistruar dhe i licencuar<sup>53</sup>. Sipas nenit 5/3 të ligjit nr. 7512/1991, i ndryshuar në vitin

<sup>50</sup> Si dhe vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 22.2.2016, i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

<sup>51</sup> Sipas kësaj shkrese, nuk rezulton dokumentacion ligjor provues për periudhën maj 1993 – nëntor 1997 për ushtrimin e aktivitetit tatimor si avokat nga ana e subjektit Petrit Hysa dhe për këtë periudhë kohore një pjesë e dokumentacionit tatimor është shkatërruar gjatë trazirave të vitit 1997.

<sup>52</sup> Sipas nenit 4 të këtij ligji, parashikohej se: “*Personat fizikë a juridikë privatë, vendës a të huaj, e ushtrojnë veprimtarinë ekonomike private me mjetet e tyre financiare, me kredi, me aksione e forma të tjera*”. Profesionin e avokatisë u rregullua me një ligj të posaçëm vetëm në vitin 2003, me miratimin e ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003, në të cilin, sipas ndryshimeve të vitit 2012, u shtua në nenin 25, shkronja “ë”, e cila parashikonte regjistrimin e avokatit në organet tatimore, si një kusht për ushtrimin e aktivitetit. Ndërsa vetë legjislacioni tatimor dhe ai i sigurimeve shoqërore deri në mars të vitit 1998 nuk rezulton të ketë parashikime eksplicite për mënyrën, procedurën apo identifikimin e këtij aktiviteti si një burim i të ardhurave të tatueshme dhe që të përcaktojë detyrimet me karakter tatimor apo të tjera, që ngarkohen ndaj individëve që ushtrojnë këtë aktivitet. Vetëm me ndryshimet që pësoi ky ligj në vitin 1998, u parashikua rregullimi ligjor se Ministria e Financave është organi që përcakton rregullat për përllogaritjen dhe dokumentimin e shlyerjes së detyrimeve financiare të personave që ushtrojnë veprimtari private në vend, duke tentuar të normonte rregullat bazë të përcaktimit të detyrimeve financiare dhe procedurave të pagimit të tyre. *Regjistrimi im si person fizik privat që ushtrova aktivitetin e avokatisë prej vitit 1993 dhe pagesa e kontributeve për sigurimin shoqëror të detyrueshëm sipas parashikimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*.

<sup>53</sup> Neni 8 i ligjit nr. 7512/1991, i ndryshuar me ligjin nr. 8333, datë 24.3.1998, parashikon se: “*Ministria e Financave përcakton rregulla për dokumentimin ekonomiko-financiar, për mënyrën e llogaritjes së kontributit fiskal dhe afatet e derdhjes së tij, si dhe për kontrollin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme të sektorit privat*”. Ajo përcakton gjithashtu edhe kriteret e llogaritjes së fitimit për personat fizikë e juridikë, vendës e të huaj, që ushtrojnë veprimtari private në Shqipëri.

1993, parashikohej se: “Një kopje të vendimit përkatës të saj gjykata ia dërgon brenda 10 ditëve, nga data që vendimi ka marrë formë të prerë, organit financiar të juridiksionit të vet dhe bën regjistrimin e subjekteve”. Ky parashikim ligjor e përjashton mundësinë e mosregjistrimit në organet financiare të personave fizikë dhe që ushtronin aktivitet ekonomik.

**1.39.** Ndryshe nga sa pretendon subjekti, Komisioni vëren se nuk është paraqitur ndonjë kopje e regjistrimit të regjistrimit të çështjeve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me nr. rendor \*\*\*, datë 1.6.1993, ku të vërtetohet se subjekti ka nisur aktivitetin si avokat që nga 1 qershori i vitit 1993 akti, si dhe akti i datës 23.2.2016, lëshuar nga Bashkia Mat.

**1.40.** Vërtetimi nr. \*\*\*, datë 13.10.2016, i pretenduar nga subjekti lidhur me pagesën e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga DRSSH-ja Dibër, ka të bëjë me pagesën e kontributeve për periudhën gjatë së cilës ka punuar në Uzinën e Ferrokromit Burrel dhe jo me ushtrimin e aktivitetit të avokatisë<sup>54</sup>. Edhe vërtetimi për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto për periudhën 1.4.1997 – 31.12.1997, paraqitur në pyetësin nr. 1, ka të bëjë me të ardhurat e realizuara nga punësimi në pozicionin jurist në Uzinën e Ferrokromit Burrel.

**1.41.** Nga hetimi i Komisionit nuk rezultoi asnjë informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, ku subjekti të figuronte i regjistruar si person fizik me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër<sup>55</sup>. Po kështu, Bashkia Dibër<sup>56</sup> konfirmon se shtetasi Petrit Hysa nuk ka pasur biznes të regjistruar në zyrën e taksave dhe tarifave vendore pranë kësaj Bashkie.

**1.42.** Sa më lart, nuk rezulton e provuar që subjekti i rivlerësimit ka ushtruar aktivitetin e avokatisë në vitet 1993 – 1997, pasi nuk është arritur të provohet ushtrimi i këtij aktiviteti as me prova indirekte nga ana e subjektit. Për rrjedhojë, nuk mund të analizohet ligjshmëria e këtyre të ardhurave, për sa kohë nuk u provua burimi i tyre.

**1.43. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: “Duket se ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të provuar burimin e deklaruar – ushtrimi i aktivitetit si avokat dhe, për rrjedhojë, shumën e të ardhurave të pretenduara nga ky aktivitet në vlerën 5.000.000 lekë, për periudhën 1993 – 1997”.

**1.44.** Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim<sup>57</sup>, si dhe gjatë seancës dëgjimore, në përgjigje të barrës së provës, fillimisht shpjegoi se, ndonëse distanca kohore dhe rrethanat e kohës

---

<sup>54</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016, lëshuar nga DRSSH-ja Dibër, sipas të cilit Uzina e Ferrokromit Burrel ka paguar kontributin e sigurimeve shoqërore për z. Petrit Hysa.

<sup>55</sup> Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ushtrimi i profesionit të avokatisë presupozohet të zhvillohet në formën e një aktiviteti privat fitimprurës. Subjekti nuk rezulton i regjistruar në organet financiare të personave që regjistroheshin me vendim gjyqësor si persona fizikë dhe që ushtronin aktivitet ekonomik, sipas nenit 5, paragrafi 3 i ligjit nr. 7512/1991, i ndryshuar në vitin 1993, ku parashikohej se: “Një kopje të vendimit përkatës të saj gjykata ia dërgon brenda 10 ditëve, nga data që vendimi ka marrë formë të prerë, organit financiar të juridiksionit të vet dhe bën regjistrimin e ...”.

<sup>56</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2018, dosje e ILDKPKI-së (përcjellë në ILDKPKI me anë të email-it).

<sup>57</sup> (i) Dorëzuar në protokoll me nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2023; (ii) dërguar me email-in e datës 10.5.2023.



për të cilat diskutohen të ardhurat e tij është tepër e gjatë dhe sigurimi i këtij informacioni paraqet vështirësi, është përpjekur të sjellë para Komisionit një sërë dokumentesh<sup>58</sup>, që provojnë të ardhura të siguruar nga avokatia.

**1.45.** Subjekti shpjegoi se nëpërmjet këtij dokumentacioni, si dhe me kopjen e shkresës së marrë nga regjistri i regjistrimit të çështjeve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat<sup>59</sup>, provohet se ai e ka filluar aktivitetin si avokat që nga data 1.6.1993 dhe se nga ky dokumentacion rezultojnë të dhëna që tregojnë indirekt se ka qenë i regjistruar si person fizik privat tregtar dhe ka paguar kontribute të sigurimeve të detyrueshme shoqërore për periudhën 1.6.1993 – 30.11.1997.

**1.46.** Më tej, subjekti paraqiti një tablo të parashikimeve ligjore lidhur me ushtrimin e profesionit si avokat dhe theksoi se këto parashikime ligjore përforcojnë prezumimin ligjor se ai ishte i njohur dhe i regjistruar si person fizik në organet gjyqësore dhe i regjistruar gjithashtu si person fizik në organet e sigurimeve shoqërore.

**1.47.** Subjekti thekson faktin që organet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore nuk japin të dhëna të plota për të ardhurat e prezumuara të deklaruara prej tij për këtë periudhë, për shkaqe që nuk lidhen me keqdashjen e tij, por me elemente kohore dhe faktike që i përkasin mënyrës së organizimit dhe funksionimit në atë kohë të administratës tatimore, si dhe situatës faktike dhe paqartësitë lidhur me ligjin e zbatueshëm në kohën që është ushtruar aktiviteti i avokatisë.

**1.48.** Subjekti shpjegoi se nga kërkimi pranë arkivave të rretheve gjyqësore ku ka punuar dhe arkivit qendror gjyqësor Lundër, ka arritur të sigurojë vendime gjyqësore dhe procesverbale të seancave gjyqësore dhe të hetimit në disa rrethe, ku emri i subjektit figuron si avokat në vitet 1993 – 1997<sup>60</sup>. Sipas këtyre vendimeve, vijoi subjekti, rezulton të mbulohet e plotë e gjithë periudha kohore e viteve 1993 – 1997, e ushtrimit të aktivitetit të avokatisë në disa rrethe të vendit dhe kryesisht për vepra penale të rënda, që është tregues i një klientele të mirë dhe se ka qenë i mirëpaguar. Ndonëse nuk ka mundur të sigurojë dokumentacion të plotë për të pasqyruar të gjithë aktivitetin si avokat, në përfundim, subjekti kërkoi të konsiderohet si biznes i vogël, brenda kufirit prej 2.000.000 lekësh në vit, me një marzh fitimi prej 80%, të pranuar nga Komisioni edhe për raste të ngjashme.

**1.49.** Gjithashtu, subjekti pretendoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë për të kontrolluar vërtetësinë e deklarimeve dhe burimeve të ligjshme të të ardhurave (nga profesioni i avokatisë)

---

<sup>58</sup> (i) certifikata e titullit të Avokatisë nr. \*\*\* dhe vërtetimi nr. \*\*\* , datë 22.2.2016; (ii) vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2016, lëshuar nga ISSH Dibër; (iii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër.

<sup>59</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2023, me anë të së cilës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, në përgjigje të kërkesës së drejtuar nga subjekti, bën me dije se disponon fotokopje të regjistrimit si person fizik në profesionin avokat të shtetasit Petrit Hysa, duke bashkëlidhur një fletë regjistri, ku në numrin rendor 482 figuron emri i subjektit me datë regjistrimi 1.6.1993 si avokat, vendbanimi Burrel. Ky dokument është cituar gjatë hetimit administrativ dhe është paraqitur në përgjigje të rezultateve të hetimit.

<sup>60</sup> (1) Vendimi penal nr. \*\*\* , datë 25, 26, 30 e 31.8.1993, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për të pandehurin Sh. C.; (2) procesverbalet e seancave gjyqësore për të pandehurin D. K., të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, në lidhje me vendimin penal nr. \*\*\* , datë 1.11.1993; (3) vendimi penal nr. \*\*\* , datë 8.7.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, me të pandehur A. Gj.; (4) me materialin e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për të pandehurin N. M., të vitit 1995 (gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë); (5) vendimi penal nr. \*\*\* , datë 12.6.1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për të pandehurin V. M.; (6) vendimi penal nr. \*\*\* , datë 12.9.1996 (dhe procesverbale të seancave gjyqësore, si dhe dokumente të tjera të marra nga dosja penale), i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe përfaqësimi i bërë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, me të pandehur Y. K.; (7) vendimi penal nr. \*\*\* , datë 11.10.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për të pandehurin L. D.; (8) vendimi penal nr. \*\*\* , datë 14.11.1997, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për të pandehurit G. M. dhe R. B.

për krijimin e pasurisë banesë. Në këto kushte, kërkoi të merren në konsideratë disa rrethana bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sikurse koha e hershme e krijimit të tyre, përpara rreth 2 dekadave nga miratimi i paketës së reformës në drejtësi, mungesa e detyrimit të kohës për të ruajtur dokumentacionin provues, realiteti i zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vitet 1997 – 1998, vështirësia në ruajtjen e dokumentacionit për shkak të afateve të gjata nga koha e krijimit të të ardhurave, si dhe fakti se Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër nuk ka pasqyrim në regjistrin elektronik C@TS dhe në regjistrin kombëtar, të krijuar pas vitit 2011.

**1.50.** Subjekti kërkoi që të vlerësohet nga ana e Komisionit si një situatë e cila, ndonëse nuk konsiderohet se provon të ardhurat e plota të ligjshme, nuk duhet të rëndojë ndaj tij me përgjegjësi përkatëse.

**1.51.** Subjekti kërkoi të mbahet në konsideratë fakti se pasuria (banesë) rezultoi të jetë filluar para se të niste ushtrimin e detyrës së prokurorit (me blerjen e truallit dhe hedhjen e themeleve përpara muajit dhjetor 1997), duke konsideruar në analizën financiare të ardhurat e krijuara prej tij në vitet 1993 – 1.1.2000 (koha e fillimit dhe e ndërtimit të banesës), nga aktiviteti i avokatisë gjatë periudhës 1993 – 1997.

**1.52.** Në analizën financiare të përpiluar nga ana e subjektit vërehet se ai ka paraqitur sipas viteve këto të ardhura: (i) për periudhën 1993 – 1994, vlerën 1.000.000 lekë; (ii) për vitin 1995, vlerën 1.000.000 lekë; (iii) për vitin 1996, vlerën 1.500.000 lekë; (iv) për vitin 1997, vlerën 1.500.000 lekë.

**1.53.** Në përfundim, subjekti kërkoi që Komisioni të vlerësojë se ai ka pasur aftësi dhe burime financiare të ligjshme për ndërtimin e banesës së tij, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ka bërë deklaram të mjaftueshëm, referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.54.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaramtën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramtat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

**1.55.** *Lidhur me pretendimin e subjektit se ndodhet në kushtet e pamundësisë për të kontrolluar vërtetësinë e deklarameve dhe burimeve të ligjshme të të ardhurave (nga profesioni i avokatisë) për krijimin e pasurisë banesë, Komisioni vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi me rrethanat, të cilat ai kërkoi të merren parasysh, nuk gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak se nuk rezultoi të provohen në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e kësaj dispozite lidhur me pamundësinë objektive, sipas pikës 2 të nenit 32, e cila përcakton se: “Subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër [...]”.*

**1.56.** Në këto kushte, Komisioni, referuar nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës<sup>61</sup>, sipas së cilës “subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave”, trupi gjykues vlerëson se, ndonëse subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm se ka ushtruar profesionin e avokatit privat, sipas provave shkresore, konkretisht vendimet gjyqësore, ku emri i tij figuron si avokat mbrojtës, si dhe fleta e regjistrit përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ku pasqyrohet i regjistruar si avokat në datën 1.6.1993, ai nuk arriti të provojë masën e të ardhurave të krijuara nga ushtrimi i avokatisë, pasi këto të ardhura nuk janë deklaruar pranë organeve shtetërore dhe, për rrjedhojë, nuk janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

**1.57.** Në shkresat e përcjella nga administrata tatimore nuk konfirmohet të paktën regjistrimi pranë kësaj administrate<sup>62</sup>. Gjithashtu, referuar vërtetimit të paraqitur nga vetë subjekti me nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2016, të lëshuar nga ISSH-ja Dibër, rezulton i regjistruar me nr. dosjeje \*\*\*, me datë fillimi 1.6.1993, por nuk janë derdhur kontribute për sigurime shoqërore.

**1.58.** Për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara nga subjekti në vlerën 5.000.000 lekë, të realizuara në 5 vite, mbeten në nivel deklarativ, të paprovuara në asnjë shifër vjetore apo në total. I pyetur edhe në seancën dëgjimore nga ana e trupit gjykues, subjekti deklaroi se nuk mund të provojë me dokumentacion ligjor justifikues apo prova indirekte shumë të pretenduar.

**1.59.** Një rrethanë tjetër, e cila duhet të merret parasysh në besueshmërinë e shumës së pretenduar nga subjekti, është fakti që paga vjetore e subjektit të rivlerësimit si prokuror në vitin 1998 ishte 368.390 lekë<sup>63</sup>, ndërkohë që, sipas deklaramit të tij, veçanërisht në dy vitet e fundit të ushtrimit të profesionit si avokat në sektorin privat, kishte siguruar të ardhura tepër të larta, konkretisht 1.500.000 lekë në vitin 1996 dhe po kaq në vitin 1997. Kjo diferencë e konsiderueshme mes përfitimeve financiare si avokat, përkundër atyre si prokuror, e bën pretendimin e tij për fitime vjetore nga aktiviteti si avokat në shuma 1.000.000 – 1.500.000 milionë lekë, përpos deklaratave, edhe të pabesueshëm, pasi bien ndesh me logjikën ekonomike, në kushtet kur subjekti fitonte rreth katër herë më shumë në sektorin privat, sesa si prokuror.

**1.60.** Lidhur me kërkesën e subjektit “që të mbahet në konsideratë fakti se pasuria (banesë) rezulton të jetë filluar para se të fillonte ushtrimin e detyrës së prokurorit”, Komisioni vlerëson se kjo kërkesë nuk bazohet në prova dhe faktet e administruara nga hetimi, pasi, siç edhe është trajtuar në vijim të këtij vendimi, ndërtimi ka filluar në janar të vitit 1999, pra rreth një vit pasi subjekti ushtronte detyrën e prokurorit.

**1.61.** Për më tepër që të ardhurat nga avokatia, referuar analizës financiare të përpiluar nga ana e subjektit, kanë shërbyer jo vetëm për ndërtimin e banesës në \*\*\*, por edhe për investimin në bono

---

<sup>61</sup> “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

<sup>62</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër (paraqitur nga subjekti); shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër (hetimi i ILDKPKI-së); shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2020 (hetimi i Komisionit).

<sup>63</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*).

thesari, i cili është përdorur në vitin 2006 për blerjen e apartamentit në Tiranë, kohë kur subjekti ishte në pozicionin e prokurorit prej disa vitesh.

**1.62.** Në përfundim të arsyetimit më lart, Komisioni vlerëson se shuma e të ardhurave prej 5.000.000 lekësh, të pretenduara nga aktiviteti i avokatisë për periudhën 1993 – 1997, si burim për ndërtimin e banesës në \*\*\*, nuk duhet të konsiderohen si të ardhura në analizën financiare.

**1.63.** Në konkluzion, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të provuar të ardhurat e ligjshme nga ushtrimi i aktivitetit si avokat në vlerën 5.000.000 lekë, për periudhën 1993 – 1997, një pjesë e të cilave ka shërbyer për ndërtimin e banesës në \*\*\*, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## **ii. Lidhur me të ardhurat nga paga si hetues për periudhën 1985 – 1991, jurist pranë Bashkisë Burrel dhe pranë Uzinës së Ferrokromit Burrel**

**1.64.** Lidhur me të ardhurat përpara vitit 1993, Komisioni iu referua vendimit nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021, të Kolegjit, ku ky i fundit, në funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtron: *“[...] periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend, që përkon me vitet 1991 – 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshme, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend, që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendëse hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992 – 1993 mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion [...]”*.

**1.65.** Në vijim, për efekt të analizës financiare, Komisioni mori në konsideratë të ardhurat nga paga e subjektit duke filluar nga viti 1992 e në vijim dhe i paraqiti ato bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*<sup>64</sup>. Ndërsa pagat e bashkëshortes u paraqitën në analizën financiare, duke filluar nga momenti i lidhjes së martesës e në vijim.

## **iii. Lidhur me të ardhurat nga kursimet familjare të prindërve dhe vëllait S. H.**

**1.66.** Në pyetësin nr. 1<sup>65</sup>, subjekti deklaroi se si burim krijimi për ndërtimin e banesës kanë shërbyer edhe të ardhurat nga kursimet familjare të prindërve dhe vëllait S. H.<sup>66</sup>. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja, datë 26.2.2016, subjekti ka deklaruar: *“Në datën 9.6.1995 kam blerë një tokë truall me sip. 400 m<sup>2</sup>, në vlerën 200.000 lekë. Mbi këtë truall në vitin 1995 ka filluar të ndërtohet banesa e deklaruar nga ana ime, së bashku me babain dhe vëllain tim, duke u hedhur vetëm themelet për banesë 3 kate”*.

<sup>64</sup> Email i datës 23.1.2023.

<sup>65</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 21.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; vërtetim datë 21.10.2016 nga Bashkia Mat; vërtetim nr. \*\*\*, datë 13.10.2016, nga DRSSH-ja Dibër; vërtetim nr. \*\*\*, datë 14.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; vërtetim datë 20.1.2017 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>66</sup> *“Për pasurinë shtëpi banimi trekatëshe, me sipërfaqe totale 447,1 m<sup>2</sup>, ndërtuar në vitet 1995 – 1.1.2000, në truallin me sipërfaqe 405 m<sup>2</sup> (aktualisht e pabanueshme), të blerë prej meje (nga të ardhurat e mia si hetues, avokat, jurist në bashki, jurist në sh.a.Uzina e Ferrokromit dhe kursime personale), nga kursimet familjare të prindërve dhe vëllait S., si dhe të ardhura nga shitja e banesës në Burrel, 1/2 e vlerës së marrë fizikisht cash në vitin 1997 (kontrata e shitjes është bërë me vonesë)”*.

**1.67.** Komisioni vëren se subjekti nuk i ka deklaruar këto kursime as në deklaratën *Vetting* dhe as në DPV/2003. Po kështu, subjekti nuk e ka përcaktuar vlerën e këtij kontributi dhe nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të ardhurat që kanë shërbyer si burim.

**1.68.** Për pasojë, për efekt të analizës financiare, Komisioni nuk e mori në konsideratë kontributin e pretenduar nga kursimet familjare të prindërve dhe vëllait S. H.

**iv. Lidhur me të ardhurat (pjesërisht) nga shitja e një shtëpie të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore**

**1.69.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për ndërtimin e shtëpisë kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e një apartamenti në vitin 1997, por kontrata është hartuar me vonesë, në vitin 2001. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti ka paraqitur certifikatën e pronësisë datë 15.11.2001 dhe kartelën e pasurisë së apartamentit me sip. 90.8 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në Mat, blerë në shumën 35.205 lekë, e regjistruar në emër të subjektit me pjesë takuese 8/35 dhe në emër të familjarëve të tij.

Rezulton se ky apartament është shitur me anë të kontratës nr. \*\*\* regj., datë 15.11.2001, në vlerën 1.900.000 lekë, me palë shitëse S., S., D., P., Y., K., M. dhe E. H.

**1.70.** Sipas dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ZVRPP Mat<sup>67</sup>, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa ka pasur të regjistruar një apartament në bashkëpronësi, të fituar me kontratë privatizimi. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur, kontrata për privatizimin e banesës është lidhur në datën 26.11.1993 në emër të shtetasit N. H. Referuar vërtetimit datë 12.12.1993, apartamenti ka qenë në përdorim në bazë të kontratës së qirasë nga qytetari N. H. dhe me aktin noterial (vërtetim kontrate, nënshkrimi e pronësie) nr. \*\*\*, datë 17.12.1993, apartamenti është blerë në shumën 35.205 lekë. Më pas është shitur nga bashkëpronarët me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 15.11.2001, me vlerë 1.900.000 lekë.

**1.71.** Në pyetësorin standard, subjekti ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë (jonoteriale) datë 15.11.2001, të lëshuar nga shtetasi S. N. H. (vëllai i subjektit), ku deklarohet se me anë të kontratës së shitjes nr. \*\*\* regj., datë 15.11.2001, shuma e marrë nga shitja e kësaj banese të përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore është ndarë midis shtetasit S. H. dhe Petrit Hysa në pjesë të barabarta, nga ½ secili.

**1.72.** Për sa i përket shumës së përfituar nga subjekti, Komisioni vëren se nuk është paraqitur asnjë dokument ligjor provues që të provojë faktin se bashkëpronarët e tjerë kanë hequr dorë nga të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie. Në këto kushte, të ardhurat e përfituara u llogaritën mbi pjesën tatuese, që subjekti i rivlerësimit zotëron në masën 8/35, nga ku rezulton se ai ka përfituar vlerën 434.286 lekë, e cila do të përlllogaritet si burim krijimi për ndërtimin e godinës 3+1 kate. Për më tepër, shuma e pretenduar nga subjekti prej 950.000 lekësh nuk është deklaruar në seksionin e të ardhurave, në deklaratën *Vetting*.

**1.73.** Për sa i përket momentit të përfitimit të këtyre të ardhurave, për të cilat subjekti ka deklaruar se i ka marrë në vitin 1997, Komisioni vëren se këto të ardhura nuk mund të jenë arkëtuar në këtë

---

<sup>67</sup> Dosja e ILDKPKI-së: shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2017.

vit, pasi në kontratën e shitjes është parashikuar se kjo pasuri është përfituar nga shitësit me dëshmi trashëgimie me regjistrim nr. \*\*\*, datë 15.11.2000 dhe, në këto kushte, nuk mund të shitej përpara se shitësit të bëheshin pronarë të saj. Në përfundim, shuma 434.286 lekë u paraqit si e ardhur në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, në datën 15.11.2001 e, për rrjedhojë, nuk mund të përlllogaritet si burim për ndërtimin e banesës në \*\*\*.

**1.74.** Në përfundim të sa më lart arsyetuar, lidhur me banesën në \*\*\*, Komisioni kreu analizën financiare, duke përdorur në këtë analizë edhe konkluzionet e renditura më lart, për sa i takon: (i) kohës së ndërtimit të objektit në vitet 1999 – 2008; (ii) vlerës totale të objektit prej 5.906.638 lekësh (themelet dhe përfundimi i katit të parë në vlerën 3.262.584 lekë<sup>68</sup> në vitin 1999, punimeve në vlerën 974.004 lekë në vitin 2006 dhe karabinaja në vlerën 1.670.054 lekë në vitin 2008); (iii) burimeve të ligjshme të pranuar në këtë arsyetim se janë përdorur për ndërtimin e tij, sipas arsytimit më sipër.

**1.75.** Komisioni konstatoi se analiza financiare për periudhën 1992 – 1999 rezultoi në vlerë negative prej 3.107.071 lekësh.

**1.76.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: *“Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 3.107.071 lekë për gërmimin dhe hedhjen e themeleve për të gjitha katet dhe për përfundimin e katit të parë (përdhe) të banesës në \*\*\*, gjatë periudhës 1992 – 1999”*.

**1.77.** Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi sa vijon:

**1.78.** *Së pari*, për sa i përket të ardhurave nga kursimet familjare të prindërve dhe të vëllait S. H., subjekti deklaroi se prindërit e tij kanë qenë të dy pensionistë që përpara vitit 1990, ndërsa vëllai S. H. ka punuar në Ndërmarrjen e Ndërtimit Burrel dhe pranë Uzinës së Ferrokromit Burrel, si dhe për një periudhë kohore, konkretisht në vitet 1991 – 1993, ka ushtruar aktivitet privat si shitës ambulantë, në treg të lirë, shitës këpucësh, por nuk ka dokumentacion që provon ushtrimin e aktivitetit privat prej tij. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur kopje të librezës së punës për të provuar punësimin e tij gjatë periudhës 1982 – 2001.

**1.79.** *Së dyti*, për sa i përket të ardhurave të fituara nga shitja e apartamentit, subjekti i qëndroi deklaratën të mëparshme lidhur me përfitimin e një shume prej 950.000 lekësh nga ana e tij. Ai shpjegoi se, sikurse rezultoi edhe nga deklaratat noteriale të paraqitura në cilësinë e provës, të lëshuara nga vëllezërit Y., K. e S., si dhe motrat D. e M., të cilët kanë deklaruar heqjen dorë nga përfitimi i vlerës së shitjes së apartamentit, çmimi i shitjes prej 1.900.00 lekësh është ndarë në

---

<sup>68</sup> Si diferencë midis vlerës së rezultuar në tabelën nr. 1 (4.236.584 lekë) dhe punimeve në vitin 2006 (974.000 lekë).

mënyrë të barabartë midis subjektit dhe vëllait S., siç e ka deklaruar në deklaratat periodike. Subjekti paraqiti dokumentacion justifikues për të mbështetur deklaratimet e tij<sup>69</sup>.

**1.80.** *Së treti*, subjekti ka parashtruar pretendimet e tij lidhur me periudhën dhe vlerën e kostos së ndërtimit të banesës në \*\*\*. Fillimisht, subjekti dha shpjegime lidhur me deklarinimin e bërë nga ana e tij në deklaratën e pasurisë së vitit 2003. Konkretisht sqaroi se përshkrimi në këtë deklaratë lidhur me banesën në \*\*\* “banesë private 3+1, e papërfunduar plotësisht”, është bërë duke pasur parasysh sistemin tri dhoma e një kuzhinë dhe jo tri kate plus papafingo. Po kështu, në lidhje me deklarinimin për vlerën e objektit prej 3 milionë lekësh, ka pasur parasysh vlerën mesatare të tregut të shitjes në kohën e deklarinimit, pa pasur një vlerësim të saktë e të mirëfilltë, pasi në deklaratat periodike vjetore nuk u është kërkuar një gjë e tillë, por është kërkuar një vlerë e përafërt e banesës.

Më tej, subjekti kërkoi që llogaritjet të kryhen referuar kostos mesatare, bazuar në çmimet mesatare të kohës për zonën e quajtur \*\*\*, Tiranë, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar, në masën e përcaktuar për vitet 1993 – 1.1.2000, sipas strukturës së përcaktuar për llogaritjen e kësaj kostoje, bazuar në manualin e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit.

Subjekti pretendoi të konsiderohet jopenalizuese edhe nëse mund të ketë ndonjë pasaktësi në lidhje me elementet e sipërcituara, pasi kjo pasuri është deklaruar sipas ligjit nr. 9049/2003 edhe në deklaratën *Vetting*.

Analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën 1992 – 1999 ka mangësi, vijoi subjekti, për shkak të mospërfshirjes së të ardhurave të deklaruara dhe të vlerës së përlllogaritur për koston e ndërtimit të banesës. Sipas tij, kjo vlerë nuk paraqet vlerën reale të kostos së saj, për arsye se nuk është mbajtur parasysh se ndërtimi është informal dhe është kryer në një zonë informale, pa iu nënshtruar taksave dhe tatimeve, pa një strukturë kostoje<sup>70</sup>, pa ngritje kantieri, pa një projekt të mirëfilltë, pa llogaritje fitimit e aplikuar, pa TVSH-në, me punëtorë e specialistë të pasiguruar, me një sërë punimesh të kryera vetë, me ndihmën e të afërmeve të subjektit, pa kryer hidroizolim, duke përfshirë zërin transport në materialet<sup>71</sup> dhe pa pasur nevojën e përdorjes së makinerive në ndërtim. Subjekti shpjegoi se këto fakte tregojnë se kostoja e ndërtimit ka qenë shumë më e ulët sesa kostoja e llogaritur nga Komisioni.

**1.81.** Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti aktin e ekspertimit të kryer nga inxhinierja e licencuar, znj. S. M.<sup>72</sup>, dhe shpjegoi se në këtë akt janë të argumentuar e sqaruar zërat e punimeve të kryera në banesë. Bazuar në këtë akt, kostoja e ndërtimit për katin përdhe dhe nën tokë është 1.786.230 lekë, ndërsa vlera e katit të dytë dhe të tretë, papafingo karabina, është 1.613.280 lekë, kosto këto të cilat konfirmohen edhe me faturat tatimore të shitjes, që përkojnë me periudhën kur janë kryer punimet në banesë, të marra nga shoqëri të ndryshme, të regjistruara në organet tatimore, përfundoi

<sup>69</sup> (i) Deklaratë noteriale nr.\*\*\*, datë 25.4.2023, lëshuar nga shtetasit D. Gj., Y. dhe K. H.; (ii) deklaratë me vulë apostile, datë 24.4.2023, lëshuar nga e motra M. C. (H.).

<sup>70</sup> Subjekti shpjegoi se kjo do të thotë që nuk është paguar një inxhinier apo brigadier punimesh.

<sup>71</sup> “Kjo pasi është bërë me mjetet e shitësit dhe të tij nga një zonë shumë e afërt me atë të pikës së shitjes së inerteve dhe hekurit me vendin ku ndërtohej, rreth 100-150 ml larg, pranë firmës “\*\*\* “sh.p.k.” – shpjegoi subjekti.

<sup>72</sup> Subjekti deklaroi se ky akt ekspertimi është bazuar në Udhëzimin nr. \*\*\*, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e llogaritjes së kostos së zërave të punimeve të ndërtimit” dhe vendimin e KM nr. \*\*\*, datë 15.8.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të ndërtimit”.

subjekti. Gjithashtu, paraqiti një *CD* me foto dhe video, duke shpjeguar se aty pasqyrohet gjendja aktuale e banesës.

**1.82.** *Së katërti*, subjekti deklaroi se bashkëshortja e tij, M. H., për periudhën 1997 – 2000, ka realizuar të ardhura në shumën 150.250 lekë dhe paraqiti në cilësinë e provës librezën e saj të punës. Më tej, ai shpjegoi se gjatë periudhës 1985 – 1991, për punën e kryer si hetues, në rrethet Dibër e Mat, i është krijuar mundësia për të krijuar rezerva, pasi, siç dihet, në atë kohë niveli i jetesës ka qenë i ulët<sup>73</sup>. Sipas llogaritjeve të periudhës dhe shpenzimeve të domosdoshme për jetesë, të ardhurat për këtë periudhë arrijnë në shumën 295.520 lekë dhe shpenzimet e domosdoshme 96.600 lekë, sqaroi subjekti.

**1.83.** Subjekti kërkoi që për periudhën 1997 – 2000 Komisioni të marrë parasysh edhe të ardhurat nga paga e bashkëshortes, të cilat nuk janë përfshirë në analizën financiare kronologjike 1992 – 1999 dhe ato të punës së tij për periudhën e mësipërme.

**1.84.** Në përfundim, subjekti paraqiti analizën financiare të përpiluar nga ana e tij, për periudhën 1992 – 1999, sipas së cilës në fund të vitit 1999 rezulton një balancë pozitive në vlerën 3.067.191 lekë dhe shpjegoi se në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat nga avokatia, por gjithashtu janë pasqyruar edhe shtesat në shpenzimet për jetesë për të reflektuar saktë të ardhurat neto të shtuara në këtë periudhë.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.85.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si në vijim:

**1.86.** *Për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me të ardhurat nga kursimet familjare të prindërve dhe të vëllait S. H.*, Komisioni konstaton se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti ka deklaruar si burim krijimi vetëm të ardhurat nga punësimet e tij dhe të ardhurat nga shitja e shtëpisë së përfutur nga privatizimi i banesave shtetërore dhe jo të ardhurat nga kursimet familjare të prindërve dhe vëllait S. H.. Po kështu, subjekti i rivlerësimit nuk ka përcaktuar as vlerën e këtij kontributi, çka bie në kundërshtim me pikën 7 të udhëzimit nr. \*\*\*/2016 të ILDKPKI-së, ku “*për çdo pasuri në pronësi të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre*”.

---

<sup>73</sup> Subjekti shpjegoi se: “*Bazuar në VKM-në Nr. \*\*\*, datë 12.8.2005, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, paga referuese për specialistët e lartë ka qenë 4.110 lekë dhe paga minimale 2.685 lekë (në fakt, për hetuesit kjo pagë ka qenë mbi kufirin 7.000 lekë)*”.



Për pasojë, qëndrimi i Komisionit mbetet i pandryshuar, duke mos e marrë në konsideratë kontributin e pretenduar nga kursimet familjare të prindërve dhe vëllait S. H.

**1.87.** *Për sa i përket shumës së përfituar nga subjekti nga shitja e apartamentit në Mat*, Komisioni vëren se kjo pasuri ka qenë e regjistruar në emër të shtetasve S., Petrit, S, E., Y., K. H., D. Gj. (Hysa) dhe M. C. (H.). Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.4.2023, të lëshuar nga shtetasit D. Gj., Y. dhe K. H., të cilët deklarojnë se kanë hequr dorë nga të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 90.8 m<sup>2</sup>, në Burrel, pasi sipas tyre ata dhe motra M. C. (H.) kanë qenë të martuar dhe në shtëpi të veçanta, në kohën e privatizimit të banesave shtetërore. Në këtë banesë banonin dy prindërit, S. me bashkëshorten dhe subjekti (beqar në momentin e privatizimit). Shuma e përfituar nga shitja e apartamentit është ndarë në mënyrë të barabartë midis vëllezërve S. dhe Petrit Hysa.

**1.88.** Gjithashtu, subjekti ka paraqitur deklaratën me vulë apostile, datë 24.4.2023, lëshuar nga motra M. C. (H.), e cila deklaroi se në kohën e privatizimit të banesës ka qenë e martuar dhe ka hequr dorë nga pjesa trashëgimore në favor të vëllezërve Petrit e S. Hysa.

**1.89.** Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë me dokumentacion ligjor faktin se bashkëpronarët e tjerë kanë hequr dorë nga të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie. Në këto kushte, të ardhurat e përfituara nga ana e subjektit u përllogaritën në vlerën 950.000 lekë, përkundrajt vlerës 434.286 lekë të pasqyruar në rezultatet e hetimit.

**1.90.** Ndërsa momenti i përfitimit të këtyre të ardhurave mbetet i njëjtë, pra në datën 15.11.2001, pasi në kontratën e shitjes nr. \*\*\* regj., datë 15.11.2001, është parashikuar se apartamenti është përfituar nga shitësit me dëshmi trashëgimie nr. \*\*\* regjistrim, datë 15.11.2000, çka tregon se kjo pasuri nuk mund të shitej përpara se shitësit të bëheshin pronarë të saj.

**1.91.** *Për sa i përket periudhës dhe vlerës së kostos së ndërtimit të banesës në \*\*\**, fillimisht, lidhur me shpjegimin nga ana e subjektit mbi deklarin e tij në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, Komisioni thekson se gjatë hetimit administrativ janë analizuar të gjitha provat e administruara gjatë hetimit administrativ<sup>74</sup> dhe krijohet bindja se në vitin 2006 objekti ka qenë i ndërtuar deri në katin e parë. Për pasojë, kjo rrethanë është marrë parasysh qysh në rezultatet e hetimit paraprak dhe subjekti nuk është ngarkuar me shpjegime apo barrë prove për këtë konstatim.

**1.92.** Në lidhje me pretendimin e subjektit për periudhën e ndërtimit të banesës në \*\*\*, Komisioni ka të njëjtin vlerësim si në rezultatet e hetimit kryesisht, se periudhat e ndërtimit të banesës, si në vijim: (i) në vitin 1999 – gërmim dhe hedhje e themeleve për të tria katet, si edhe përfundimi i katit nën tokë dhe katit të parë (përdhe); (ii) në vitin 2008 – ndërtimi karabina i katit të dytë dhe të tretë (papafingo), për aq kohë sa subjekti nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, dërguar nga Komisioni me anë të rezultateve të hetimit kryesisht.

**1.93.** Lidhur me pretendimin e subjektit se *“ka pasur kosto më të ulët për ndërtimin e banesës, pasi ndërtimi është informal dhe është kryer në një zonë informale, pa iu nënshtruar taksave dhe tatimeve, pa një strukturë kostoje, pa ngritje kantieri, pa një projekt të mirëfilltë, pa llogaritur*

<sup>74</sup> Të tilla si vetëdeklarimi i subjektit pranë ALUIZNI-t, datë 7.9.2006 dhe fotot e paraqitura me datën e stampuar 6.9.2006, ku vërehet një objekt i përfunduar me tarracë, i përbërë nga 1 kat dhe bodrum.

*fitimin e aplikuar, pa TVSH, me punëtorë e specialistë të pasiguruar, me një sërë punimesh të kryera vetë me ndihmën e të afërmeve të subjektit, pa kryer hidroizolim, duke përfshirë zërin transport në materiale dhe pa pasur nevojën e përdorjes së makinerive në ndërtim dhe përlllogaritjen e kostos së ndërtimit”, Komisioni vlerëson se ky pretendim është i pabazuar, pasi subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë me dokumentacion ligjor koston e objektit të ndërtuar. Komisioni, që në rezultatet e hetimit kryesisht është bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, sipas së cilës, në të tilla situata kur subjekti i rivlerësimit dështon të provojë me dokumentacion ligjor koston e objekteve të ndërtuara në mënyrë informale, kostoja do të përlllogaritet duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej Entit Kombëtar të Banesave, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër, që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi.*

**1.94.** Për rrjedhojë, Komisioni nuk mund të marrë në konsideratë aktin e ekspertimit të paraqitur nga subjekti, aq më tepër që faturat tatimore të paraqitura nga subjekti për të mbështetur çmimet e përdorura në këtë akt ekspertimi i përkasin një periudhe më të vonë nga koha e përfundimit të katit nën tokë dhe katit të parë (përdhe).

**1.95.** Sa më sipër u analizua, Komisioni i qëndron vlerës së kostos së ndërtimit për banesën \*\*\* në shumën 5.906.638 lekë.

**1.96.** Për sa i përket pretendimit të subjektit për përfshirjen e të ardhurave të bashkëshortes, Komisioni verifikoi librezën e punës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit. Referuar këtij dokumenti, gjatë periudhës 1997 – 9.1.2001, periudhë për të cilën subjekti nuk kishte paraqitur dokumentacion gjatë hetimit administrativ për të ardhurat e realizuara, bashkëshortja e subjektit ka qenë e punësuar si mësuese pranë Drejtorisë Arsimore M. deri më 31.8.1998, e më tej ka përfituar asistencë përgjatë periudhës 31.8.1998 – 31.8.1999, ndërsa gjatë periudhës 10.1.2000 – 10.1.2001 ka qenë me leje lindjeje. Në këto kushte, Komisioni e konsideroi si të bazuar pretendimin e subjektit dhe përfshiu në analizën financiare të ardhurat e pretenduara në vlerën 150.250 lekë<sup>75</sup>.

**1.97.** Pas analizimit dhe arsyetimit lidhur me secilin pretendim të subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1992 – 1999 dhe, pas përfshirjes në këtë analizë të të ardhurave nga paga, të shpjeguara në paragrafin e mësipërm, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.956.821 lekë për kryerjen e investimit në banesën në \*\*\*.

**1.98.** Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e punimeve për gërmimin, hedhjen e themeleve dhe përfundimin e katit të parë (përdhe), deri në fund të vitit 1999, në vlerën 2.956.821 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>75</sup> Nëse merret si referencë paga mesatare e vitit 1996 (67.849/10), referuar vërtetimit për bazën e vlerësueshme, e shumëzuar me 20 muaj (1997 – gusht 1998), rezulton një vlerë e përafërt me atë të pretenduar nga subjekti.

## **Lidhur me investimin nga ana e motrës në dy kate të banesës**

**1.99.** Komisioni konstaton se për herë të parë subjekti e ka deklaruar investimin nga ana e motrës vetëm në datën 29.2.2016, në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së<sup>76</sup>. Më tej, subjekti ka vijuar me deklarimin e këtij investimi në DIPP-në e vitit 2015<sup>77</sup> dhe në deklaratën *Vetting*.

**1.100.** Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja, vërehet se subjekti ka nënshkruar një formular vetëdeklarimi në datën 7.9.2006 për ndërtimin 1.5 kate. Më tej, Komisioni konstaton se në deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje, në datën 22.9.2014, ka nënshkruar vetëm subjekti, pavarësisht se, sipas deklarimeve të tij, motra dhe bashkëshorti i saj kishin investuar 5 – 6 vite përpara përpilimit të kësaj deklaratë.

**1.101.** Në pyetësorin standard, subjekti ka paraqitur një deklaratë të lëshuar nga shtetasi Xh. C., datë 13.7.2020, ku ka deklaruar se në datën 29.7.2008 Banka e Greqisë, përmes Organizimit Kombëtar të Strehimit, i ka dhënë një kredi pa interesa, bazuar në një program për familjet me tre fëmijë, shtëpi në të cilën banon edhe sot. Subjekti ka paraqitur kontratë kredie pa interesa kreditorë, nr. \*\*\*, datë 29.6.2008, e lidhur midis shtetasit Xh. C. dhe OEK (Organizimi i Strehimit të Punëtorëve), Athinë, për përfitimin e një kredie pa interesa për blerje banese, me vlerë 138.000 euro, si pjesë e “Programit të familjeve me shumë fëmijë dhe kujdestarëve të anëtarëve të mbrojtur prej tyre me aftësi të kufizuara”<sup>78</sup>.

**1.102.** Duke qenë se këta shtetas në të njëjtën periudhë kishin investuar edhe në blerjen e një shtëpie edhe në shtetin grek, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit me anë të pyetësorit nr. 1<sup>79</sup> dhe, në përgjigje, subjekti deklaroi se kredia e marrë në shtetin grek nuk është përdorur në Shqipëri. Për investimin në Shqipëri, familja e motrës së tij ka përdorur të ardhura të ligjshme, të siguruara dhe të ardhura të tjera të pasiguruara (por jo të kundërligjshme). Investimi i bërë nga motra i përket periudhës përpara blerjes së apartamentit me kredi në shtetin grek<sup>80</sup>.

**1.103.** Gjithashtu, subjektit iu kërkua të sqarojë mosdeklarimin e ndërtimit të dy kateve në DIPP-të përkatëse, bazuar në parashikimet e pikës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003. Në përgjigje<sup>81</sup>, subjekti shpjegoi se mosdeklarimi i investimit nga motra e tij në vitin 2008 ka qenë pasaktësi, por jo fshehje, sepse është ndrequr në DIPP-në e vitit 2015 dhe shpjegimet e dhëna në datën 26.2.2016, në ILDKPKI. Nuk kanë qenë fshehje as kontributet për banesë. Për mosdeklarimin për periudhën 2008 – 2014, deklaroi se nuk ka marrë këshillime nga ILDKPKI-ja kur është pyetur në vitin 2016.

**1.104.** Më tej, subjekti u pyet në lidhje me hapat e ndërmarrë për kalimin e pronësisë së katit të parë dhe të dytë në emër të motrës dhe bashkëshortit të saj, që prej legalizimit të objektit në vitin 2015 e deri sot. Në përgjigje, subjekti deklaroi se nga ana e familjes së motrës nuk janë ndërmarrë hapa për kalimin e pronësisë, pasi objekti ende nuk ka përfunduar, familja e motrës ndodhet në

<sup>76</sup> Subjekti ka paraqitur “Situacion - banesë 2 kate mbi 1 kat ekzistues”, investitor M. (H.) C. e Xh. C., me vlerë 1.613.280 lekë, hartuar nga ing. A. M..

<sup>77</sup> Deklaratë e dorëzuar në datën 18.3.2016.

<sup>78</sup> Vetëm faqet nr. 1, 2, 3 dhe 9.

<sup>79</sup> Email i datës 23.1.2023, ora 10:45.

<sup>80</sup> Subjekti ka paraqitur deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 1.2.2023, të lëshuar nga kunati i tij Xh. C.

<sup>81</sup> Email i datës 3.2.2023, ora 14:23.

Greqi dhe ardhja e tyre në Shqipëri nuk është shumë e shpeshtë për arsye familjare. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 1.2.2023, lëshuar nga shtetasi Xh. C., i cili deklaroi se në vitin 1998<sup>82</sup>, me pëlqimin e të dyja palëve, kanë investuar për ndërtimin e një kati banimi me papafingo (II dhe III) mbi katin përdhe të banesës së ndërtuar nga subjekti; investimi kap vlerën 1.613.280 lekë. Gjithashtu, deklaroi se nuk ka pasur mosmarrëveshje dhe se nuk ka ndërmarrë asnjë hap për pjesëtimin pasuror, kjo edhe për shkak të gjendjes së papërfunduar të ndërtimit (karabina). Vlera e investimit rreth 12.000 euro është sjellë *cash* në Shqipëri nga ana e tij ose prej disa të afërmeve të tij, nën shumën 10.000 euro. Të ardhurat e investimit rrjedhin nga paga e tij dhe e bashkëshortes, kursime familjare dhe punë të tjera jashtë kohës normale të punës si të pasiguruar, por jo të kundërligjshme, gjatë kohës së emigracionit 1998 – 2008.

**1.105.** FSHU-ja<sup>83</sup> dhe UKT-ja<sup>84</sup> informojnë se nuk kanë lidhur kontrata furnizimi në qytetin e Tiranës me shtetasit Xh. dhe M. C.

**1.106.** Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit katin e dytë dhe të tretë të banesës e ka në pronësi të tij, sipas certifikatës së pronësisë nr. \*\*\*, datë 25.8.2016, fituar me anë të lejes së legalizimit nr. \*\*\*, datë 22.9.2015, Komisioni analizoi: (i) vërtetësinë e deklarimeve të subjektit lidhur me kryerjen e investimit në katin e dytë dhe të tretë/papafingo; dhe (ii) llojin e marrëdhënies me motrën për sa i përket shumës së kontribuar nga ana e saj.

**1.107.** Lidhur me vërtetësinë e deklarimeve, nga analizimi i fakteve të sipërcituara, Komisioni konstatoi se duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë bindës në lidhje me deklarinë e tij se investimi i kryer për katin e dytë dhe të tretë (papafingo) është kryer nga ana e motrës së tij.

**1.108.** Për sa i përket llojit të marrëdhënies së subjektit me motrën e tij lidhur me kontributin e kësaj të fundit në ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë, Komisioni analizoi si vijon:

**1.109.** Kodi Civil, në nenin 163, ka përcaktuar në mënyrë të qartë se: “*Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë*”. Në vijim, në nenet 164–190, Kodi Civil ka përcaktuar edhe mënyrat e fitimit të pronësisë (me kontratë, trashëgim etj.). Nga hetimi administrativ nuk rezultoi që shtetasit M. (H.) C. e Xh. C. të kenë fituar bashkëpronësinë mbi dy katet në një nga mënyrat e përcaktuara në Kodin Civil apo me ligj të veçantë.

**1.110.** Deklarimi i subjektit se motra dhe bashkëshorti i saj kanë investuar në banesën objekt hetimi dhe konfirmimi i këtij deklarimi nga ky i fundit nuk e bëjnë atë automatikisht bashkëpronar mbi pasurinë e mësipërme. Në rastin konkret mund të jenë përpara lindjes së një marrëdhënieje detyrimi ndërmjet subjektit dhe motrës e bashkëshortit të saj, ku këta të fundit kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e shumës së dhënë, por jo përpara një marrëdhënieje bashkëpronësie. Nga marrëdhëniet e detyrimit nuk mund të kalohet në marrëdhënien e pronësisë, të cilat janë dy institute të ndryshme që kanë një rregullim të veçantë në Kodin Civil<sup>85</sup>.

<sup>82</sup> Mund të jetë lapsus deklarimi i vitit 1998, në vend të vitit 2008.

<sup>83</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2023.

<sup>84</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2023.

<sup>85</sup> Vendim nr. 7, datë 16.1.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

**1.111.** Në rastin konkret, marrëdhënia ndërmjet subjektit dhe motrës, si edhe bashkëshortit të saj, plotëson elementet e kontratës së dhurimit me kusht, të parashikuar nga nenet 761, 764 dhe 768<sup>86</sup> të Kodit Civil, pasi njëra palë i ka kaluar palës tjetër një shumë të hollash pa kundërshpërblim për kryerjen e investimit në dy kate, me kushtin që ta shfrytëzojnë dhe ata sipas nevojave dhe pala tjetër ka pranuar shumën e dhënë, si dhe të drejtën (kushtin) e palës dhuruese për shfrytëzimin e banesës.

**1.112.** Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, shtetasit M. C. dhe Xh. C. konsiderohen “persona të tjerë të lidhur” me subjektin e rivlerësimit, për shkak të marrëdhënies që ekziston ndërmjet tyre dhe të pranuar nga të dy palët dhe në zbatim të nenit 32, pika 4, të ligjit 84/2016, subjekti ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së investuar në dy kate të banesës.

**1.113.** Lidhur me të ardhurat e këtyre shtetasve, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur: (i) vërtetim nga kompania greke “\*\*\*\*” ltd, ku vërtetohet se shtetasja M. C. punon në kompaninë e mësipërme si pastruese nga data 30.1.2002 e aktualisht; (ii) deklaratë të thjeshtë të lëshuar nga shtetasi Xh. C., i cili deklaron se nga viti 1998 dhe aktualisht jeton në Greqi me bashkëshorten M. dhe fëmijët. Në vitet 2008 – 2011 kanë investuar në Tiranë, në marrëveshje me vëllain e bashkëshortes, Petrit Hysa, në banesën e tij, një shumë prej 12.000 euro për vetëstrehim atje, në rast të humbjes së vendit të punës, si rezultat i krizës ekonomike që përfshiu shtetin grek. Investimi ka mbetur në fazën e karabinasë për arsye ekonomike; (iii) format vetëdeklarimi datë 24.10.2014, ku shtetasi Xh. C., banues në bashkinë \*\*\*\*, Greqi, deklaron periudhat e punësimit dhe emrat e punëdhënësve në Greqi<sup>87</sup>.

**1.114.** Me anë të *email*-it datë 9.2.2023<sup>88</sup>, subjekti ka paraqitur dokumentin “Shënim likuiditeti taksë të ardhurash personash fizikë në bazë të deklaratimit të ndryshuar 2”, për vitet 2003 – 2008, të shtetasit Xh. C., nga punësimi në shtetin grek. Është paraqitur leja e qëndrimit në shtetin grek, si dhe vërtetim nga kryetari i Bashkisë \*\*\*\*, i cili informon se ky shtetas është banues i përhershëm në bashkinë \*\*\*\*, Greqi.

**1.115.** Në dokumentacionin e paraqitur evidentohen të ardhurat nga punësimi të shtetasve Xh. C. dhe M. C. për periudhën janar 2003 – qershor 2008<sup>89</sup>, të cilat përlllogariten në shumën 83.493 euro.

**1.116.** Më tej, Komisioni iu referua të dhënave statistikore<sup>90</sup> për të përlllogaritur shpenzimet e jetesës për këta dy shtetas dhe fëmijët e tyre<sup>91</sup>, për periudhën 2003 – qershor 2008, nga ku rezultoi

---

<sup>86</sup> Kodi Civil, neni 761: “Dhurimi është një kontratë, me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon”; neni 764: “...Në qoftë se ka për objekt sende të luajtshme, ai është i vlefshëm kur ato specifikohen, duke treguar edhe vlefshëm e tyre në kontratën e dhurimit...”; neni 768: “Dhurimi mund të rëndohet me kusht ose me barrë. Dhuruesi është i detyruar të përmbushë barrën brenda kufijve të vlefshëm të sendit të dhuruar...”.

<sup>87</sup>\*\*\*\*, NIPT \*\*\*\* nga 12.6.2003 – 28.4.2004, P. P., \*\*\*\* -\*\*\*\*, NIPT \*\*\*\* nga 6.5.2004 – 26.11.2014 dhe 13.5.2015 – 29.2.2016. NOV P. OE, Ave. M. \*\*\*\*, NIPT \*\*\*\*, nga 20.10.2016.

<sup>88</sup> Ora 11:10.

<sup>89</sup> U përlllogarit ½ e shumës së të ardhurave vjetore.

<sup>90</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC\\_LI01\\_\\_custom\\_5289581/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01__custom_5289581/default/table?lang=en)

<sup>91</sup> Shkresë nr. \*\*\*\* prot., datë 21.3.2023, nga DPGJC-ja.

një vlerë prej 71.880 euro. Pas përlllogaritjes së vlerës së investimit<sup>92</sup>, duket se nuk mbulohet e gjithë vlera e deklaruar e investimit të deklaruar.

**1.117.** Nga analiza financiare u konstatua se motra e subjektit dhe bashkëshorti i saj nuk justifikojnë plotësisht me burime të ligjshme vlerën e investimit të deklaruar, duke rezultuar me një mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.871 euro balancë, e cila duhet të jetë edhe më e lartë, duke marrë parasysh faktin që të ardhurat që pasqyrohen në formularët e deklarimit të të ardhurave paraqiten në vlerën bruto.

**1.118.** Në kushtet që deklarimi i subjektit nuk ishte bindës lidhur me investimin e kryer në katin e dytë dhe të tretë dhe në kushtet që motra dhe bashkëshorti i saj nuk justifikonin plotësisht me burime financiare të ligjshme kontributin e deklaruar, Komisioni kreu analizën financiare në vitin 2008 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin dhe personat e lidhur, të cilët rezultuan me mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 1.617.569 lekë për investimin në dy kate të banesës në \*\*\*, në vitin 2008.

**1.119. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimet se: *(i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë bindës në lidhje me deklarimin e tij se investimi i kryer për katin e dytë dhe të tretë (papafingo) është kryer nga ana e motrës së tij, pasi: (a) për herë të parë kryerja e investimit nga ana e motrës është deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 26.2.2016, ndërkohë që subjekti deklaroi që investimi është kryer gjatë viteve 2008 – 2009; (b) në aplikimin e kryer pranë ASHK-së, në datën 22.9.2014, nga ana e subjektit nuk figuron emri i motrës apo bashkëshortit të saj, edhe pse shtesa në investim, sipas deklarimeve të subjektit, ishte kryer vetëm nga motra e tij; (c) nuk është ndërmarrë asnjë hap për kalimin e pronësisë në emër të motrës; (ç) në vitin 2008, motra dhe bashkëshorti kanë përfituar nga shteti grek një kredi pa interesa për blerje banese, si pjesë e “Programit të familjeve me shumë fëmijë dhe kujdestarëve të anëtarëve të mbrojtur prej tyre me aftësi të kufizuara”, çka është tregues i një shtate financiare jo të favorshme për kryerjen e investimeve të tjera. (ii) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në vlerën 1.617.569 lekë për investimin në dy kate të banesës në \*\*\*, në vitin 2008.*

**1.120.** Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi sa vijon:

**1.121.** Lidhur me konstatimet e Komisionit në pikën (i), subjekti sqaroi se mosdeklarimi i katit të dytë dhe të tretë, të ndërtuar nga motra në vitin 2008, ka qenë pasaktësi, e cila është ndrequr në DIPP-në e vitit 2015 (deklarata e datës. 18.3.2016) dhe shpjegimet e dhëna në datën 26.2.2016 në ILDKPKI. Më tej, ai shpjegoi se nuk janë ndërmarrë hapa për kalimin e pronësisë, pasi objekti ende nuk ka përfunduar, familja e motrës jeton në Greqi dhe se ardhja e tyre në Shqipëri nuk është e shpeshtë për arsye familjare. Subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 1.2.2023, lëshuar

---

<sup>92</sup> Shuma 1.613.280 lekë, e vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit për vitin 2008, 1 euro = 123,6852, sipas Bankës së Shqipërisë.

nga shtetasi Xh. C., e paraqitur edhe gjatë hetimit administrativ, si edhe kërkoi të pyetet shtetasi Xh. C. në cilësinë e dëshmitarit, duke riçelur hetimin administrativ.

**1.122.** Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për të verifikuar burimet e ligjshme të familjes së motrës për kryerjen e investimit të deklaruar, subjekti deklaroi se: *“Kjo analizë nuk qëndron, pasi, së pari, aty nuk përfshihet asnjë e ardhur nga punësimet e dyta apo të paregjistruara që ka kryer kunati me motrën dhe, së dyti, shpenzimet për jetesë për një emigrant nuk mund të barazohen me ato të një qytetari grek. Vetëm pasqyrimi i reduktuar i shpenzimeve për jetesë do të mbulonte lehtësisht diferencën në shumën 1.871 euro për periudhën 5-vjeçare (374 euro/vit), pa marrë në konsideratë të ardhurat nga punësimet e dyta. Nëse do të parashikohej që shpenzimet për jetesë të motrës dhe kunatit do të ishin vetëm 3% më pak se ato të përlllogaritura për një familje greke, investimi do të rezultonte i justifikuar”*.

**1.123.** Në përfundim, në lidhje me vlerën e përlllogaritjes së investimit të motrës dhe bashkëshortit të saj, subjekti pretendoi se: *“Duke marrë parasysh objektivitetin, proporcionalitetin, kohën e gjatë të kaluar, si dhe duke konsideruar se nuk ka indicie që këto të ardhura dhe fitimi i tyre të jetë nga aktivitete të paligjshme, investimi duhet të konsiderohet i justifikuar”*.

**1.124.** Lidhur me konstatimet e Komisionit në pikën (ii), subjekti pretendoi se përlllogaritja e këtij investimi në analizën e tij financiare është e pavend, në një kohë që ky investim i kunatit dhe motrës është deklaruar nga ana e tij përpara fillimit të procesit të rivlerësimit dhe dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Subjekti paraqiti një analizë financiare të vitit 2008, ku reflektohet një balancë pozitive në vlerën 52.485 lekë, duke pretenduar se nuk qëndron konstatimi se ai dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.125.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**1.126.** Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë të kundërtën e barrës së provës se investimi i kryer për katin e dytë dhe të tretë (papafingo) është kryer nga ana e motrës së tij, për shkak se: (i) për herë të parë, kryerja e investimit nga ana e motrës është deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së në datën 26.2.2016, ndërkohë që subjekti ka deklaruar se investimi është kryer gjatë viteve 2008 – 2009; (ii) në aplikimin e kryer pranë ASHK-së në datën 22.9.2014 nga ana e subjektit, nuk figuron emri i motrës apo bashkëshortit të saj, edhe pse shtesa në investim, sipas deklaratimeve të subjektit, ishte kryer vetëm nga motra e tij; (iii) nuk është ndërmarrë asnjë hap për kalimin e pronësisë në emër të motrës; (iv) në vitin 2008, motra dhe bashkëshorti kanë përfituar nga shteti grek një kredi pa interesa për blerje banese, si pjesë e “Programit të familjeve me shumë fëmijë dhe kujdestarëve të anëtarëve të mbrojtur prej tyre me aftësi të kufizuara”, çka është tregues i një situatë financiare jo të favorshme për kryerjen e investimeve të tjera.

**1.127.** Në këto kushte, Komisioni vlerëson se mbeten jobindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me dyshimet e ngritura për vërtetësinë e deklarimeve të tij në lidhje me deklarin se investimi në katin e dytë dhe të tretë është kryer nga motra e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

**1.128.** Duke qenë se subjekti nuk provoi bindshëm se investimi në katin e dytë dhe të tretë është kryer nga motra e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, në konsideratë të vlerësimit të rrethanave dhe fakteve të analizuara më lart, trupi gjykues krijon bindjen se investimi është kryer nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe e gjithë banesa është pasuri e tij, ashtu sikurse rezulton e regjistruar në regjistrat publikë, vërtetuar me lejen e legalizimit dhe certifikatën e pronësisë.

**1.129.** Për rrjedhojë, investimi i kryer në katin e dytë dhe të tretë papafingo konsiderohet si i kryer nga vetë subjekti, çka bën që rezultati financiar për vitin 2008 të mbetet i pandryshuar, me një mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1.617.569 lekë për kryerjen e investimit.

**1.130.** Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimi nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e investimit në vlerën 1.617.569 lekë në vitin 2008, dhe nuk ka deklaruar me vërtetësi këtë pasuri të krijuar, duke mos plotësuar përcaktimet e shkronjave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## **2. Gjendja cash në shumën 1.050.000 lekë**

**2.1.** Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në shumën 850.000 lekë, nga kursimet familjare të tij dhe bashkëshortes ndër vite dhe 200.000 lekë nga shitja e autoveturës tip “\*\*\*\*”, prodhim i vitit 1990. Bashkëlidhur kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 16.6.2016. Totali *cash*: 1.050.000 lekë. Burimi i krijimit: kursimet familjare dhe shitja e autoveturës. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues<sup>93</sup>.

**2.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se** subjekti ka deklaruar në DIPP-të vjetore si në vijim: në DIPP-në e vitit 2003 – “*Cash në banesë, të ardhura nga paga, 5 milionë*”; në DIPP-në e vitit 2004 – “*200 mijë lekë, 2004*”; në DIPP-në e vitit 2005 – “*Kursime nga pagat 400.000 lekë*”; në DIPP-në e vitit 2006 – “*400 mijë lekë, 2005*” e, më tej, në rubrikën e të dhënave që nuk publikohen është cituar *400.000 lekë cash*; në DIPP-në e vitit 2007 – “*400.000 lekë kursime nga pagat*”; në DIPP-në e vitit 2008 – “*Të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortes 500.000 lekë*”; në DIPP-në e vitit 2009 – “*Të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortes 500.000 lekë*”; në DIPP-në e vitit 2010 nuk ka deklaruar shtesa/pakësime, por lidhur me blerjen e apartamentit ka deklaruar: “*Për këto pagesa janë përdorur hua 14.000+27.000, pjesa tjetër nga mbyllja e depozitës në bono thesari e bashkëshortes dhe gjendja në cash e akumuluar*”; në DIPP-në e vitit 2011 nuk ka deklaruar shtesa/pakësime/gjendje; në DIPP-në e vitit 2012 “*300.000 lekë, të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortes*”; në DIPP-në e vitit 2013 “*300.000 lekë, të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortes*”; në DIPP-në e vitit 2014 “*250.000 lekë, të ardhura nga paga ime dhe e*

<sup>93</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 16.6.2016; vërtetim nga DPSHTRR-ja, ku vërtetohet se z. Petrit Hysa me automjetin me targë \*\*\* deri në datën 15.6.2016 nuk është debitor; kopje e regjistratit të barrës siguruese; certifikatë e pronësisë së mjetit dhe leja e qarkullimit; *statement* bankar i llogarisë së pagës në emër të subjektit në “Credins Bank”, datë 17.10.2016; *statement* bankar i llogarisë së pagës në emër të bashkëshortes në BKT, datë 14.10.2016.



*bashkëshortes*”; në DIPP-në e vitit 2015 “300.000 lekë, të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortes, duke përfshirë edhe gjendjen në llogarinë time në shumën 101.687 lekë dhe në shumën prej 42.970 lekësh në datën 31.12.2015”. Në DIPP-në e vitit 2016 nuk ka deklaruar shtesa/pakësime/gjendje.

**2.3.** Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 26.2.2016, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* në banesë në datën 31.12.2014 ka qenë 850.000 lekë. Gjithashtu, subjektit i është kërkuar të saktësojë burimin e krijimit të gjendjes *cash* në shumën 5.000.000 lekë, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 dhe, në përgjigje, subjekti deklaroi se për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 5.000.000 lekë, të deklaruar në vitin 2003, kanë shërbyer kursimet nga puna si avokat nga viti 1993 – 1997, si dhe të ardhurat nga punësimi pranë Bashkisë Burrel, pranë Komisionit të Pronave, Privatizimit të Banesave dhe si këshilltar i kryetarit të Bashkisë. Gjatë kohës që ka ushtruar profesionin si avokat, ka kryer edhe funksione pranë Bashkisë Burrel, duke qenë se në atë kohë ligji nuk e ndalonte dypunësimin. Si burim për krijimin e gjendjes *cash* kanë shërbyer edhe të ardhurat si hetues për periudhën 1.8.1985 – 1.7.1992 dhe si prokuror nga data 6.12.1997.

**2.4.** Ndërkohë që, për herë të parë në pyetësin standard, subjekti sqaroi se shuma 5.000.000 lekë në deklaratën e vitit 2003 nuk ka qenë e gjitha *cash*, por ka pasur të përfshirë edhe investimin në bono thesari. Shuma prej 2.150.000 lekësh ka qenë gjendje *cash* në banesë dhe shuma prej 2.850.000 lekësh ka qenë në bono thesari në emër të bashkëshortes M. H. Subjekti sqaroi se në konsultë me inspektorin e ILDKPKI-së, shuma prej 5.000.000 lekësh në vitin 2003 është deklaruar si *cash*, pa u ndarë në bono thesari apo *cash* në banesë, duke konsideruar *cash* si bonot e thesarit, të cilat ishin letra me vlerë në shtëpi, ashtu edhe lekët në shtëpi.

**2.5.** Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti është kontradiktor në deklaratimet e bëra lidhur me burimin e gjendjes *cash* prej 5.000.000 lekësh, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, pasi, i pyetur nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, deklaroi se si burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat e tij nga paga. Ndërkohë që në pyetësin standard deklaroi se si burim krijimi kanë shërbyer kursimet e ardhura nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga puna si avokat, në vlerë totale 2.150.000 lekë, pasi shuma prej 2.850.000 lekësh ka qenë në bono thesari, në emër të bashkëshortes M. H.

**2.6.** Sa më sipër, me anë të pyetësit nr. 1, subjektit iu kërkuar të qartësojë deklaratimet e tij lidhur me likuiditetet *cash* jashtë sistemit bankar, si dhe të shpjegojë mospërputhjet lidhur me burimin e gjendjes *cash* në shumën 5.000.000 lekë, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003. Në përgjigje<sup>94</sup>, subjekti deklaroi se paqartësia e deklaratimit të gjendjes *cash* dhe pasaktësitë në deklaratim kanë ardhur si rezultat i mungesës së trajnimeve të duhura lidhur me deklaratimet dhe të faktin që njohuritë e tij në fushën ekonomike dhe në mbajtjen e shënimeve apo evidencave nuk ishin të përshtatshme.

**2.7.** Subjekti vijoi duke shpjeguar se ka pasaktësi që në deklaratimin e parë, duke deklaruar bashkërisht gjendjen *cash* në banesë, por edhe bonot e thesarit, dhe më tej sqaroi se në atë kohë ia ka bërë prezent inspektorit të ILDKPKI-së, A. M., deklaratimin në këtë mënyrë, duke i shpjeguar që

---

<sup>94</sup> Email datë 3.2.2023, ora 14:23.

nga gjendja *cash* që ka pasur në banesë janë blerë bonot e thesarit<sup>95</sup>. Po kështu, subjekti shpjegoi se në deklaratimet e mëposhme nuk ka evidentuar pakësimet e gjendjes *cash* lidhur me pagesat e kryera të kësteve të banesës apo shpenzimet e kryera, pasi me deklarin e kësteve të paguara ka nënkuptuar edhe pakësimin e gjendjes *cash*. Gjithashtu, në shumë deklaratime u është referuar shtesave në likuiditete, duke nënkuptuar si ato në bankë, edhe ato gjendje *cash*. Më tej, subjekti dha shpjegime për secilin vit, të cilat u morën në shqyrtim nga Komisioni, duke i krahasuar me deklaratimet e subjektit në DIPP-të përkatëse.

**2.8.** Në përfundim, subjekti deklaroi se për krijimin e gjendjes *cash* në banesë të shumës 5.000.000 lekë në vitin 2003, kanë shërbyer këto burime: të ardhurat e subjektit si hetues, avokat, jurist në Bashkinë Burrel/Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, avokat në Uzinën e Ferrokromit Burrel sh.a., kursimet e familjare pasmartesore, paga e bashkëshortes dhe të ardhura nga shitja e banesës në Burrel, ½ e vlerës së marrë fizikisht *cash* në vitin 1997.

**2.9.** Sa më lart, në vijim të shpjegimeve të subjektit, Komisioni vëren që subjekti ka krijuar një situatë konfuze në lidhje me deklaratimet e likuiditeteve *cash*, duke zgjedhur, vit pas viti, mënyra të ndryshme për të përmbushur këtë detyrim ligjor. Veçanërisht gjatë periudhës 2006 – 2010, pra nga momenti i porositjes së apartamentit (trajtuar në pikën 3) në vitin 2006, deri në deklarin për herë të parë të kësaj pasurie në vitin 2010, subjekti nuk ka deklaruar as pagesat e kësteve, as huat e marra dhe as pakësimet e gjendjes *cash*, duke e vështirësuar në këtë drejtim kontrollin nga ana e Komisionit.

**2.10.** Në analizë të deklaratimeve të subjektit në DIPP-të vjetore dhe të shpjegimeve në pyetësor, Komisioni konstaton se për vitet 2008, 2011, 2012, 2013, 2015 dhe 2016, siç konstatohet dhe nga tabela e mësipërme, subjekti u ka qëndruar deklaratimeve në DIPP.

**2.11.** Ndërsa për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2009, 2010 dhe 2014, Komisioni analizoi deklaratimet në DIPP dhe gjatë hetimit administrativ, për të mbajtur një qëndrim në lidhje me balancat përkatëse të likuiditeteve *cash*, si në vijim:

- i. Për vitin 2003 – Komisioni vëren se në deklaratën e vitit 2003 është specifikuar qartësisht se gjendja prej 5.000.000 lekësh ka qenë në banesë. Gjithashtu, subjekti ka pasur mundësi që ta sqaronte këtë situatë në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 26.2.2016, ku ai është pyetur lidhur me burimin e gjendjes *cash* të deklaruar në DP/2003<sup>96</sup>, por as këtu subjekti nuk e ka saktësuar përbërjen e kësaj shume. Për rrjedhojë, në fund të vitit 2003, gjendja *cash* përlllogaritet aq sa është deklaruar nga subjekti qartësisht në deklaratën e vitit 2003, pra 5.000.000 lekë.
- ii. Për vitin 2004 – nga analizimi i transaksioneve të kryera me bonot e thesarit, konstatohet se gjatë vitit 2004 janë investuar 450.000 lekë në këta tituj. Subjekti nuk ka pakësuar investimin e tij, por ka tërhequr interesa në vlerën totale 249.400 lekë. Duke qenë se diferenca midis depozitimeve dhe tërheqjeve të interesave rezulton rreth 200.000 lekë, Komisioni e mori në

---

<sup>95</sup> Subjekti ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë (jo e noterizuar), datë 30.1.2023, të lëshuar nga shtetasi A. M., sipas së cilës deklaroi se në vitet 2003 – 2004 ka qenë me detyrë inspektor pranë ILDKPKI-së dhe është vënë në dijeni nga subjekti se në deklarin e parë në muajin mars 2004, në gjendjen *cash* të parave kishte përfshirë edhe një shumë prej 3.000.000 lekësh, të cilat i kishte investuar në bono thesari dhe se në lidhje me këtë fakt ishte shprehur se duhet të justifikonte burimin e të ardhurave.

<sup>96</sup> Pyetje nr. 2: Saktësoni burimin e krijimit të gjendjes *cash* në shumën 5.000.000 lekë, deklaruar në DP/2003.

konsideratë shpjegimin e subjektit dhe nuk paraqiti në analizën financiare shtesa në likuiditete *cash* (jashtë sistemit bankar).

- iii. Për vitin 2005 – nga analizimi i llogarive bankare të bashkëshortes pranë “Credins Bank”, Komisioni vëren se gjatë vitit 2005 është shtuar gjendja e llogarisë së pagës dhe gjendja e depozitës, respektivisht me 92.125 lekë dhe me 100.000 lekë. Gjithashtu, rezulton se llogaria e subjektit pranë “Raiffeisen Bank” është shtuar me 157.680 lekë, çka bën që totali i shtesave në llogaritë bankare të jetë 349.805 lekë dhe jo 192.000 lekë, siç ka shpjeguar subjekti.

Për rrjedhje, Komisioni nuk e mori në konsideratë shpjegimin e subjektit dhe përllorarit vlerën 400.000 lekë si shtesa në likuiditete *cash* (jashtë sistemit bankar).

- iv. Për vitin 2006 – për sa i përket shtesave nga kursimet, nga analizimi i llogarive bankare, Komisioni vëren se gjatë vitit 2006 janë shtuar gjendjet e llogarive të pagave, në total me 78.291 lekë dhe llogaria e depozitës me 100.000 lekë. Gjithashtu, në rubrikën e të dhënave që nuk publikohen, është cituar 400.000 lekë *cash*. Për rrjedhje, Komisioni nuk e mori në konsideratë shpjegimin e subjektit dhe përllorarit vlerën 400.000 lekë si shtesa në likuiditete *cash* (jashtë sistemit bankar).

Komisioni vëren se në përlloraritjet e tij subjekti ka shtuar gjendjen e vitit paraardhës me 300.000 lekë, konkretisht e ka paraqitur 2.658.000 lekë, përkundrejt vlerës prej 2.358.000 lekësh të vitit paraardhës.

Për sa i përket pakësimeve nga tërheqja e bonove të thesarit, ato janë reflektuar në analizën financiare si pakësim i gjendjeve të llogarive bankare.

- v. Për vitin 2007 – për sa i përket shtesave nga kursimet, Komisioni përllorarit vlerën 400.000 lekë sipas deklaramit në DIPP-në e vitit 2007 si shtesa në likuiditete *cash* (jashtë sistemit bankar).

Për sa i përket pakësimeve, siç u konkludua në paragrafin 2.9, mungojnë deklaramet në këtë DIPP lidhur me pagesën e kësteve të apartamentit apo lidhur me pakësimin e likuiditeteve *cash*. Në këto kushte, Komisioni, duke konsideruar pagesën e kryer në datën 19.2.2007 me vlerë 12.000 euro dhe deklarimin e kryer në DIPP-në e vitit 2010, ku subjekti ka deklaruar se për kryerjen e pagesave të apartamentit, përveç huave dhe tërheqjes së vlerës së bonove janë përdorur edhe likuiditetet e akumuluar *cash*, paraqiti në analizën financiare pakësim të likuiditeteve *cash* në vlerën 12.000 euro (ekuivalenti 1.458.000 lekë).

Në përfundim, ndryshimi i likuiditeteve për vitin 2007 u pasqyrua në vlerën -1.058.000 lekë<sup>97</sup>.

- vi. Për vitin 2009 – nga analizimi i llogarive bankare të bashkëshortes pranë “Credins Bank”, Komisioni vëren se gjatë vitit 2009 depozitat janë shtuar me 500.000 lekë, çka përputhet me deklarimin e subjektit. Për rrjedhje, Komisioni e mori në konsideratë shpjegimin e subjektit dhe nuk paraqiti shtesa të likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar.

---

<sup>97</sup> Shtesë 400.000 lekë, pakësim -1.058.000 lekë.

vii. Për vitin 2010 – Komisioni, duke konsideruar pagesën e kryer në datën 15.5.2010 me vlerë 4.000 euro dhe deklarimin në këtë DIPP, ku subjekti ka deklaruar se për kryerjen e pagesave të apartamentit, përveç huave dhe tërheqjes së vlerës së bonove, janë përdorur edhe likuiditetet e akumuluar *cash*, paraqiti në analizën financiare pakësim të likuiditeteve *cash* në vlerën 500.000 lekë.

viii. Për vitin 2014 – për sa i përket shtesave nga kursimet, Komisioni përlllogariti vlerën 250.000 lekë sipas deklarimit në DIPP-në e vitit 2014, si shtesa në likuiditete *cash* (jashtë sistemit bankar).

Për sa i përket pakësimeve të këtyre likuiditeteve, veprim i cili, sipas shpjegimeve të subjektit, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me pagesën e këstit prej 10.000 euro për apartamentin e trajtuar në pikën 3, Komisioni vëren se në DIPP-të vjetore nuk ka asnjë gjurmë lidhur me pagesën e këtij kësti apo shpjegim për burimin e tij dhe, në këto kushte, ky pakësim nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni.

**2.12.** Komisioni vëren se subjekti ka konfirmuar deklarimin që gjendja *cash* në banesë nuk ka ndryshuar në vitin 2016, në përputhje me deklarimin në DIPP-në e vitit 2016, por në kundërshtim me deklarimin në *Vetting*, ku si burim të vlerës totale prej 1.050.000 lekësh deklaroi edhe të ardhurat në vlerën 200.000 lekë nga shitja e automjetit në vitin 2016.

**2.13.** Në përfundim të sa më lart, Komisioni reflektoi ndryshimet e likuiditeteve *cash* në analizën financiare.

**2.14. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimin se: (i) *Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me likuiditetet cash, duke pasqyruar mospërputhje midis vlerës së deklaruar në Vetting dhe asaj të rezultuar nga përlllogaritjet e bazuara në DIPP-të vjetore.* (ii) *Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar se burim i gjendjes totale prej 1.050.000 lekësh janë edhe të ardhurat në vlerën 200.000 lekë, të realizuara nga shitja e automjetit në vitin 2016, ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2016 dhe pyetësorin nr. 1 ka deklaruar se nuk ka pasur ndryshime të gjendjes cash gjatë vitit 2016.*

**2.15. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës,** deklaroi se ka pasur pasaktësi, por shpjegimet e dhëna kanë lidhje logjike dhe shkakësore. Në deklarimin e parë ka përfshirë edhe gjendjen *cash* në banesë, si dhe bonot e thesarit si një deklarim *cash*. Është deklaruar i tillë, pasi ishte menduar si një investim afatshkurtër dhe me burim gjendjen *cash* në banesë, çka i ishte bërë prezent inspektorit të ILDKPKI-së. Linja logjike e ndjekur me deklaratimet e gjendjes *cash* në banesë kishte të bënte me shtesat në banesë dhe në llogari bankare, siç konfirmohet edhe nga deklarimi në vitin 2015.

Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 26.2.2016, gjendja *cash* në banesë në datën 31.12.2014 është deklaruar në shumën 850.000 lekë dhe, më pas, gjendja në fund të vitit 2016 rezultoi në shumën rreth 1.000.000 lekë.

**2.16.** Për sa i përket mospërputhjes së konstatuar në lidhje me deklarin e burimit të likuiditeteve *cash* në deklaratën *Vetting*, subjekti shpjegoi se sipas tij nuk ka pasaktësi, për faktin se gjendja *cash* në banesë mund të jetë pakësuar gjatë vitit për shpenzime të ndryshme jetese etj., dhe mund të jetë shtuar nga arkëtimet nga pagat, ndër to edhe nga shitja e automjetit, por duke mos ndryshuar në fund të vitit në krahasim me vitin e kaluar. Gjendja *cash* në banesë nuk është një gjendje statike, ajo ndryshon me shpenzimet dhe arkëtimet gjatë vitit kalendarik, vijoi subjekti.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**2.17.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarin në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**2.18.** Për sa i përket deklarin të subjektit në DP/2003, lidhur me paraqitjen në një zë të vetëm të bonove të thesarit dhe likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë shpjegimin e subjektit, duke konsideruar këtu se në formularin A-5 shpjegohet se me termin likuiditete kuptohet gjendja *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie. Për rrjedhojë, likuiditetet *cash* në fund të vitit 2003 u paraqitën në vlerën 2.150.000 lekë.

**2.19.** Lidhur me pretendimin e subjektit për pakësimin e likuiditeteve *cash* në vitin 2014 për të paguar këstin e apartamentit prej 10.000 euro, Komisioni vëren se në kushtet që në DIPP-të vjetore nuk ka asnjë gjurmë lidhur me pagesën e këtij kësti apo shpjegim për burimin e tij, ky pretendim i subjektit nuk mund të konsiderohet (trajtuar në pikën 3).

**2.20.** Më tej, duke krahasuar shpjegimet e subjektit në pyetësin nr. 1 dhe ato të dhëna në prapësime në lidhje me shtesën e likuiditeteve *cash* në vitet 2005 dhe 2006, vërehet se subjekti nuk u ka qëndruar shpjegimeve të tij në pyetësin, por ka paraqitur të njëjtat vlera të reflektuara në rezultatet e hetimit nga ana e Komisionit. Ndërsa shpjegimi i subjektit lidhur me mospërputhjen e deklarin të burimit midis deklarin në pyetësin dhe atij në *Vetting* u konsiderua bindës nga ana e Komisionit.

**2.21.** Në përfundim, Komisioni çmon se ndryshimi i qëndrimit të subjektit në disa raste, si edhe pasaktësitë e tij lidhur me deklarin e likuiditeteve *cash*, sikundër e pranon edhe vetë subjekti, kanë krijuar një situatë të tillë, në të cilën Komisioni e ka të vështirë kontrollin e dinamikës së këtyre likuiditeteve ndër vite, duke bërë që në fund të vitit 2016 të rezultojë një vlerë më e lartë se ajo e deklaruar nga subjekti.

**2.22.** Në këto kushte, pavarësisht se Komisioni pranoi disa prej shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, mënyra e deklarin të tij në DIPP-të vjetore apo, në disa raste, edhe mungesa e këtij deklarin, si dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në drejtim të shpjegimeve të dhëna, e bëjnë të pamundur kryerjen e kontrollit të plotë nga ana e Komisionit lidhur me këtë pasuri dhe, për rrjedhojë, krijuan bindjen se pasaktësitë në deklarin e subjektit të

rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklarin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

### **3. Apartament me sip. 95.26 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë**

**3.1.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament me kubaturë 2+1 dhe ambiente ndihmëse, me sipërfaqe totale së bashku me shkallët prej 95.26 m<sup>2</sup>. Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 7.6.2006, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Bashkëlidhur kopja e kontratës, hartuar në emër të bashkëshortes M. H.. Vlera: 74.000 euro. Në bashkëpronësinë e subjektit, bashkëshortes dhe fëmijëve, sipas certifikatës së gjendjes familjare. Burimi i krijimit: të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij ndër vite (1985 – 2006), si dhe hua të marra nga shtetasit K. D. dhe L. C. (deklaruar edhe më parë). Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues<sup>98</sup>.

**3.2.** Nga hetimi i Komisionit konstatohet se për herë të parë subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2010, duke deklaruar se ka porositur apartamentin me sip. 95.26 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me vlerë 74.000 euro, sipas kontratës së porosisë datë 7.6.2006. Pagaruar 47.500 euro në vitin 2006 dhe 12.500 euro në vitet në vazhdim deri në vitin 2009. Për këto pagesa janë përdorur hua 14.000 euro marrë shtetasit L. C. dhe 27.000 euro, marrë shtetasit K. D., pjesa tjetër nga mbyllja e depozitës në bono thesari e bashkëshortes dhe gjendja *cash* e akumuluar, detyrimi i mbetur firmës 10.000 euro me rastin e hipotekimit. Pjesa takuese: 100 % e bashkëshortes. Në seksionin të dhëna konfidenciale, subjekti ka sqaruar se mosdeklarimi i apartamentit të porositur është pasojë e mosmarrëveshjeve me firmën e ndërtimit dhe mosdhënies nga ana e saj të një kontrate me shkrim. Bashkëlidhur kontratat me shkrim dhe dy deklarata noteriale. Në DIPP-të vijuese, subjekti nuk ka kryer asnjë deklarin lidhur me pagesën e këtij detyrimi të mbetur ndaj shitësit.

**3.3.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur kontratë porosie për ndërtim apartamenti me sip. 95.26 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, datë 7.6.2006, të lidhur ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në cilësinë e shoqërisë ndërtuese, me porositëse shtetasen M. H.. Objekti i kësaj kontrate është blerja e një apartamenti që po ndërtohet, me sip. 95.26 m<sup>2</sup> dhe çmim 74.000 euro. Referuar kësaj kontrate porosie, pagesa e shumë do të bëhet: (i) kësti i parë prej 47.500 euro u pagua jashtë zyrës noteriale, në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) kësti i dytë prej 20.000 euro do të paguhet deri në datën 30.9.2006; (iii) kësti i tretë prej 6.500 euro do të paguhet deri në datën 30.10.2006, moment në të cilin do të dorëzohen çelësat në dorë, sipas një procesverbali të mbajtur mes palëve. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një vërtetim të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 25.2.2016, sipas të cilit M. H., mbi bazën e kontratës së porosisë datë 7.6.2006, ka kryer pagesën e apartamentit në shumën 73.000 euro. Pagesa është kryer gjatë periudhës kohore 2006 – 2014. Ndërkohë që në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se kronologjikisht pagesat për apartamentin prej 74.000 euro janë kryer: datë 7.6.2006, vlerë 47.500 euro; datë 19.2.2007, vlerë 12.000 euro; datë 8.4.2009, vlerë 500 euro; datë

---

<sup>98</sup> Kontratë porosie për ndërtim apartamenti nr. \*\*\*, datë 7.6.2006, vërtetim nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

15.5.2010, vlerë 4.000 euro; datë 17.3.2016, vlerë 10.000 euro. Në mbështetje të këtij deklarimi, ka paraqitur 4 mandatpagesa, të cilat përkojnë me vlerat dhe datat e renditura nga subjekti<sup>99</sup>.

**3.4.** Komisioni vëren se këto mandatpagesa nuk kanë numër rendor dhe numër serial, tre prej tyre janë të nënshkruara nga ana e subjektit dhe z. Q. P., ortaku i vetëm/administratori i shoqërisë “P.” sh.p.k., ndërsa mandatpagesa e datës 17.3.2016 mban vetëm firmën e z. Q. P. dhe vulën e shoqërisë.

**3.5.** Nga hetimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Tiranë<sup>100</sup> nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shitësit/ndërtuesit e këtij apartamenti.

**3.6.** Për sa i përket pagesave të kryera, Komisioni ka konstatuar disa mospërputhje, të renditura në vijim: (i) vërtetimi i datës 25.2.2016 i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. konfirmon kryerjen e pagesave gjatë periudhës 2006 – 2014, ndërkohë që mandati prej 10.000 euro, i paraqitur në pyetësonin standard, mban datën 17.3.2016, pra pas datës së lëshimit të vërtetimit; (ii) në procesverbalin datë 26.2.2016 pranë ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se i gjithë detyrimi ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. është shlyer, ndërkohë që mandati prej 10.000 euro, i paraqitur në pyetësonin standard, mban datën 17.3.2016; (iii) në DIPP-në e vitit 2010 nuk është deklaruar pagesa e kryer sipas mandatit të datës 15.5.2010, vlerë 4.000 euro; (iv) subjekti nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në DIPP-të e viteve 2011 – 2015, referuar mandatit prej 10.000 euro, datë 17.3.2016, të paraqitur në pyetësonin standard; (v) subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 kryerjen e pagesës prej 10.000 euro dhe shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., referuar mandatit prej 10.000 euro, datë 17.3.2016, të paraqitur në pyetësonin standard; (vi) detyrim i mbetur prej 10.000 euro ndaj shitësit është deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 dhe, më tej, në DIPP-të vijuese nuk është kryer asnjë deklarim lidhur me shlyerjen e këtij detyrimi.

**3.7.** Me anë të pyetësonit nr. 1<sup>101</sup>, Komisioni i përcolli subjektit mospërputhjet e sipërcituara dhe, në përgjigje, subjekti shpjegoi se *shlyerja e vlerës prej 10.000 euro është bërë në fakt në vitin 2014, ndërsa mandatarkëtimi mban datën 17.3.2016. Mosdeklarimi i vlerës së pagesës prej 4.000 euro në vitin 2010 dhe, më pas, në vitet 2011 – 2015, është harresë e paqëllimshme, sepse kontrata e porosisë së apartamentit është deklaruar. Për sa i përket raportit të bashkëpronësisë, subjekti deklaroi se në vitin 2006 është deklaruar gabim pjesa takuese 100% e bashkëshortes, pasi në fakt dhe sipas akteve (kontrata dhe të ardhurat) ajo është në bashkëpronësi pasmartesore. Ky fakt është ndrequr më pas në vitin 2011. Gjithashtu, subjekti shpjegoi se kontrata e sipërmarrjes kishte të parashikuara tri këste pagesash brenda vitit 2006, por gjatë këtij viti është realizuar vetëm kësti i parë, datë 7.6.2006, në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes. Pagesa e kësteve është realizuar në vitet pasardhëse, me mirëkuptimin e përfaqësuesit të firmës së ndërtimit, duke lejuar që pagesat të kryheshin sipas mundësive financiare. Gjatë vitit 2006 kishin planifikuar që*

---

<sup>99</sup> (1) Datë 19.2.2007, vlerë 12.000 euro; (2) datë 8.4.2009, vlerë 500 euro; (3) datë 15.5.2010, vlerë 4.000 euro; (4) datë 17.3.2016, vlerë 10.000 euro.

<sup>100</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

<sup>101</sup> Email i datës 23.1.2023.

*të realizonim më shumë shlyerje të kësteve, por për arsye të disa shpenzimeve në shtëpinë në \*\*\* dhe për arsye familjare nuk u kryen dhe u shtynë në vitet më pas, përfundoi subjekti.*

**3.8.** Në përfundim të analizimit të deklarimeve dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni, në kushtet e deklarimeve të paplota në DIPP-të vjetore, përcaktoi datat në të cilat do të kryhet analiza financiare, si në vijim: Në datën 7.6.2006, për vlerën 47.500 euro – sipas parashikimit në kontratën e porosisë, ku specifikohet se kjo shumë është shlyer në datën e nënshkrimit të kontratës. Subjekti e ka deklaruar këtë pagesë në DIPP-në e vitit 2010; – Në datën 19.2.2007, për vlerën 12.000 euro – sipas mandatit të paraqitur në pyetësonin standard. Subjekti e ka deklaruar këtë pagesë në DIPP-në e vitit 2010<sup>102</sup>; – Në datën 8.4.2009, për vlerën 500 euro – sipas mandatit të paraqitur në pyetësonin standard. Subjekti e ka deklaruar këtë pagesë në DIPP-në e vitit 2010; – Në datën 15.5.2010, për vlerën 4.000 euro – sipas mandatit të paraqitur në pyetësonin standard. Kjo pagesë nuk është deklaruar qartësisht në DIPP-në e vitit 2010, por nënkuptohet për shkak se subjekti ka deklaruar vlerën e mbetur prej 10.000 euro si detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit; – Në vitin 2014, për vlerën 10.000 euro – në kushtet që: (i) janë paraqitur dy dokumente kontradiktore lidhur me këtë pagesë, nga njëra anë mandati që mban datën 17.3.2016 dhe, nga ana tjetër, vërtetimi i datës 25.2.2016, ku shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. konfirmon se pagesat janë kryer gjatë periudhës kohore 2006 – 2014; (ii) subjekti nuk e ka deklaruar këtë pagesë në asnjë DIPP; (iii) mandati i datës 17.3.2016 nuk mban nënshkrimin e subjektit; Komisioni iu referua deklaramit të subjektit në pyetësonin nr.1<sup>103</sup>, ku përcaktohet viti 2014 si vit i kryerjes së pagesës së vlerës 10.000 euro.

**3.9. Burimi i krijimit** – duke qenë se subjekti ka deklaruar se si burim i pagesës për këtë apartament kanë qenë edhe dy hua të marra, pa afat shlyerjeje dhe pa interesa, fillimisht Komisioni analizoi deklaramet e subjektit lidhur me huat, nga ku rezultoi sa vijon: Së pari, këto hua nuk janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2006, por janë deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010, vit në të cilin është deklaruar edhe apartamenti; Së dyti, nuk provohet koha reale e dhënies së huave, pasi referuar dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja<sup>104</sup> rezulton se subjekti ka dorëzuar pranë këtij institucioni dy deklarata të thjeshta, të hartuar me shkrim dore në qershor 2006 (jo të noterizuara), ndërkohë në deklaratën *Vetting* subjekti ka dorëzuar dy deklarata të thjeshta (jo të noterizuara), datë 24.1.2017, ku shtetasit K. D. dhe L. C. deklarojnë se i kanë dhënë subjektit hua në vitin 2006. Së treti, konstatohen deklaramet kontradiktore nga ana e subjektit lidhur me kohën e marrjes së këtyre huave (analizuar në paragrafët 3.13 dhe 3.26) në deklaratën *Vetting*, në pyetësonin standard dhe dokumentin vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\*, datë 30.12.2010, hartuar para Dhomës së Noterit Publik, A. P.; Së katërti, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2006 – 2010 detyrimin ndaj huamarrësve, referuar nenit 4, shkonja “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

**3.10.** Nga sa më lart arsyetuar, rezulton se huat e konfirmuara me deklaratat e paraqitura nga shtetasit K. D. dhe L. C. duket se nuk janë marrë nga subjekti dhe, si rezultat, nuk mund të kenë

<sup>102</sup> Subjekti deklaroi: “*Paguar 47.500 euro në vitin 2006 dhe 12.500 euro në vitet në vazhdim deri në vitin 2009. Detyrimi i mbetur firmës 10.000 euro me rastin e hipotekimit*”.

<sup>103</sup> Subjekti deklaroi: “*Saktësaj se shlyerja e vlerës prej 10 mijë euro është bërë në fakt në vitin 2014, ndërsa mandatarkëtimi mban datën 17.3.2016*”.

<sup>104</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.11.2022.



shërbyer si burim për blerjen e apartamentit. Edhe nëse pranohet versioni i fakteve të pretenduara nga subjekti, ky version nuk mbështetet nga analiza financiare lidhur me burimet e ligjshme të personave të tjetër të lidhur për të dhënë këto hua. Në mënyrë më të detajuar u analizua secila shumë e marrë hua:

**3.11. Hua në shumën 27.000 euro nga shtetasi K. D. (kunati i subjektit)** – në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se në vitin 2006 (muaji qershor – tetor) ka marrë hua nga shtetasi K. D. shumën 27.000 euro, për shlyerje kontrate porosie për blerje apartamenti. Shlyer shuma 3.000 euro, mbetur pa shlyer shuma 24.000 euro. Huaja është marrë me deklaratë me shkrim, pa afat shlyerjeje dhe pa interesa. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar një deklaratë të thjeshtë (jo e noterizuar), datë 24.1.2017, të lëshuar nga z. K. D., i cili deklaron se në vitin 2006 i ka dhënë një hua pa afat në vlerën 27.000 euro, shumë e cila rrjedh nga të ardhurat e biznesit të tij 20-vjeçar “Depo farmaceutike \*\*\*”<sup>105</sup>. Komisioni vëren se kjo hua është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010, vit në të cilin është deklaruar edhe apartamenti.

**3.12.** Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI<sup>106</sup>, rezulton se subjekti ka dorëzuar pranë këtij institucioni një deklaratë të thjeshtë, të hartuar me shkrim dore, me datë qershor 2006, ku shtetasi K. D. deklaron se i ka dhënë subjektit një hua në shumën 27.000 euro me afat të pacaktuar. Kjo deklaratë është nënshkruar nga të dyja palët. Me anë të vërtetimit-nënshkrimit nr. \*\*\*, datë 30.12.2010, hartuar para Dhomës së Noterit Publik A. P., subjekti dhe z. K. D. deklarojnë se kjo deklaratë është redaktuar dhe nënshkruar prej tyre në qershor 2006, jashtë zyrës noteriale, dhe se ajo shpreh vullnetin e tyre të plotë.

**3.13.** Sa më lart, për sa i përket kohës së marrjes së kësaj huaje, konstatohen deklarime kontradiktore nga ana e subjektit, pasi: (i) në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se kjo hua është marrë në periudhën qershor – tetor 2006 dhe, po kështu, në pyetësorin standard ka deklaruar se ka marrë 20.000 euro në fillim të muajit qershor 2006 dhe vlerën 7.000 euro në muajin tetor 2006; ndërsa (ii) referuar deklaratës së mësipërme, gjithë huaja është marrë në muajin qershor 2006.

**3.14.** Lidhur me shlyerjen e kësaj huaje, subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP-në e vitit 2011, shlyerje 100.000 lekë dhe mbetje 26.000 euro; (ii) në DIPP-në e vitit 2012, shlyerje 1.000 euro dhe mbetje 25.000 euro; (iii) në DIPP-në e vitit 2012, shlyerje 300 euro dhe mbetje 25.000 euro; (iv) në DIPP-në e vitit 2015, shlyerje 1.000 euro dhe mbetje 24.000 euro; (v) në DIPP-në e vitit 2016, shlyerje 500 euro dhe mbetje 23.500 euro.

**3.15.** Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues për të provuar mundësitë financiare të shtetasit K. D. për dhënien e kësaj huaje, konkretisht: (i) ekstrakt historik të kompanisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; (ii) veprimet e kryera për bonot e thesarit nga z. K. D. për periudhën 2003 – 2004<sup>107</sup>.

**3.16.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se në lidhje me huan e marrë nga kunati K. D. (vdekur në vitin 2021), të ardhurat nuk kanë qenë vetëm nga biznesi, por edhe nga të ardhurat

<sup>105</sup> Bashkëlidhur dy ekstrakte historike të kompanisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

<sup>106</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.11.2022.

<sup>107</sup> Subjekti deklaroi se e ka administruar në rrugë elektronike nga Banka e Shqipërisë, në bazë të kërkesës së tij me nr. \*\*\* prot., datë 5.8.2020. Ky dokument u paraqit i vulosur, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1.

dhe kursimet e tij familjare e personale, kryesisht nga investimi i tij në bono thesari në vitet 2000 – 2005, dhe nuk ka tërhequr dividend nga biznesi i tij<sup>108</sup>.

**3.17.** *Për sa i përket aktivitetit tregtar*, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve<sup>109</sup> informon se nga të dhënat në sistemin informatik shtetasi K. S. D. rezulton administrator/aksioner i subjektit tregtar me NIPT \*\*\* dhe administrator i subjektit tregtar me NIPT \*\*\*.

**3.18.** Nga këqyrja e ekstraktit të QKB-së së shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, Komisioni konstaton se shtetasi K. D. ka zotëruar 16.66% të kuotave në këtë shoqëri gjatë periudhës 11.4.1995 – 24.2.2010<sup>110</sup>. Ndërsa subjekti tregtar “K. D.”, person fizik, me NIPT \*\*\*, rezulton të jetë regjistruar në datën 8.10.2009. DRT Dibër<sup>111</sup> ka përcjellë të dhëna financiare për subjektin tregtar “\*\*\*\*” sh.p.k. vetëm për periudhën 2009 e në vijim, pra pas vitit në të cilin është dhënë huaja.

**3.19.** Komisioni kërkoi sërish informacion pranë DRT-së Dibër<sup>112</sup>, duke kërkuar riverifikim lidhur me këtë subjekt tregtar, duke qenë se deri në vitin 2003 ka figuruar me emërtimin “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe, në përgjigje, DRT Dibër konfirmoi se nuk ka të dhëna për periudhën 1996 – 2007<sup>113</sup>.

**3.20.** Sa më lart, provohet që i ndjeri K. D. ka zhvilluar aktivitet tregtar, por nuk provohet të ketë përfituar dividend nga aktiviteti i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. përpara vitit 2006.

**3.21.** *Për sa i përket investimit në bono thesari*, rezulton se i ndjeri K. D. ka investuar shumën 10.000.000 lekë në datën 21.1.2003 dhe, më tej, në datën 25.7.2003 ka tërhequr 969.626 lekë si interesa dhe pjesë e papranuar në ankand, ndërsa në datën 22.1.2004 ka tërhequr shumën e maturuar prej 9.358.539 lekësh.

**3.22.** Referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>114</sup>, vetëm fakti i pasjes së një aktiviteti tregtar dhe gjendjes së likuiditeteve në sistemin bankar, nuk mjaftojnë për të konkluduar se edhe shuma e dhënë hua ka doemos një burim të ligjshëm, ndërkohë që nga të dhënat e deklaruara në organet përkatëse nuk evidentohen për huadhënësin rekorde të fitimit drejtpërdrejt të këtyre të ardhurave.

**3.23.** Nga hetimi pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Tiranë<sup>115</sup> nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin K. D.

**3.24. Hua në shumën 14.000 euro nga shtetasi L. C. (mik i subjektit) – në deklaratën Vetting** subjekti ka deklaruar se në vitin 2006 (muaji qershor – shtator) ka marrë hua nga shtetasi L. C.

---

<sup>108</sup> Subjekti ka paraqitur certifikatë vdekjeje të shtetasit K. D., dokument nxjerrje llogarie nga Banka e Shqipërisë dhe dokument për veprime të kryera për bonot e thesarit nga ish-klienti K. D. pranë sportelit të bonove të thesarit, periudha 2003 – 2004.

<sup>109</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2017, administruar nga ILDKPKI-ja.

<sup>110</sup> Të dhëna në lidhje me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.: NIPT \*\*\*; objekt aktiviteti “Përgatitja, paketimi, kontrolli i cilësisë, shitje ose pa recetë e barnave...”; themeluar në datën 11.4.1995; përfaqësues ligjor K. D., ortakë K. D., V. N., H. H., D. K., Z. C., L. Ç.. Në datën 25.2.2010, rezulton të jenë larguar ortakët e tjerë dhe z. K. D. është bërë aksioner i vetëm me 100% të kuotave, nga 16.66% që zotëronte. Në datën 25.5.2016 rezulton të jetë larguar ortakë K. D. dhe kuotat i kanë kaluar shtetasit H. D., administrator dhe ortak i vetëm i kësaj kompanie.

<sup>111</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2017, administruar nga ILDKPKI-ja.

<sup>112</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2023.

<sup>113</sup> Në përgjigjen e parë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2022, DRT Dibër informoi se nuk ka të dhëna për këtë subjekt.

<sup>114</sup> Vendim nr. 16-2020 (JR), datë 13.7.2020, subjekti H. D.

<sup>115</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

shumën prej 14.000 euro, për shlyerje kontratë porosie për blerje apartamenti. Shlyer shuma 4.000 euro, mbetur pa shlyer shuma 10.000 euro. Huaja është marrë me deklaratë me shkrim, pa afat shlyerje dhe pa interesa. Subjekti ka dorëzuar një deklaratë të thjeshtë (jo e noterizuar), datë 24.1.2017, të lëshuar nga shtetasi L. C., i cili deklaron se në vitin 2006 i ka dhënë një hua pa afat në vlerën 14.000 euro, shumë e cila rrjedh nga të ardhurat e punës së tij mbi 10 vjet emigracion në shtetin italian, si edhe dokumentacion lidhur me punësimin e këtij shtetasi në shtetin italian<sup>116</sup>.

**3.25.** Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja<sup>117</sup>, rezulton se subjekti ka paraqitur pranë këtij institucioni një deklaratë të thjeshtë, të hartuar me shkrim dore, në qershor 2006, ku shtetasi L. C. deklaron se i ka dhënë subjektit një hua në shumën 14.000 euro me afat të pacaktuar. Kjo deklaratë është nënshkruar nga të dyja palët. Me anë të vërtetimit nënshkrimit nr.\*\*\*, datë 30.12.2010, hartuar para dhomës së noterit publik A. P., subjekti dhe shtetasi L. C. deklarojnë se kjo deklaratë është redaktuar dhe nënshkruar prej tyre në qershor 2006, jashtë zyrës noteriale dhe se ajo shpreh vullnetin e tyre të plotë.

**3.26.** Sa më lart, për sa i përket kohës së marrjes së kësaj huaje, konstatohen deklaramë kontradiktore nga ana e subjektit pasi: (i) në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se kjo hua është marrë në periudhën qershor – shtator 2006 dhe, po kështu, në pyetësin standard ka deklaruar se ka marrë 8.000 euro në datën 5.6.2006 dhe 6.000 euro në shtator 2006; ndërsa (ii) referuar deklaratës së mësipërme, gjithë huaja është marrë në qershor 2006.

**3.27.** *Ndërsa lidhur me shlyerjen e kësaj huaje*, subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP-në e vitit 2011, shlyerje shlyerje 200.000 lekë dhe mbetje 12.500 euro; (ii) në DIPP-në e vitit 2012, shlyerje 500 euro dhe mbetje 12.000 euro; (iii) në DIPP-në e vitit 2014, shlyerje 1.000 euro dhe mbetje 11.000 euro; (iv) në DIPP-në e vitit 2015, shlyerje 1.000 euro dhe mbetje 10.000 euro.

**3.28.** Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se shtetasi L. C. është i punësuar në shtetin italian, në firmën e sipërmarrësit A. C., me NIPT \*\*\* dhe me seli në rrugën “\*\*\*\*”, nr. \*\*, Itali, regjistruar në regjistrin e artizanëve nr. \*\*. Në përgjigje të pyetësin nr. 1<sup>118</sup>, lidhur me mënyrën e dërgesës së këtyre fondeve në Shqipëri, subjekti deklaroi se gjatë periudhës së emigracionit (vitet 1998 – 2006) ky shtetas ka ardhur herë pas here në Shqipëri dhe ka sjellë gjithmonë me vete para në gjendje *cash* (nën 10.000 euro për çdo rast). Një transferim i tillë është bërë edhe për arsye sigurie<sup>119</sup>.

---

<sup>116</sup> (i) “libro matricola” për punësimin e shtetasit L. C. në Itali; (ii) vërtetim nga INPS (Instituti i Sigurimeve Shoqërore Itali) sipas të cilit L. C. është regjistruar prej datës 3.11.2005 e aktualisht në shoqëri/ndërmarrje artizanale; (iii) kopje e lejes së qëndrimit në Itali.

<sup>117</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.11.2022.

<sup>118</sup> *Email* datë 9.2.2023, ora 11:10, datë 9.2.2023, ora 11:10 dhe datë 13.2.2023, ora 16:21.

<sup>119</sup> Me anë të *email*-it datë 13.2.2023, ora 17:42, subjekti ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë (jo e noterizuar) të lëshuar nga shtetasi L. C., i cili deklaron se gjatë viteve 1995 – 2006 ka qenë emigrant në shtetin italian, i punësuar dhe i siguruar sikurse është e pasqyruar në dokumentin e INPS-së. Gjatë periudhës së qëndrimit në Itali ka ardhur tek familjarët e tij në Shqipëri shpeshherë (5-6 herë) dhe gjithmonë ka sjellë me vete para *cash* (nën 10.000 euro për çdo rast). Një transferim i tillë e ka bërë edhe për efekte sigurie. Në momentin që i është kërkuar huaja nga subjekti i rivlerësimit, me të ardhurat dhe gjendjen që kishte në Shqipëri, ka pasur mundësinë e dhënies së kësaj huaje. Në datën 11.4.2023 subjekti ka përcjellë me anë të postës elektronike deklaratë të lëshuar nga shtetasi L. C. me nr. \*\*\* me apostile \*\*\* regjistri.

**3.29.** Për të vërtetuar mundësitë financiare të këtij shtetasi për dhënien e huas, subjekti paraqiti ekstraktin e llogarisë së sigurimeve datë 3.2.2023, lëshuar nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore Italiane, ku renditen periudhat e kontributeve të regjistruara në arkivat e këtij Instituti.

**3.30.** Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton se shtetasi L. C. ka realizuar të ardhura gjatë periudhës 1.7.1998 – 31.12.2006, me disa shkëputje ndër vite. Shuma totale e të ardhurave bruto ka qenë 34.528 euro. Referuar të dhënave statistikore, shpenzimet e minimumit jetik, për të njëjtën periudhë, vetëm për një person, kanë qenë në një vlerë totale prej 54.094 euro<sup>120</sup>.

**3.31.** Sa më lart, duket se shuma e të ardhurave të realizuara (34.528 euro) nuk është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të jetesës vetëm për një person (54.094 euro) dhe, për rrjedhojë, as për huan e dhënë (14.000 euro)<sup>121</sup>.

**3.32.** Nga hetimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Tiranë<sup>122</sup> nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin L. C..

**3.33.** Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti, sipas kësteve të detajuara në paragrafin 3.8.

**3.34.** Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar se për pagesat e apartamentit është përdorur hua shuma 14.000 euro marrë shtetasit L. C. dhe 27.000 euro, marrë shtetasit K. D.. Pjesa tjetër nga mbyllja e depozitës në bono thesari e bashkëshortes dhe gjendja *cash* e akumuluar.

**3.35.** Me anë të pyetësorit nr. 1<sup>123</sup>, Komisioni i kërkoi subjektit të sqarojë qartësisht burimin financiar për pagesat e kryera për apartamentin, duke specifikuar për secilën prej tyre se sa është kontributi nga huat, sa nga kursimet e vitit, sa nga kursimet e mbartura etj. Në përgjigje, subjekti shpjegoi se burimi për pagesat e kryera është: nga huat 41.000 euro, 19.000 euro nga shuma e bonove të thesarit të konvertuara në euro (që janë kursime të mbartura) dhe shuma 10.000 euro, likuiduar në vitin 2014, të ardhura nga paga dhe kursimet familjare deri në këtë vit.

Duke analizuar shpjegimet e subjektit në raport me datat e kryerjes së pagesës, duket se subjekti ka përfshirë në pagesat e kryera në vitet 2007 – 2010 (në total 16.500 euro) edhe vlerën e mbetur nga huat apo burime të tjera, vlera të cilat nuk janë deklaruar në DIPP-të përkatëse.

**3.36.** Sa më lart, nuk është e qartë se sa është përdorur specifikisht nga secili prej burimeve (hua, tërheqja e bonove dhe pakësimi i gjendjes *cash*) për secilin këst.

**3.37.** Komisioni vëren se, nëse do të ishin krijuar likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, ato do të duhet të ishin deklaruar në DIPP-në e vitit përkatës në përputhje me kërkesat ligjore, konkretisht referuar nenit 4, shkronjës “d” të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, parashikohet se subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, si dhe

<sup>120</sup> [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC\\_LI01\\_custom\\_5160774/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_LI01_custom_5160774/default/table?lang=en). Në kushtet e mungesës së të dhënave për vitet 2002 dhe 2003, u morën si referencë të dhënat e vitit 2001.

<sup>121</sup> Saktësuar vlera e huas e shënuar në paragrafin 3.50 të relacionit mbi rezultatet e hetimit.

<sup>122</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022 dhe \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

<sup>123</sup> Email datë 23.1.2023.

referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, në deklarin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë.

**3.38.** *Kësti i parë, datë 7.6.2006, vlera 47.500 euro* – në pyetësin standard subjekti ka deklaruar se në muajin mars 2006 i ka dhënë hua kunatës, shtetas Sh. Gj., shumën 16.000 euro, përafërsisht në vlerën 2.000.000 lekë, nga gjendja *cash* në banesë. Kjo shumë i është kthyer në nëntor të të njëjtit vit. Subjekti ka paraqitur deklaratë të shtetas Sh. Gj., ku konfirmohet deklarimi i subjektit. Pra, referuar këtyre shpjegimeve, subjekti nuk i ka pasur të disponueshme likuiditetet *cash* të viteve paraardhëse dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të jenë përdorur për pagesën e këtij kësti.

**3.39.** Nga analizimi i transaksioneve të kryera me bonot e thesarit<sup>124</sup> rezultoi se në datën 7.6.2006, është tërhequr gjithë investimi i kryer në bono, në vlerën totale 3.300.000 lekë.

**3.40.** Pas analizimit të origjinës së shumës së investuar në bono thesari dhe ligjshmërisë së krijimit të tyre, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2000 – 2003<sup>125</sup>, për shumën e investuar deri në fund të vitit 2003, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 6.419.993 lekë për investimin në bono thesari, krijimin e likuiditeteve *cash* dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 2000 – 2003<sup>126</sup>.

**3.41.** Ndërkohë që nga analiza financiare e vitit 2004, për të verifikuar burimet e ligjshme të investimit prej 450.000 lekësh, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për të kryer këtë investim.

**3.42.** *Kësti i dytë, datë 19.2.2007, vlera 12.000 euro* – Komisioni konstaton se për pagesën e këtij kësti janë përdorur kursimet e akumuluar *cash*, referuar arsyetimit në paragrafin (v) të pikës 2 lidhur me likuiditetet *cash*.

**3.43.** Për këtë arsye, Komisioni analizoi krijimin e këtyre likuiditeteve *cash* deri në fund të vitit 2006, konkretisht: (i) vlerën 5.000.000 lekë deri në fund të vitit 2003; (ii) shtesën 400.000 lekë për vitin 2005; (iii) shtesën 400.000 lekë për vitin 2006.

**3.44.** Në kushtet që periudha 2000 – 2003 është trajtuar më sipër, Komisioni vijoi me analizën financiare për vitet 2005 – 2006, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personave të lidhur.

**3.45.** Për sa i përket vitit 2006, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme vetëm për krijimin e kursimeve prej 400.000 lekësh, Komisioni e kreu analizën financiare të këtij viti duke e ndarë në dy fragmente, konkretisht: (i) për krijimin e likuiditeteve *cash*, duke përjashtuar apartamentin dhe burimin e tij; (ii) për apartamentin, duke i qëndruar vetëm burimeve të deklaruara (tërheqjes së bonove të thesarit dhe dy huave).

---

<sup>124</sup> Pasqyrat e detajuara të transaksioneve të kryera, paraqitur nga subjekti në pyetësin standard dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2023, nga Banka e Shqipërisë. Veprimet e detajuara sipas datave u paraqitën tek “Tabela e transaksioneve të investimit në bono thesari (depozitime, investime, interesa të tërhequr, tërheqje)” dhe u përfshinë në aneksin nr. 1, në faqen me emërtim “Bono thesari”.

<sup>125</sup> Periudhat paraardhëse janë trajtuar në pasurinë nr. 1 (banesa \*\*\*).

<sup>126</sup> Kjo vlerë përbëhet nga: (i) mungesë në vlerën 1.479.527 lekë për investimin në bono thesari prej 2.850.000 lekësh (pra vetëm diferenca prej 1.370.473 lekësh përbën burime financiare të ligjshme); (ii) mungesë në vlerën 4.940.466 lekë<sup>126</sup> për krijimin e likuiditeteve *cash* (5.000.000 lekë).

**3.46.** Nga analiza financiare e vitit 2005 rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme në vitin 2005 për krijimin e kursimeve në vlerën 400.000 lekë, ndërsa referuar analizës financiare të vitit 2006, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 1.211.747 lekë për krijimin e kursimeve dhe kryerjen e shpenzimeve (duke përjashtuar analizën e kryer për pagesën e këstit të parë për apartamentin).

**3.47.** *Kësti i tretë, datë 8.4.2009, vlera 500 euro* – nga analizimi i llogarive bankare pranë “Credins Bank” dhe “Raiffeisen Bank” u konstatua se subjekti dhe bashkëshortja kanë tërhequr nga llogaria e pagës likuiditete të mjaftueshme dhe, për rrjedhojë, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të kryer pagesën e këstit me vlerë 500 euro, në datën 8.4.2009.

**3.48.** *Kësti i katërt, datë 15.5.2010, vlera 4.000 euro* – Komisioni konstaton se për pagesën e këtij kësti janë përdorur kursimet e akumuluar *cash*, referuar arsytimit në paragrafin (vii) të pikës 2 lidhur me likuiditetet *cash*.

**3.49.** Për këtë arsye, Komisioni analizoi krijimin e këtyre likuiditeteve tyre gjatë periudhës 2008 – 2009, nga ku rezultoi se në vitin 2008 janë shtuar 500.000 lekë, ndërsa gjatë vitit 2009 nuk ka pasur as shtesa dhe as pakësime. Pas kryerjes së analizës financiare për vitin 2008, vetëm për verifikimin e burimeve të likuiditeteve *cash* dhe duke përjashtuar investimin<sup>127</sup>, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme në vitin 2008 për krijimin e kursimeve në vlerën 500.000 lekë dhe për kryerjen e shpenzimeve. Për rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e këstit prej 4.000 euro për apartamentin.

**3.50.** *Kësti i pestë, datë 17.3.2014, vlera 10.000 euro* – siç është trajtuar në paragrafët përkatës, në DIPP-të vjetore nuk ka asnjë gjurmë lidhur me pagesën e këtij kësti apo shpjegim lidhur me burimin. Gjithashtu, mandati i paraqitur në pyetësorin standard mban datën 17.3.2016, por referuar shpjegimeve të subjektit, kjo pagesë është kryer më 17.3.2014 [referojuni arsytimit në paragrafin (viii) të pikës 2].

**3.51.** Në kushtet që nuk mund të konsiderohet pakësimi i kursimeve *cash* të akumuluar, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.1.2014 – 17.3.2014, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.337.908 lekë për shlyerjen e këstit prej 10.000 euro në datën 17.3.2014.

**3.52. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimet se: *(i) Nuk krijohet bindja se subjekti ka marrë hua nga shtetasit K. D. dhe L. C., çka do të thotë se nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, pasi: nuk janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2006, por janë deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010, vit në të cilin është deklaruar edhe apartamenti; nuk provohet koha*

---

<sup>127</sup> Konkluzioni lidhur me mungesën e burimeve për kryerjen e investimit është trajtuar në paragrafin 1.96 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

reale e dhënies së huave, pasi referuar dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja, rezulton se subjekti ka dorëzuar pranë këtij institucioni dy deklarata të thjeshta, të hartuara me shkrim dore në qershor 2006 (jo të noterizuara), ndërkohë në deklaratën Vetting, subjekti ka dorëzuar dy deklarata të thjeshta (jo të noterizuara), datë 24.1.2017, ku shtetasit K. D. dhe L. C. deklarojnë se i kanë dhënë subjektit hua në vitin 2006; konstatohen deklarime kontradiktore nga ana e subjektit lidhur me kohën e marrjes së këtyre huave në deklaratën Vetting, në pyetësorin standard dhe dokumentin vërtetim nënshkrimi nr.\*\*\*, datë 30.12.2010, hartuar para dhomës së noterit publik A. P.; subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2006 – 2010 detyrimin ndaj huamarrësve, referuar nenit 4, shkronja “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. (ii) Mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të provuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, të ndjerit K. D. për huan në shumën 27.000 euro<sup>128</sup>. (iii) Mungon dokumentacioni ligjor justifikues për të provuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, shtetasit L. C. për huan 14.000 euro<sup>129</sup>. (iv) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në vlerën totale 5.780.835 lekë, e përbërë nga mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 4.042.927 lekë për shlyerjen e këstit 47.500 euro, në vitin 2006, si pasojë e: (a) mungesës në vlerën 1.479.527 lekë për investimin në bono thesari prej 2.850.000 lekësh; (b) mungesës së mundësive financiare për dhënien e huave nga ana e shtetasve K. D. dhe L. C.; mungesës së burimeve financiare të ligjshme në vlerën 400.000 lekë për krijimin e kursimeve cash në vitin 2006, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e këstit 12.000 euro, në vitin 2007; mungesës së burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1.337.908 lekë për shlyerjen e këstit 10.000 euro, në datën 17.3.2014. (v) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 1.211.747 lekë, në vitin 2006, e përbërë nga: (a) mungesë prej 400.000 lekësh për krijimin e kursimeve cash; (b) mungesë prej 811.747 lekësh për kryerjen e shpenzimeve. (vi) Lidhur me likuiditetet cash prej 5.000.000 lekësh të deklaruara në DPV/2003, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 4.940.446 lekë për krijimin e këtyre likuiditeteve.

### **3.53. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi sa vijon:**

**3.54.** Lidhur me huan në vlerën 27.000 euro, subjekti shpjegoi se i ndjeri K. D. është marrë me aktivitet tregtar që në vitin 1995. Ai ka pasur dy aktivitete tregtare, në fushën e laboratorëve mjekësore dhe shitjen e barnave, depo farmaceutike e produkte të tjera kozmetike, mjekësore etj., aktivitete të cilat kanë pasur një marzh fitimi të kënaqshëm dhe avantazhe fitimprurëse për faktin se konkurrenca ishte e papërfillshme dhe tregu ishte i etur. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në atë kohë, z. K. D. ka pasur në banesë gjendje *cash*, me burim nga shitja e bonove të thesarit me vlerë totale 9.358.539 lekë dhe se prej këtyre, si dhe aktiviteteve të tjera familjare, ka pasur mundësi për t'i dhënë vlerën e huas.

**3.55.** Subjekti deklaroi se, në kushtet kur kunati ka ndërruar jetë, e ka objektivisht të pamundur të dijë se nga cili burim apo cili aktivitet tregtar është origjina e shumës prej 27.000 euro që i ka

<sup>128</sup> Paragrafi 3.41 i relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

<sup>129</sup> Paragrafi 3.52 i relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

marrë hua, në një kohë që ai ka tërhequr nga Banka e Shqipërisë shumën 9.358.539 lekë. Këto shuma të depozituara mundet të jenë tërhequr prej tij në shoqëritë e tij dhe të jenë kthyer më pas në shoqëri dhe në kushtet e mungesës së pasqyrave financiare të atyre viteve, Komisioni duhet të ketë në konsideratë parashikimet ligjore mbi pamundësinë objektive për sigurimin e informacionit, përfundoi subjekti. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti praktikën e akteve origjinale datë 30.5.2006, lëshuar nga Banka e Shqipërisë, çka sipas tij, provon ligjshmërinë e burimit të shumës së përfituar nga kunati dhe mundësinë e dhënies së huas.

**3.56.** *Lidhur me huan në vlerën 14.000 euro* – subjekti deklaroi se shtetasi L. C., në kohën e huadhënies, kishte një periudhë emigracioni 10-vjeçare dhe mundësia që një emigrant të kursejë një shumë prej 10.000 euro për një periudhë të tillë është më se e mundur. Subjekti kërkoi të pyetet në cilësinë e dëshmitarit shtetasi L. C. dhe kërkoi të riçelet hetimi administrativ.

Subjekti gjithashtu kërkoi të merren parasysh rrethanat si objektiviteti, proporcionaliteti, fakti që ushtron aktivitet, nuk kanë qenë deklaruar në DIPPV-të koha e gjatë e kaluar nga dhënia e huas, si edhe të mbahet në konsideratë se shtetasi L. C. ka qenë i pajisur me leje qëndrimi në shtetin italian dhe se nuk ka *indicie* që këto të ardhura dhe fitimi i tyre të jetë nga aktivitete të paligjshme.

**3.57.** *Në lidhje me blerjen e apartamentit me sip. 95.26 m<sup>2</sup>* – fillimisht subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 4.5.2023, lëshuar nga shtetasi B. P., vëllai i administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k, shtetasi Q. P., lidhur me blerjen dhe likuidimin e vlerës së këtij apartamenti, si dhe dëmtimin e dokumentacionit të shoqërisë.

**3.58.** *Lidhur me mundësitë financiare për investimin në bono thesari*, subjekti i rivlerësimit paraqiti dy tabela të analizës financiare, konkretisht për periudhën 1992 – 1999, ku pasqyrohet një balancë pozitive prej 3.067.191 lekësh, dhe për periudhën 2000 – 2003, ku pasqyrohet një balancë pozitive prej 12.912 lekësh. Këto analiza financiare tregojnë qartë mundësinë financiare të investimit në bono thesari, si dhe gjithashtu të disponimit të shumës së gjendjes së *cash* në banesë, por edhe të investimit në banesën në \*\*\*, sqaroi subjekti.

**3.59.** Gjithashtu, subjekti pretendoi se analiza financiare e kryer për vitet 2005 – 2006 ka gabime në ndërtimin e saj, pasi ajo nuk merr në konsideratë asnjë burim nga huat dhe, gjithashtu, edhe nga bonot e thesarit, pra praktikisht eliminon burimet e të ardhurave të deklaruara. Subjekti i rivlerësimit paraqiti analizën financiare për vitin 2006 të përpiluar nga ana e tij, ku pasqyrohet një balancë pozitive prej 1.296.676 lekësh.

**3.60.** *Lidhur me analizën financiare të kryer nga Komisioni për pagesën e këstit prej 10.000 euro në vitin 2014*, subjekti pretendoi se kjo analizë nuk është korrekte dhe nuk i përgjigjet një logjike ekonomike. Sipas tij, pamundësia financiare në shumën 1.337.908 lekë për të paguar këstin dhe në të njëjtën kohë të disponojë një gjendje monetare *cash* në banesë në shumën 5.592.000 lekë, janë dy gjëra që bien ndesh me njëra-tjetrën. Subjekti pretendoi se, nëse për të dalë në këtë konkluzion do të përdoret argumenti që nuk është deklaruar në deklaratën periodike pakësimi i gjendjes *cash*, atëherë do të duhet të merret në konsideratë deklarimi i kryer pranë ILDKPKI-së sipas procesverbalit datë 26.2.2016, ku është deklaruar se i gjithë detyrimi ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. është shlyer në vitin 2014, pasi ky vërtetim konfirmon kryerjen e pagesave gjatë periudhës 2006 – 2014. Gjithashtu, në këtë procesverbal është deklaruar edhe gjendja e mbetur *cash* në



shumën 850.000 lekë në fund të vitit 2014, theksoi subjekti. Në përfundim, subjekti paraqiti analizën financiare të përpiluar nga ana e tij, për vitin 2014, ku vërehet një balancë vjetore pozitive në vlerën 618.396 lekë.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**3.61.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

**3.62.** Subjekti nuk e ka deklaruar poroshtjen e këtij apartamenti në DIPP-në e vitit 2006 bazuar në parashikimet e shkronjës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, sipas të cilit, mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to. Deklarimet e subjektit në DIPP-në e vitit 2010 lidhur me mosdhënien nga ana e firmës të një kontrate me shkrim, nuk janë të vërteta, pasi nga hetimi rezultoi se kontrata e porosisë e vitit 2006 është lidhur përpara noterit publik dhe është nënshkruar personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, në datën 7.6.2006. Gjithashtu, subjekti nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., referuar nenit 4, shkronja “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, lidhur me detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, sipas deklaratimeve të mëvonshme të subjektit në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ në Komision.

**3.63.** *Lidhur me vërtetësinë e deklaratimeve për 2 huat e deklaruara si burim për blerjen e apartamentit*, në prapësimet e tij, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë shpjegim dhe nuk paraqiti prova lidhur me dyshimet e ngritura nga Komisioni se nuk krijohet bindja se subjekti ka marrë hua nga shtetasit K. D. dhe L. C., për shkak se: (i) këto hua nuk janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2006, por janë deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010, vit në të cilin është deklaruar edhe apartamenti; (ii) nuk provohet koha reale e dhënies së huave, pasi referuar dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja, rezulton se subjekti ka dorëzuar pranë këtij institucioni dy deklarata të thjeshta, të hartuara me shkrim dore në qershor 2006 (jo të noterizuara), ndërkohë në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar dy deklarata të thjeshta (jo të noterizuara), datë 24.1.2017, ku shtetasit K. D. dhe L. C. deklarojnë se i kanë dhënë subjektit hua në vitin 2006; (iii) konstatohen deklarime kontradiktore nga ana e subjektit lidhur me kohën e marrjes së këtyre huave në deklaratën *Vetting*, në pyetësonin standard, dhe dokumentin vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\*, datë 30.12.2010, hartuar para dhomës së noterit publik A. P.; (iv) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2006 – 2010 detyrimin ndaj huamarrësve, referuar nenit 4, shkronja “dh” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003; (v) personat e tjetër të lidhur/huadhënësit nuk kanë burime të ligjshme financiare, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues për dhënien e huave në shumat 27.000 euro dhe 14.000 euro.

**3.64.** Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri.

**3.65.** Sa më lart, për efekt të analizës financiare nuk u pasqyrua marrja e këtyre huave në analizën e kryer për vitin 2006 dhe, për rrjedhojë, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 3.775.147 lekë<sup>130</sup> për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2006<sup>131</sup>.

**3.66.** Më tej, Komisioni mori në shqyrtim analizën financiare për periudhën 2000 – 2003, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të analizimit të burimit për kryerjen e investimit në bono thesari (të përdorura për blerjen e apartamentit në vitin 2006), ku u konstatua se në fillim të periudhës është mbartur balanca pozitive prej 3.067.191 lekësh, vlerë e cila kishte rezultuar nga analiza financiare e kryer nga ana e subjektit për periudhën 1992 – 1999.

**3.67.** Ndërkohë që, sipas trajtimit dhe arsytimit në paragrafët përkatës, Komisioni arriti në konkluzionin se referuar analizës financiare të kryer për periudhën 1992 – 1999, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme për kryerjen e investimit (paragrafi 1.98) dhe, për rrjedhojë, Komisioni rishikoi analizën financiare për periudhën 2000 – 2003, duke saktësuar vetëm dy elemente të saj, konkretisht: (i) të ardhurat nga shitja e apartamentit në Mat, të cilat u pasqyruan në vlerën 950.000 lekë dhe gjendja e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, e cila u pasqyrua në vlerën 2.150.000 lekë.

**Tabela nr. 1 – analiza financiare për periudhën 2000 – 2003**

Periudha	Përshkrim	Të ardhura	Shpenzim /pasuri	Gjendje progresive
2000	Të ardhura nga paga subjekti	449,284		449,284
2000	Të ardhura nga paga bashkëshortja		-	449,284
2000	Shpenzime jetese 4 persona		423,000	26,284
2001	Të ardhura nga paga subjekti		702,800	729,084
15.11.2001	Të ardhura nga shitja e apartamentit në ***		950,000	1,679,084
2001	Të ardhura nga paga bashkëshortja		79,242	1,758,326
2001	Shpenzime jetese 4 persona		432,000	1,326,326
2002	Të ardhura nga paga subjekti		675,499	2,001,825
2002	Të ardhura nga paga bashkëshortja		124,468	2,126,293
2002	Shpenzime jetese 4 persona		375,456	1,750,837
3.9.2002	Investim në bono thesari (depozitim bashkëshortja)		500,000	1,250,837
11.9.2002	Investim në bono thesari (depozitim bashkëshortja)		500,000	750,837
24.9.2002	Interesa nga bonot e thesarit		55,082	805,919
6.12.2002	Investim në bono thesari (depozitim bashkëshortja)		550,000	255,919
17.12.2002	Interesa nga bonot e thesarit		61,414	317,333
2003	Të ardhura nga paga subjekti		617,360	934,693
2003	Të ardhura nga paga bashkëshortja		337,239	1,271,932
2003	Shpenzime jetese 4 persona		375,456	896,476
2000-2003	Shpenzime arredimi (pyetësori nr. 1)		400,000	496,476
17.2.2003	Investim në bono thesari (depozitim bashkëshortja)		400,000	96,476
21.2.2003	Interesa nga bonot e thesarit		44,032	140,508

<sup>130</sup> E përbërë nga: (i) mungesë në vlerën 1.211.747 lekë për krijimin e kursimeve *cash* prej 400.000 lekësh dhe për kryerjen e shpenzimeve; dhe (ii) mungesë në vlerën 2.563.400 lekë për blerjen e apartamentit (konkluzioni për investimin në bono është i përfshirë në analizën financiare të periudhës 2000 – 2003).

<sup>131</sup> Konkluzioni për ligjshmërinë e krijimit të bonove të thesarit është reflektuar në analizën dhe përfundimin e arritur pas kryerjes së analizës financiare për periudhën 2000 – 2003.

26.3.2003	Interesa nga bonot e thesarit	48,904		189,412
31.3.2003	Investim në bono thesari (depozitim bashkëshortja)		500,000	-310,588
9.4.2003	Interesa nga bonot e thesarit	53,484		-257,104
9.9.2003	Investim në bono thesari (depozitim bashkëshortja)		200,000	-457,104
19.9.2003	Interesa nga bonot e thesarit	47,967		-409,137
22.10.2003	Shpenzime për blerje automjeti me targë ***		354,676	-763,813
8.12.2003	Investim në bono thesari (depozitim bashkëshortja)		200,000	-963,813
12.12.2003	Interesa nga bonot e thesarit	59,534		-904,279
2003	Gjendje likuiditete <i>cash</i> (jashtë sistemit bankar)		2,150,000	-3,054,279
	<b>TOTALI</b>	<b>4,306,309</b>	<b>7,360,588</b>	<b>-3,054,279</b>

**3.68.** Në përfundim të analizës financiare të kryer për periudhën 2000 – 2003, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 3.054.279 lekë për kryerjen e shpenzimeve, investimin në bono thesari dhe shtesën në kursime.

**3.69.** Lidhur me pretendimet e subjektit për konkluzionet që i përkasin pagesës së kështit prej 10.000 euro, e konkretisht lidhur me pretendimin se Komisioni po përdor si argument mosdeklarimin e pakësimit të likuiditeteve *cash* në DIPP-në e vitit 2014, është me rëndësi të theksohet se ligji nr. 9049/2003 përcakton detyrimin e subjektit deklarues për të deklaruar në formën e kërkuar, formë e cila nuk është një detyrim alternativ në varësi të vullnetit të subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar.

**3.70.** Referuar nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003<sup>132</sup>, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, “në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë [...]”, detyrim i cili nuk rezulton të jetë përmbushur nga ana e subjektit në lidhje me pakësimin e pretenduar.

**3.71.** Në analizën financiare të vitit 2014, të paraqitur nga subjekti<sup>133</sup>, konstatohet se zëri ndryshim likuiditeti pasqyrohet në vlerën -1.545.378 lekë<sup>134</sup>, përkundrajt vlerës +346.622 lekë<sup>135</sup> të përlllogaritur nga Komisioni, pra subjekti ka pasqyruar një diferencë (pakësim) prej 1.892.000 lekësh.

**3.72.** Për sa kohë pakësimi i likuiditeteve *cash* nuk është deklaruar në DIPP-në përkatëse, sipas legjisllacionit në fuqi, ai nuk mund të konsiderohet si burim për efekt të kryerjes së analizës financiare.

<sup>132</sup> Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, me ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006, me ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006, me ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012 dhe me ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014.

<sup>133</sup> Analiza financiare e paraqitur nga subjekti është kryer për të gjithë vitin kalendarik, ndërkohë që kështu është paguar në datën 17.3.2014.

<sup>134</sup> Nëse i zbrisim kësaj vlere ndryshimin e likuiditeteve në llogaritë bankare në shumën 96.622 lekë, rezulton se subjekti ka pakësuar likuiditetet *cash* me një vlerë prej 1.642.000 lekësh (përfshirë këtu edhe shtesën e pretenduar prej 250.000 lekësh).

<sup>135</sup> Shtesë likuiditetesh *cash* 250.000 lekë, shtesë likuiditetesh në bankë 96.622 lekë.

**3.73.** Për rrjedhojë, mbetet i pandryshuar konkluzioni se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 1.337.908 lekë për shlyerjen e këstit prej 10.000 euro, në datën 17.3.2014, për blerjen e apartamentit në Tiranë.

**3.74. Në konkluzion, të sa më lart arsyetuar,** Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të kësaj pasurie si edhe nga analiza financiare rezultoi se subjekti, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare: (i) për kryerjen e shpenzimeve, investimin në bono thesari dhe shtesën në kursime, në vlerën 3.054.279 lekë, për periudhën 2000 – 2003; (ii) në vlerën 3.775.147 lekë për vitin 2006, për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve; (iii) në vlerën 1.337.908 lekë për shlyerjen e këstit prej 10.000 euro, në datën 17.3.2014, për blerjen e apartamentit në Tiranë, duke mos plotësuar përcaktimet e shkronjave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

#### **4. Automjete**

**4.1. Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\* (vit prodhimi 1985)** – në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti ka deklaruar blerjen e një automjeti me targë \*\*\*, me vlerë 300.000 lekë.

**4.2.** Në pyetësin standard subjekti ka dorëzuar kontratën nr.\*\*\*, datë 22.10.2003, sipas së cilës ka blerë nga shtetasi K. A. automjetin tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 1985, në vlerën 190.000 lekë. Në kontratë është përcaktuar se blerësi do të kryejë zhdoganimin e mjetit.

**4.3.** Në përgjigje të pyetësin nr. 1, subjekti deklaroi se në çmimin e deklaramit të blerjes dhe më pas të shitjes kanë ndikuar edhe shpenzimet e zhdoganimit të mjetit. Me insistimin e shitësit, zhdoganimi i mjetit është bërë nga vetë ai, ndonëse në kontratë është theksuar se duhet ta bëjë blerësi. Subjekti shpjegoi se, në dakordësi me shitësin, i ka paguar *cash* këtij të fundit shumën 110.000 lekë, ndaj edhe në deklaramin e vitit 2003 ka theksuar vlerën e mjetit në shumën 300.000 lekë. Referuar dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja dhe DPD-ja<sup>136</sup>, rezulton se mjeti është zhdoganuar nga shtetasi K. A. sipas vërtetimit të datës 24.10.2003 dhe deklaramës doganore në të njëjtën datë, me çmim 200.000 lekë dhe shpenzime doganore në shumën 154.676 lekë, në total 354.676 lekë.

**4.4.** Sa më lart, për efekt të analizës financiare, Komisioni konsideroi një kosto totale prej 354.676 lekësh. Duke iu referuar analizës financiare për periudhën 2000 – 2003, duket se në datën 22.10.2003, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti. Për sa i përket shitjes së këtij automjeti, në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja në vlerën 200.000 lekë, çka provohet me vërtetim nënshkrimi nga noteri nr. \*\*\* rep., datë 17.8.2005.

**4.5. Në konkluzion,** nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë

---

<sup>136</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2023, nga DRSHTRR-ja (paraqitur nga subjekti) dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (hetimi i Komisionit).

pasuri dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

**4.6. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\* (vit prodhimi 1990)** – në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar se ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, prodhim i vitit 1990, në vlerën 150.000 lekë. DRSHTRR-ja<sup>137</sup> informon se në emër të subjektit Petrit Hysa ka qenë i regjistruar mjete me targë \*\*\*. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur, subjekti e ka blerë këtë automjet me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 17.6.2010, nga z. E. H., me çmim 150.000 lekë. Mjeti është importuar nga shitësi në datën 24.8.2003. Më pas, subjekti ia ka shitur këtë mjet shtetas K. B., me kontratë nr. \*\*\*, datë 16.6.2016, në shumën 200.000 lekë, ndërkohë nga kontrolli i kryer në AMF, polica e fundit e sigurimit për këtë mjet është prerë nga subjekti në vitin 2015.

Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare në datën 17.6.2010, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targë \*\*\*.

**Në konkluzion**, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

**4.7. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*** – fillimisht në përdorim, pastaj në pronësi – në pyetësin standard subjekti ka deklaruar se në vitin 2016, ai dhe djali i tij A. H. kanë pasur një prokurë të lëshuar nga shtetasi E. D., për të përdorur automjetin në pronësi të tij, tip “Mercedes-Benz C200”, prodhim i vitit 2011, me targa \*\*\*. Ky mjet është përdorur për një periudhë shumë të shkurtër nga djali i tij, rreth një apo dy muaj dhe më pas, shtetasi E. D. ka tërhequr prokurën. Subjekti ka dorëzuar një deklaratë të thjeshtë (jo para noterit) datë 7.7.2020, sipas së cilës shtetasi E. D. ka deklaruar se në muajin shkurt të vitit 2016 i ka lëshuar një prokurë shtetasve Petrit dhe A. H. për të përdorur automjetin në pronësinë e tij tip “Mercedes-Benz C-200”, prodhim i vitit 2011, me targa \*\*\*. Ky automjet është përdorur në disa raste të veçanta nga A. H.. Prokura është tërhequr brenda muajit shkurt dhe aktualisht nuk posedon kopje të saj. Ai deklaron se nuk është paraqitur para ndonjë noteri për të deklaruar tërheqjen e saj, gjë për të cilën nuk ka pasur njohuri.

**4.8.** Në vitin 2018 ky automjet është blerë nga djali i subjektit, me kontratën nr. \*\*\*, datë 30.3.2018, referuar deklaratimit të subjektit në pyetësin standard<sup>138</sup>. DRSHTRR-ja<sup>139</sup> konfirmon se ky automjet i regjistruar në emër të shtetasit A. H. dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, mjeti është blerë nga shitësi E. D. me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 30.3.2018, me çmim 800.000 lekë. Rezulton se z. E. D. e ka blerë këtë automjet nga shtetasi G. R., me kontratën nr. \*\*\*, datë 12.2.2016, në vlerën 7.000 euro.

**4.9.** Në DIPP-në e vitit 2018, personi i lidhur A. H. ka deklaruar se me kontratën nr. \*\*\*, datë 30.3.2018, me kursimet familjare (të prindërve) ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” në

---

<sup>137</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2020.

<sup>138</sup> Subjekti ka deklaruar se me kursimet familjare ka blerë një automjet tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2011, me targa \*\*\*, në shumën 800.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat familjare, shpenzuar gjendja *cash* në banesë, regjistruar në emër të djalit A. H..

<sup>139</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2020.

shumën 800.000 lekë. Me anë të pyetësorit nr. 1, subjektit iu kërkua të paraqesë prokurën e lëshuar nga z. E. D. për përdorimin e mjetit tip “Mercedes-Benz C200”, prodhim i vitit 2011, me targa \*\*\*, si dhe të shpjegojë marrëdhënien me shtetasin E. D.. Në përgjigje, subjekti deklaroi se me gjithë interesimin e tij nuk është bërë e mundur gjetja e prokurës së përdorimit. Marrëdhënia familjare e subjektit me shtetasin E. D. është njohje shoqërore.

**4.10.** Nga hetimi pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Tiranë<sup>140</sup> nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin E. D. Nga kontrolli i kryer në AMF, referuar policave të sigurimit, automjeti rezultoi në pronësi të shtetasit A. H. nga viti 2018 e deri më sot dhe më parë në emër të z. E. D. në vitet 2016 – 2018. Djali i subjektit A. H. rezultoi përdorues në vitin 2018, ndërkohë që E. D. figuron pronar i këtij automjeti.

**4.11. Komisioni vëren se** djali i subjektit A. H. ka blerë të njëjtin mjet, të cilin subjekti deklaroi se e ka pasur në përdorim në vitin 2016. Rezultoi se sapo është blerë, po në shkurt të vitit 2016, mjeti i është dhënë në përdorim subjektit dhe djalit të tij A. H..

**4.12. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me konstatimin se: *Djali i subjektit A. H. ka blerë të njëjtin mjet tip “Mercedes-Benz C200”, prodhim i vitit 2011, me targa \*\*\*, të cilin subjekti deklaroi se e ka pasur në përdorim në vitin 2016, ky mjet sapo është blerë në shkurt të vitit 2016, i është dhënë në përdorim subjektit dhe djalit të tij A. H., çka ngre dyshime mbi të drejtat reale që subjekti dhe djali i tij gëzojnë mbi këtë automjet.*

**4.13. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës,** deklaroi se: Referuar deklaratës noteriale të lëshuar nga shtetasi Sh. D. (vëllai i shtetasit E. D.) të shoqëruar me Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit person fizik “Sh. D.” dhe formularit të deklarimit të pagesës së tatimit mbi fitimin të këtij subjekti tregtar, provohet se shtetasi Sh. D. nga të ardhurat nga aktiviteti i bizneseve dhe kursimet familjare ka pasur mundësi dhe i ka dhuruar vëllait të tij shtetasit E. D. (për shkak të lidhjes gjinore shumë të afërt, vëlla), vlerën prej 950.000 lekësh për të blerë autoveturë për nevojat e tij personale e familjare. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale të shtetasit Sh. D., ekstraktin historik, formularin e deklarimit dhe pagesën e tatimit mbi fitimin e këtij subjekti. Në prapësime, subjekti kërkoi të pyetet në cilësinë e dëshmitarit shtetasi Sh. D..

Më tej, në seancën dëgjimore subjekti paraqiti dokumentacion shtesë për të provuar të ardhurat e subjektit person fizik “Sh. D.” dhe mundësinë e shtetasit Sh. D. për dhurimin e vlerës prej 950.000 lekësh, e cila ka shërbyer për blerjen e autoveturës nga ana e shtetasit E. D.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**4.14.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe

<sup>140</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022 dhe \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

**4.15.** Marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit dhe djalit të tij me këtë automjet në kuptim të parashikimeve të Kodit Civil dhe të ligjit nr. 84/2016, është një marrëdhënie juridiko-civile e huapërdorjes, ku subjekti ka fituar të drejtën e përdorimit mbi këtë send, sipas parashikimeve të nenit 901 të Kodit Civil. Këto të drejta janë gëzuar realisht prej subjektit, sipas pohimeve të vetë atij. Por për sa kohë nuk u ngritën dyshime mbi ligjshmërinë e fitimit të kësaj pasurie, zbehet mundësia për të fshehur ndonjë burim të paligjshëm, për shkak të mosjustifikimit të tyre.

**4.16.** Për sa më sipër, nuk plotësohet kushti kushtetues i parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, që të mbështesë parashikimin ligjor të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 për ta konsideruar këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit si fshehje pasurie, por mbetet vetëm në kuadër dyshimi nga ana e Komisionit.

## **5. Analiza financiare**

**5.1.** Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1992 – 2016 për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, duke i vendosur në dispozicion subjektit të rivlerësimit aneksin nr. 1 me emërtim “Analiza financiare” dhe aneksin nr. 2, me emërtim “Metodika e analizës financiare”.

**5.2. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës më sipër, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimet se: *Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në datat e krijimit të pasurive, në një vlerë totale prej 16.257.688 lekësh, të detajuar si në vijim: (i) për periudhën 1992 – 2003, mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 9.527.064 lekë; (ii) për vitin 2006, mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 3.775.147 lekë; (iii) për vitin 2008, mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 1.617.569 lekë; (iv) për vitin 2014, mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 1.337.908 lekë në datën 17.3.2014.*

**5.3. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës** deklaroi se analiza financiare e kryer nga Komisioni ka mangësi dhe pasaktësi lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e përllogaritura. Konkretisht, analiza financiare e kryer nuk përfshin të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i avokatisë, përllogarit një shpenzim në ndërtimin e banesës në \*\*\* në një vlerë tej vlerës reale të investuar, përfshin investimin e kryer nga kunati dhe motra e subjektit, si një shpenzim (investim) të kryer nga vetë subjekti, vijoi subjekti. Gjithashtu, në trajtimin e kryer për ndërtimin e analizës financiare nuk janë marrë në konsideratë huat e marra nga z. D. dhe z. C., por është përfshirë vetëm likuidimi i huave të marra, duke përdorur një standard të dyfishtë, pasi nuk njihen si të ardhura, por njihen si shpenzim.

Subjektit i rivlerësimit pretendoi se të gjitha këto trajtime të gabuara kanë sjellë një analizë financiare të deformuar dhe të gabuar, dhe më tej ai paraqiti analizën financiare vjetore të përpiluar nga ana e tij dhe deklaroi se në asnjë vit kalendarik nuk rezulton me diferenca negative. Referuar kësaj analize, shpjegoi subjekti, të ardhurat në total janë në shumën 32.360.779 lekë dhe pasuria

neto në vlerën 13.628.387 lekë dhe se nga diferenca e të ardhurave neto me pasurinë neto ndër vite rezulton një diferencë pozitive në shumën 6.696.957 lekë, tej çdo dyshimi për pamundësi financiare në krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**5.4.** Pretendimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga avokatia, vlera e kostos së ndërtimit të banesës në \*\*\*, investimi i deklaruar i kryer nga motra dhe kunati i subjektit të rivlerësimit, si edhe marrja e dy huave janë trajtuar dhe arsyetuar në paragrafët përkatës të këtij vendimi.

**5.5.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me mosparaqitjen në analizën financiare të huave, por vetëm të shlyerjeve të kryera për këto hua, Komisioni vlerëson se, në kushtet që subjekti nuk arriti ta përmbysë barrën e provës lidhur me marrjen e këtyre huave (trajtuar në paragrafët përkatës të këtij vendimi), shkak që passolli përfundimisht mospërfshirjen e tyre në analizën financiare të vitit 2006, të mos paraqesë në analizën financiare as shumatat e deklaruara të shlyerjeve.

**5.6.** Në përfundim të analizave konkluduese të shprehura në këtë vendim, tabela financiare e përmbledhur, paraqitet në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 2 – analiza financiare**

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit
1992-2003	3,817,260	2,150,000	2,850,000	5,502,185	-	2,696,025	- 6,011,100	- 6,011,100
2004	-	-	450,001	1,434,986	-	397,678	587,307	-
2005	-	400,000	349,804	1,611,671	-	488,228	373,639	-
2006	10,108,564	400,000	- 3,121,709	1,430,998	3,271,160	1,090,450	- 3,775,147	- 3,775,147
2007	-	- 1,058,000	- 253,399	1,357,630	- 1,458,000	827,725	383,304	-
2008	1,670,054	500,000	- 101,315	1,376,042	-	924,872	- 1,617,569	- 1,617,569
2009	-	-	378,586	1,590,524	- 68,585	783,147	360,207	-
2010	150,000	- 500,000	322,784	1,641,849	- 545,160	1,109,995	13,910	-
2011	-	-	- 636,627	1,755,158		947,670	1,444,114	-
2012	-	300,000	- 200,002	1,785,545		1,126,091	559,456	-
2013	-	300,000	- 26,138	1,850,578		983,987	592,729	-
2014	-	250,000	96,622	1,976,756	- 1,404,400	1,359,228	- 1,133,494	- 1,133,494
2015	-	155,343	35,802	1,984,615		1,323,586	469,884	-
2016	-	-	- 120,836	2,212,492		1,506,811	826,517	-
<b>TOTAL</b>	<b>15,745,878</b>	<b>2,897,343</b>	<b>23,574</b>	<b>27,511,029</b>	<b>- 204,985</b>	<b>15,565,494</b>	<b>- 6,926,244</b>	<b>-12,537,310</b>

**5.7.** Në përfundim, referuar konkluzioneve mbi balancat negative në momentin e krijimit të pasurive, trajtuar në seksionin përkatës të pasurive, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare me një vlerë totale prej 12.741.724 lekësh<sup>141</sup>, për

<sup>141</sup> (i) Mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e punimeve për gërmimin, hedhjen e themeleve dhe përfundimin e katit të parë (përdhe), deri në fund të vitit 1999, në vlerën 2.956.821 lekë; (ii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e investimit në vlerën 1.617.569 lekë në vitin 2008; (iii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e



blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**Në përfundim të rivlerësimit të kriterit të kontrollit të pasurisë, rezultoi se:**

*Lidhur me godinën e banimit 3 + 1 kat nën tokë, e ndodhur në \*\*\*, Tiranë*

- i. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të provuar të ardhurat e ligjshme nga ushtrimi i aktivitetit si avokat në vlerën 5.000.000 lekë, për periudhën 1993 - 1997, një pjesë e të cilave ka shërbyer për ndërtimin e banesës në \*\*\*, duke u gjendur në këtë mënyrë në plotësim të kushteve të parashikuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e punimeve për gjurmimin, hedhjen e themeleve dhe përfundimin e katit të parë (përdhe), deri në fund të vitit 1999, në vlerën 2.956.821 lekë, duke u gjendur në kushtet e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për kryerjen e investimit në vlerën 1.617.569 lekë në vitin 2008, dhe nuk ka deklaruar me vërtetësi këtë pasuri të krijuar, duke mos plotësuar përcaktimet e shkronjave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me gjendjen e likuiditeteve cash në shumën 1.050.000 lekë*

Pasaktësitë në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me gjendjen e likuiditeteve *cash* gjatë deklaratimeve të tij në ILDKPKI dhe gjatë hetimit në Komision e bëjnë në këtë rast deklaratimin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronja “a” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me apartamentin me sip. 95.26 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë*

Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të kësaj pasurie, si dhe nga analiza financiare rezultoi se subjekti, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare: (i) për kryerjen e shpenzimeve, investimin në bono thesari dhe shtesën në kursime, në vlerën 3.054.279 lekë, për periudhën 2000 – 2003; (ii) në vlerën 3.775.147 lekë për vitin 2006, për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve; (iii) në vlerën 1.337.908 lekë për shlyerjen e këstit prej 10.000 euro, në datën 17.3.2014, për blerjen e apartamentit në Tiranë, duke mos plotësuar përcaktimet e shkronjave “a”, “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\* (vit prodhimi 1985)*

---

shpenzimeve, investimin në bono thesari dhe shtesën në kursime, në vlerën 3.054.279 lekë, për periudhën 2000 – 2003; (iv) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 3.775.147 lekë për vitin 2006, për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve; (v) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën 1.337.908 lekë për shlyerjen e këstit prej 10.000 euro, në datën 17.3.2014, për blerjen e apartamentit në Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

*Lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\* (vit prodhimi 1990)*

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në lidhje me këtë pasuri dhe nuk konstatohen problematika, të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

### **Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\* – fillimisht në përdorim, pastaj në pronësi**

Nga analizimi i fakteve dhe rrethanave rreth kësaj pasurie nuk plotësohet kushti kushtetues i parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, që të mbështesë parashikimin ligjor të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 për ta konsideruar këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit si fshehje pasurie, por mbetet vetëm në kuadër dyshimi nga ana e Komisionit.

### **Lidhur me analizën financiare**

Referuar konkluzioneve mbi balancat negative në momentin e krijimit të pasurive të trajtuara më lart, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare me një vlerë totale prej 12.741.724 lekësh, për blerjen e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**Në konkluzion**, trupi gjykues i Komisionit çmon se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a” “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili e vë atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**1.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.8.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**2.** Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Petrit Hysa.

3. Komisioni, me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022, ka kërkuar përditësimin e raportit me materialet shtesë që mund të disponohen deri aktualisht. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga DSIK-ja, me anë të shkresës datë 6.1.2023, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*, datë 10.1.2023, rezulton se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin e rivlerësimit, çka nuk e ndryshon konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, duke konkluduar se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

1. Subjekti i rivlerësimit Petrit Hysa, në periudhat 15.7.1985 – 31.12.1985 dhe janar 1986 – tetor 1991 ka qenë i punësuar si hetues në Dibër dhe më pas në Mat. Me anë të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pogradec, detyrë të cilën e ka ushtruar për periudhën 6.12.1997 – 15.1.1999, ku me Dekretin e Presidentit datë 15.1.1999, është transferuar dhe emëruar zv/prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, funksion të cilin e ushtron deri aktualisht.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi” e ka miratuar këtë raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale dhe; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

#### **Aftësitë profesionale**

3. *Njohuritë ligjore* – në dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

4. *Arsyetimi ligjor* – subjekti i rivlerësimit, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar në masën “shumë mirë”, dokumentuar me aktet e lëshuara nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet përkatëse.

#### **Aftësitë organizative**

5. *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve, konstatohet se prokurori Petrit Hysa është përballur me një

ngarkesë të konsiderueshme pune duke treguar eficiencë në marrjen e vendimeve brenda një afati të arsyeshëm, referuar natyrës së çështjeve të hetuara.

### **Aftësia për të kryer procedurat hetimore**

**6.** Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimeve penale. Ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

### **Aftësia për të administruar dosjet**

**7.** Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të administruar dosjet.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

**8.** Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e vëzhguara nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

**9.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesëmarrje në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit profesional apo në shkëmbimin e eksperiencave, referuar vetëdeklarimit dhe akteve bashkëlidhur.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**10.** Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara dhe ankesat e paraqitura, duke kërkuar informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë<sup>142</sup>, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë<sup>143</sup>, Këshillit të Lartë të Prokurorisë<sup>144</sup> dhe Prokurorisë së Përgjithshme<sup>145</sup> në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri më sot.

**11.** Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit janë depozituar 3 ankesa: ankesa e shtetasit M. P., e vitit 2018; ankesa e shtetasës A. S. e vitit 2019 dhe ankesa e shtetasës L. X. e vitit 2022. Pasi u analizuan në mënyrë më të detajuar ankesat e paraqitura, vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.

---

<sup>142</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2022.

<sup>143</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2022.

<sup>144</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2022.

<sup>145</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2023.

**12.** Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2023, të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni vëren se ndaj subjektit janë depozituar 5 ankesa: ankesa e shtetasit J. B., e vitit 2020, është vendosur arkivimi i ankesës; ankesa e shtetasve L. e K. M., e vitit 2020, e cila ndodhet në fazën e shqyrtimit fillestar; ankesat e shtetasit V. Rr., të vitit 2020, është vendosur arkivimi i ankesave; ankesa e shtetasës D. D., e vitit 2021, është vendosur arkivimi i ankesës; ankesa e shtetasës L. G., e vitit 2022, është vendosur arkivimi i ankesës. Pasi u analizuan në mënyrë më të detajuar ankesat e paraqitura, vlerësohet se pretendimet ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit.

**13.** Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.1.2023, të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni vëren se ndaj subjektit janë depozituar 2 ankesa: ankesa nr. \*\*\* e vitit 2018, e shtetasës A. S. dhe ankesa nr. \*\*\*, e vitit 2022 e shtetasve L. e K. M. Më tej, rezultoi se:

i) Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 28.1.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, ndaj subjektit është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, për shkelje të urdhrin nr. \*\*\*, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”. Veprimet e prokurorit janë konsideruar si shkelje disiplinore të parashikuara në nenin 32 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni, pasi analizoi shkaqet e këtij vendimi<sup>146</sup>, vëren sa vijon:

**14.** Mbi bazën e hetimeve të kryera për procedimin penal nr. \*\*\*/2004, subjekti ka vendosur dërgimin për gjykim të të pandehurve A. Z. (ish-Drejtor i Burgut \*\*\* Tiranë) dhe D. C. (ish-shef i sektorit juridik të këtij burgu) me akuzën “shpërdorim detyre”, neni 248 i Kodit Penal. Në përfundim të gjykimit subjekti ka përgatitur me shkrim konkluzionet përfundimtare, duke kërkuar të deklarohen fajtorë të dy të pandehurit për krimin e shpërdorimit të detyrës, në bazë të nenit 248 të Kodit Penal dhe shtetasi A. Z. të dënohet me 1 vit burgim, ndërsa shtetasi D. C. me 1 vit e 6 muaj burgim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, dalë 3.11.2004, ka vendosur deklarinimin e pafajshëm për të dy të pandehurit duke argumentuar se mungojnë elementet e anës subjektive të figurës së shpërdorimit të detyrës, por nga tërësia e rrethanave ka elemente të pakujdesisë në formën e neglizhencës dhe se vepra penale “shpërdorim detyre” kërkon domosdoshmërisht ardhjen e pasojave të rënda, të cilat nuk kanë ardhur përderisa i dënuari E. Ç. u rikthye në vendin e vuajtjes së dënimit.

**15.** Nga studimi i akteve të administruara në këtë procedim penal u evidentua se: (i) Subjekti nuk ka kryer hetime të plota lidhur me akuzën e shpërdorimit të detyrës nga dy të pandehurit, Konkluzionet përfundimtare me shkrim nuk janë të argumentuara mirë mbi bazën e të gjitha akteve të administruara në dosje. Në këto konkluzione nuk paraqiten pretendimet e të pandehurve apo avokatëve dhe, për rrjedhojë, as për argumente ligjore për t’i rrëzuar ato. (ii) Në konkluzionet e subjektit nuk evidentohen mirë dhe me hollësi të gjitha provat dhe faktet konkrete, lidhur me akuzën në ngarkim të të pandehurve. Moskryerja me dashje e detyrave nga ana e të pandehurve, sollën pasojën e rëndë, atë të liritimit nga burgu \*\*\* Tiranë të të dënuarit E. Ç., kur ndaj tij ishte marrë një masë sigurimi “arrest në burg” për krime të rënda, për të cilat vazhdonte gjykimi i

<sup>146</sup> Urdhri nr. \*\*\*, datë 28.12.2004 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj prokurorit Petrit Hysa”.

çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjatë kontrollit të ushtruar asokohe nga Prokuroria e Përgjithshme, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe u porosit për apelimin që duhet të bëjë.

**16. Sa u parashtrua më lart, Komisioni vëren se** konkluzionet e subjektit nuk janë të plota dhe në zbatim korrekt të Urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. \*\*\*, datë 5.9.2003 “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”, pika 1, ku përcaktohet se: *“Në kërkesat e prokurorit jo vetëm duhet të arsyetohet qëndrimi i tij, por me argumente duhet të rrëzohen edhe pretendimet e të pandehurit apo të mbrojtësit”*.

**17. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegime në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se:** *“Në konkluzionet me shkrim të mbajtura nga ana ime, jam përqendruar tek thelbi i akuzës dhe provat që provojnë fajësinë e të pandehurve, padyshim që duheshin bërë edhe më mirë, më të zgjeruara, por në këtë rast duhet të mbahet parasysht edhe ngarkesa në punë, rrethana të tjera (urdhrave të dhënë). Për këtë rast unë kam pranuar përgjegjësitë e mia dhe fakti që vitin pasardhës jam vlerësuar shumë mirë, tregon se unë kam reflektuar në këtë drejtim. Kërkoj që kjo masë disiplinore e dhënë në atë kohë të mos merret parasysht nga juaj referuar edhe praktikës suaj për subjektet e rivlerësimit E. K. dhe A. N.”*

ii) Gjithashtu, nga hetimi rezultoi se përsëri ndaj subjektit është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” me urdhrin nr. \*\*\*, datë 31.7.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm. Subjekti e ka kundërshtuar dhënien e kësaj mase disiplinore me padi në gjykatë, ndërkohë që Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.2.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Komisioni, pasi analizoi shkaqet e këtij vendimi, vëren sa vijon:

**18. Bazuar në urdhrin nr. \*\*\*, datë 18.11.2013, të Prokurorit të Përgjithshëm, u ushtrua kontroll në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me pjesëmarrjen në gjykim të prokurorëve për çështje penale themeli të përfunduara me vendim gjyqësor gjatë vitit 2012, si dhe për çështje penale themeli të përfunduara apo që janë duke u gjykuar gjatë vitit 2013, deri në momentin e ushtrimit të kontrollit. Objekt i kontrollit ka qenë edhe verifikimi i pjesëmarrjes së prokurorit në procese gjyqësore që lidhen me shqyrtimin e kërkesave të palëve për kundërshtimin e vendimeve të prokurorisë, ekzekutimin e vendimeve penale, heqjen e sekuestros, rivendosjen në afat, shuarjen e masës së sigurimit, etj.**

**19. Pas përfundimit të kontrollit u konstatuan mangësi të theksuara në lidhje me rregullsinë e pjesëmarrjes në gjykim të subjektit Petrit Hysa<sup>147</sup>. Gjithashtu, nga kontrolli është evidentuar se në 49 seanca gjyqësore subjekti i ka kërkuar gjykatës shtyrjen e seancave gjyqësore për shkak të mosadministrimit të dëshmive të penalitetit. Dëshmia e penalitetit sipas nenit 332, shkronja “d” e Kodit të Procedurës Penale është pjesë e fashikullit që dërgohet në gjykatë dhe merret që në fazën**

---

<sup>147</sup> Është konstatuar se ka munguar në 96 seanca gjyqësore duke informuar gjykatën ose pretenduar në observacionet e tij se ka qenë i gatshëm me masat e sigurimit. Nga verifikimi i listave të grafikut të gatishmërisë rezultoi se për 37 seanca gjyqësore në të cilat ka munguar duke informuar gjykatën se ka qenë i gatshëm apo ka pretenduar se ka qenë i gatshëm, ndërsa në procesverbalin e gjykatës është shënuar pa shkaqe të arsyeshme. Pra, nuk figuron që prokurori Petrit Hysa të ketë qenë i gatshëm, ndërkohë që për 59 seancat e tjera gjyqësore në të cilat ka munguar me pretendimin se ka qenë i gatshëm, datat e të cilave përkojnë me grafikun e gatishmërisë, nuk jepet asnjë shpjegim nëse ka pasur masa sigurimi, nëse janë kryer veprime hetimore apo paraqitje në gjykatë në funksion të masave të sigurimit, të cilat bëjnë të pamundur paraqitjen e prokurorit në seancat e gjyqeve të themelit. Nga materialet e kontrollit rezultoi se për 10 seanca të tjera gjyqësore, në procesverbalet e të cilave mosparaqitja e prokurorit është shënuar pa shkaqe të arsyeshme, subjekti nuk ka dhënë shpjegime rreth shkaqeve të mosparaqitjes ose nuk i kujton ato.

e hetimit paraprak. Prokurori ka pasur detyrimin ligjor dhe kohën e mjaftueshme për të administruar dëshmitë në fazën e hetimit. Kërkesat e prokurorit drejtuar gjykatës për shtyrje të seancave me qëllim administrimin e dëshmisë së penaltetit, janë krejtësisht të pajustificuara dhe kanë sjellë zvarritje të theksuara të gjyqimit.

**20. Komisioni vëren se** për periudhën objekt kontrolli janë evidentuar mangësi nga ana e subjektit të rivlerësimit, mosparaqitja në seancat gjyqësore dhe kërkesat për shtyrjen e tyre për rrethana që duhej të ishin shmangur kanë ndikuar në zvarritjen e gjykimeve dhe cenimin e performancës së prokurorit në gjykim.

**21. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegime në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se** sipas statistikave, për periudhën objekt kontrolli, rezulton se është ndër të paktët prokurorë, që ka përfunduar në gjykim një numër të lartë çështjesh<sup>148</sup>. Fakti që nuk mund të justifikojë mungesat e mundshme në disa seanca gjyqësore për shkak të kohës së gjatë të kaluar, nuk do të thotë se ka munguar pa arsye. Mungesat në gjykim duhen parë të lidhura ngushtësisht edhe me treguesit e punës në hetim. Me urdhra të brendshëm, verbalë dhe të shkruar, është normuar dhënia përparësi e shërbimit të gatishmërisë në raport me seancat gjyqësore<sup>149</sup>. Sipas subjektit, numri i shtyrjes së seancave gjyqësore për mungesë dëshmie penalteti nuk rezulton të jetë ai i paraqitur nga inspektorët, por me i vogël. Asnjë dosje nuk kalon për gjykim pa pasur të paktën kërkesën me shkrim drejtuar zyrës së regjistrimit gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë për dëshmi penalteti. Në çdo dosje penale ndodhet urdhri i delegimit dhe në çdo rast i është lënë detyrë oficerit të policisë gjyqësore administrimi i dëshmisë së penaltetit.

**22. Komisioni hetoi me tej lidhur me vlerësimet dhe performancën në punë të subjektit pas dhënies së masave disiplinore të analizuara më sipër, ku pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, vërehet se ndaj subjektit janë dhënë vlerësimet profesionale në masën “shumë mirë” për vitet 2012, 2014, 2015 dhe 2016, ndërkohë që në vitin 2013 është vlerësuar në masën “mirë”.**

**23. Sa rezulton, në vlerësimin tërësor, problematikat e evidentuara dhe të shqyrtuara më sipër nuk përmbajnë shkelje serioze dhe nuk kanë shkaktuar pasoja të rënda procedurale për palët në mënyrë që subjekti i rivlerësimit të kualifikohet “i papërshtatshëm” nga ana profesionale.**

**24. Më tej, Komisioni kërkoi informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme<sup>150</sup> nëse ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit Petrit Hysa.**

**25. Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr.\*\*\*, datë 30.7.2019, i shtetasit I. B., për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal në datën 2.8.2019. Ky shtetas pretendon se subjekti dhe oficeri i policisë gjyqësore Sh. K. kanë**

---

<sup>148</sup> Kohëzgjatja e gatishmërisë për seksionin e të miturve ku ka punuar për periudhën në fjalë shkon nga 7-10 ditë në muaj, ndërsa e prokurorëve të linjave të tjera kjo kohëzgjatje është 2-3 ditë në muaj. Si rrjedhim, duke qenë kohëzgjatja më e madhe, padyshim që probabiliteti për të pasur masa sigurimi është shumë më i lartë sesa në rastet kur janë më pak dite gatishmërie dhe, rrjedhimisht, mundësia për të marrë pjesë në gjykim është rreth 3-4 herë më e ulët. Subjekti, në cilësinë e provës, ka bashkëlidhur grafikët e shërbimit të gatishmërisë dhe treguesit e punës.

<sup>149</sup> Urdhri nr. \*\*\*, datë 7.2.2002 “Për shërbimin e gatishmërisë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

<sup>150</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.7.2020.

zvarritur çështjen e tij dhe në përfundim është marrë një vendim i padrejtë. Nga ana e Prokurorisë është konstatuar se nuk rezulton që nga ana e subjektit Petrit Hysa të jenë kryer apo moskryer me dashje veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës.

**26.** Pas analizimit të fashikullit hetimor, Komisioni, gjithashtu vlerëson se nuk rezultoi ndonjë e dhënë lidhur me moszbatimin e procedurave ligjore konkrete nga subjekti i rivlerësimit, gjë që krijon bindjen se nuk ka pasur shkelje ligjore nga ana e tij.

**27.** Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar materialet hetimore sa vijon:

- i. Nr. \*\*\*/2018, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal me anë të vendimit datë 10.12.2018. Në lidhje me kallëzimin e bërë ndaj subjektit<sup>151</sup>, nga ana e Prokurorisë është konkluduar se nuk ndodhet para veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi shtetasit të mësipërm i është bërë një proces i rregullt hetimor e gjyqësor dhe nuk i është cenuar asnjë e drejtë. Pas analizimit të fashikullit hetimor, Komisioni, gjithashtu vlerëson se nuk rezultoi ndonjë e dhënë lidhur me moszbatimin e procedurave ligjore konkrete nga subjekti i rivlerësimit, gjë që krijon bindjen se nuk ka pasur shkelje ligjore nga ana e tij.
- ii. Nr. \*\*\*/2019, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal me anë të vendimit datë 12.11.2019. Ky procedim penal ka nisur mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve R. e I. S., të cilët e akuzojnë subjektin se në dëm të interesave të tyre ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal mbi bazën e kallëzimit të bërë për veprën penale “mashttrim”, “fyerje” dhe “kanosje” ndaj shoqërisë “\*\*\*\*”. Pas analizimit të fashikullit hetimor, Komisioni, gjithashtu vlerëson se nuk rezultoi ndonjë e dhënë lidhur me moszbatimin e procedurave ligjore konkrete nga subjekti i rivlerësimit.
- iii. Nr. \*\*\*/2020, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal me anë të vendimit datë 14.2.2020<sup>152</sup>. Prokuroria ka konkluduar se nuk rezultojnë të jenë kryer apo moskryer me dashje veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin dhe se në lidhje me detyrat e lëna nga gjykata, kjo çështje penale është ende në gjykim dhe gjykata nuk ka marrë ende një vendim mbi kontrollin e detyrave të lëna prej saj. Lidhur me vendimin për pushimin e çështjes nga ana e subjektit, kallëzuesit duhet t’i drejtohen me ankim gjykatës më të lartë. Komisioni kërkoi administrimin e vendimit gjyqësor të kësaj çështjeje<sup>153</sup>, nga ku rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të vendimit nr.\*\*\*, datë 12.11.2021, ka vendosur pushimin e

---

<sup>151</sup> Ky procedim penal ka nisur mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit A. Q., i cili e akuzon subjektin dhe gjyqtaren e çështjes së tij për veprën penale “shpërdorim detyre”. Rezultoi se ky shtetas është dërguar në gjyq nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për akuzën “Prishje e rendit dhe qetësisë publike”, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes. Ky shtetas pretendon se është goditur dhe keqtrajtuar gjatë kohës që e kanë shoqëruar në Drejtorinë e Policisë së Tiranës dhe akuzon subjektin e rivlerësimit se gjatë gjykimit ka kërkuar ekspertim psikiatrik. Gjatë hetimeve, sipas aktit të ekspertimit psikiatrik, ka dalë me çrregullime të personalitetit.

<sup>152</sup> Komisioni vëren se ky procedim penal ka nisur mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve B. e E. N., të cilët akuzojnë subjektin për veprën penale “shpërdorim detyre”. Kallëzuesit pretendojnë se gjatë hetimit të çështjes së tyre, subjekti nuk i është përgjigjur pyetjeve të lëna nga gjykata dhe se së bashku me ekspertin kanë përdorur një dokument të falsifikuar (aktin e kolaudimit).

<sup>153</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2023.



çështjes<sup>154</sup>. Pas analizimit të fashikullit hetimor, Komisioni, gjithashtu vlerëson se nuk rezultoi ndonjë e dhënë lidhur me moszbatimin e procedurave ligjore konkrete nga subjekti i rivlerësimit.

iv. Nr. \*\*\*/2020, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal me anë të vendimit datë 24.3.2020. Ky procedim penal ka nisur mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit J. B., i cili e akuzon subjektin se ka shkelur parimin kushtetues të ndalimit të gjyqimit dy herë për të njëjtën veprë penale, si dhe ka interpretuar gabim ligjin material, pasi i ka kërkuar Gjykatës një marzh dënimi më të rëndë. Në përfundim të hetimeve, nga ana e Prokurorisë është konstatuar se nuk rezulton të jenë kryer apo moskryer me dashje veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës (kjo çështje është trajtuar në seksionin e denoncimeve nga publiku në këtë vendim).

v. Nr. \*\*\*/2020, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal.

**28.** Për të përditësuar informacionin nëse në vijim janë regjistruar procedime të tjera penale, mosfillim apo pushim në ngarkim të subjektit, Komisioni ka kërkuar përsëri informacion pranë Prokurorisë së Përgjithshme<sup>155</sup>, e cila me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2023, informon sa vijon: (i) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>156</sup> janë regjistruar materialet hetimore nr. \*\*\*/2018, nr. \*\*\*/2019, nr. \*\*\*/2020, nr. \*\*\*/2020, nr. \*\*\*/2020, \*\*\*/2021, nr. \*\*\*/2021 dhe nr. \*\*\*/2022, për të cilat është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal; (ii) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*/2019, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 5.11.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit I. B. për kundërshtimin e vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”; kallëzimi penal nr. \*\*\*/2020, për veprën penale “shpërdorim detyre”, transferuar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës; kallëzimi penal nr. \*\*\*/2021, për veprën penale “mashttrim”, transferuar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**29. Nga hetimet e Komisionit** u vlerësuan si *indicie* informacionet e marra nga mediat *online* lidhur me pushimin e procedimit penal për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm” dhe moszbardhja dhe hetimi i rrethanave që çuan në vdekjen e shtetasit S. M. Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2022, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u kërkuua administrimi i dosjes penale. Në përgjigje<sup>157</sup>, Prokuroria ka vënë në dispozicion të Komisionit fashikullin hetimor të procedimit penal nr. \*\*\*/2017, nga ku rezultoi sa vijon:

**30. Rrethanat e faktit** – shtetasi S. M. në datën 1.6.2017 operohet me diagnozën “Obezitet Morbid” dhe kryhet “*sleeve gastrectomy*” (palosje gastrike), në spitalin “\*\*\*\*” Tiranë. Operacioni është kryer nga mjeku specialist kirurg i përgjithshëm, dr. S. G., me shtetësi greke. Pas disa ditësh qëndrimi në spital, më 5.6.2017, pacienti del nga spitali për t’u rikthyer sërish më 9.6.2017, në gjendje jo të mirë shëndetësore, me diagnozën “Peritonit pas operator”. Pas ndërhyrjes së mjekut

<sup>154</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2023.

<sup>155</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022.

<sup>156</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2022.

<sup>157</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2023.

S. G., së bashku me mjekun G. S. (shef i kirurgjisë pranë këtij spitali), pacienti u shoqërua në reanimacion ku u përmirësua dhe paraqitej hemodinamikisht qëndrueshëm. Në datën 18.6.2017, pas 11 ditësh qëndrimi në spitalin “\*\*\*”, pacienti largohet në drejtim të Athinës për shërbim mjekësor më të specializuar dhe gjatë transportimit me ambulancë humbi jetën. Viktima është paraqitur në Spitalin e Përgjithshëm të Korinthit në Greqi pa shenja jete.

**31.** Nga hetimi i Komisionit, sipas deklaratave të personave që kanë dijeni për ngjarjen, rezultoi se pacienti paraqitej me temperaturë dhe jo në parametrat e kërkuar, transporti i të cilit u krye pa asnjë mjek shoqëruar (vetëm një infermier), në një kohë që dihej se në ambulancë nuk do të bëhej dot ushqyerja dhe mungesa e saj do të sillte pasojën që erdhi, gjithashtu nuk ishte e pajisur me ekran dhe defibrilator që duhej të ishte përdorur në momentin që viktima dyshohet të ketë pësuar infarkt. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 31.12.2018 ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 6.7.2017, për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal. Subjekti arsyeton se me gjithë kohën e gjatë të kaluar dhe kërkesat e përsëritura të kryera nga ana e Prokurorisë, nuk ka marrë përgjigje nga ana e autoriteteve greke. Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë, në aktin e ekspertimit mjekoligjor nr.\*\*\*, datë 23.10.2017, në lidhje me shkaqet e vdekjes, midis të tjerash, thekson se në mungesë të plotë të organeve jetësore si truri, zemra dhe stomaku, nuk mund të shprehen për shkakun e vdekjes së shtetasit S. M.. Në kushtet e mungesës së aktit të ekspertimit mjekoligjor, çështja duhet të pushohet sepse fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenin 329/a, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale.

**32.** Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.5.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së subjektit, duke arsyetuar se kërkesa e Prokurorisë për pushimin e procedimit penal nuk duhet pranuar, pasi nuk është rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, për rrjedhojë duhet t’i kthehen aktet për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme, duke lënë disa veprime hetimore<sup>158</sup>. Rezulton se subjekti e ka apeluar vendimin e dhënë në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.9.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

**33.** Pas kthimit të akteve nga ana e Gjykatës dhe lënies së detyrave përkatëse përsëri subjekti ka kërkuar pushimin e procedimit penal me vendimin datë 10.7.2020, duke arsyetuar përsëri se me gjithë kohën e gjatë të kaluar dhe kërkesat e përsëritura të kryera nga ana e Prokurorisë, nuk kanë marrë përgjigje nga ana e autoriteteve greke, por në seancë gjyqësore ka kërkuar zgjatjen e afatit të hetimit për një afat prej 90 ditësh, duke qenë se në datën 31.8.2020 kanë ardhur materialet e kërkuara nga autoritetet greke. Në këto kushte, subjekti i kërkon gjykatës kthimin e dosjes për plotësim hetimesh, pasi materiali përkatës ka ardhur pas depozitimit të kërkesës për pushimin e procedimit penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.10.2020, ka vendosur të kthehen aktet për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme. Në përfundim të hetimeve,

---

<sup>158</sup> Të merren me letërporosi aktet mjekoligjore, aktin e autopsisë; të kërkohet me letërporosi nga autoritetet e shtetit grek sqarimi i rrethanave në lidhje me faktin e mungesës prej trupit të viktimës të të gjitha organeve jetësore si truri, zemra dhe stomaku, pse i janë hequr ato nga trupi viktimës; të kërkohet kthimi i këtyre organeve jetësore si truri, zemra dhe stomaku dhe t’i vihen në dispozicion Institutit të Mjekësisë Ligjore, për t’iu nënshtruar ekspertizës mjekoligjore në lidhje me shkakun e vdekjes së viktimës S. M.; të bëhet ballafaqimi i plotë mes të katër dëshmitarëve E. P., M. Ç., V. K. dhe Zh. M. në lidhje me kundërthëniet e tyre; të rripyeten të tre mjekët E. P., M. Ç. dhe Dr. G. rreth faktit nëse i qëndruan konsekuent recetës së Dr. J. Th., nëse e kanë bërë ushqyerjen e viktimës dhe përse bënë transportimin e tij për në Greqi me ambulancë pa asnjë mjek në ambulancë.

subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin në gjyq të çështjes nr. \*\*\*, datë 6.7.2017, për veprën penale “neglizhencë në trajtimin mjekësor”<sup>159</sup>, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal, me të pandehur shtetasin S. G. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor rezultoi se ka elemente të neglizhencës mjekësore në trajtimin mjekësor të tij, të cilat konsistojnë në vendimmarrje jo të duhur për mënyrën e trajtimit kirurgjikal të shtetasit S. M. në momentin e paraqitjes në spital për herë të dytë në datën 8.6.2017, për të cilën mbajnë përgjegjësi mjekët kirurgë që janë marrë me trajtimin e tij.

**34.** Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2023, Komisioni kërkoj administrimin e vendimit dhe dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje. Në përgjigje, me anë të shkresës nr. \*\*\*, prot., datë 8.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informon se kjo çështje është ende në proces.

**35. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoj shpjegime në lidhje me konstatimin se:** (i) Subjekti i rivlerësimit ka kryer një hetimi jo të plotë dhe të gjithanshëm duke parashtruar para gjykatës dy herë kërkesë për pushimin e procedimit penal, duke mos ezauruar çdo veprim të nevojshëm hetimor për të hedhur dritë mbi këtë çështje. (ii) Arsyetimi i subjektit mbi të cilin bazon vendimin e pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, duket se nuk qëndron, pasi nuk gjen zbatim në asnjë prej pikave të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, ku janë përcaktuar shkaqet për pushimin e çështjes penale.

**36. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se pas më shumë se një viti e gjysmë hetimesh, kur ishin kryer të gjitha veprimet hetimore të mundshme, si dhe i ishin dërguar letërporositë autoriteteve të shtetit grek, nuk kishin marrë asnjë përgjigje në këtë drejtim dhe në gjendjen që ishin aktet (duke mos pasur alternativë tjetër procedurale) ka dërguar çështjen në gjykatë për pushim<sup>160</sup>.** Subjekti deklaroi se nuk janë cenuar të drejtat e palëve për sa kohë që ligji procedural penal i ka dhënë zgjidhje kësaj situatë procedurale, pasi me të ardhur përgjigjet e letërporosive ka kërkuar kthimin e akteve për plotësim hetimesh, ka kryer një riekspertim mjekoligjor me grup ekspertësh dhe e ka dërguar çështjen për gjykim.

**37. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – bazuar në nenin 304 “Veprimtaria hetimore e prokurorit”, të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se: *“Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm”*. Pra, në këtë kontekst subjekti duhet të kryejë të gjitha veprimet e mundshme hetimore për të provuar: (a) ekzistencën e faktit penal; dhe (b) autorin e veprës penale. Mbase të ketë sqaruar këto elemente të hetimit dhe të ketë konkluduar, duhet të analizojë nëse ka shkaqe padënueshmërie. Arsyetimi i subjektit mbi të cilin është bazuar dy herë vendimi i pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, nuk gjen zbatim në asnjë prej pikave të

---

<sup>159</sup> Me ligjin nr. 44/2019 dispozita penale për veprën “mjekim i pakujdesshëm” neni 96 i Kodit Penal, është ndryshuar sa vijon: *“Mjekimi i pakujdesshëm i të sëmurëve nga ana e mjekut ose e personelit tjetër mjekësor, si dhe moszbatimi i terapisë ose i porositve të mjekut nga personeli mjekësor apo farmacist, kur ka shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit, ka rrezikuar jetën e personit ose ka shkaktuar vdekjen e tij, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet”*.

<sup>160</sup> Ka kërkuar pushimin e çështjes dhe arkivuar atë në pritje të ardhjes së provave me anë të letërporosisë, gjë e cila lehtëson punën e prokurorit nga një ngarkesë e tepërt/jo efektive sikurse është kërkimi i zgjatjes së afatit të hetimeve në gjykatë vetëm për këtë fakt, për muaj e vite me radhë, eviton mbajtjen e çështjes në dorë/hetim për këtë shkak nga viti në vit, si dhe ndikon në mirëmbajtjen dhe miradministrimin e dosjes fizike në arkivin e organit procedues dhe ndjekjen në dinamike të problemit.

nenit 328<sup>161</sup>, të Kodit të Procedurës Penale, ku janë përcaktuar shkaqet për pushimin e çështjes penale. Megjithatë vlen të përmendet fakti se pas administrimit të letërporosive nga shteti grek, subjekti ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq duke ezauruar në këtë mënyrë të gjitha detyrat e lëna nga gjykata lidhur me veprimet e mëtejshme hetimore.

**38.** Trupi gjykues vlerëson se konstatimet e bëra për këtë çështje nuk përbëjnë shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por qasja e subjektit dhe arsytimi i tij në dy vendimet e para për pushimin e çështjes janë elemente të cilat do të konsiderohen në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

## **DENONCIMET NGA PUBLIKU**

**39.** Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Petrit Hysa, janë administruar 23 denoncime nga publiku. Në 11 prej këtyre denoncimeve ngrihen pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta dhe nuk përmbahen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: (1) denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2018, të shtetases A. S.; (2) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2018, i shtetasit Q. H., (3) denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2018, nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2019, nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2019, nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020, të shtetasit ...\* ...\*, i cili kërkon të mbetet anonim; (4) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2019 i shtetasit ...\* ...\*, i cili kërkon të mbetet anonim; (5) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2019, i shtetasit A. P.

**40.** Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

**41. Ndërkohë që Komisioni** kërkoi shpjegime lidhur me denoncimet sa vijon:

- i. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018, i paraqitur nga shtetasi S. K., i cili ankohet për moskryerjen e hetimeve të plota nga ana e subjektit, dhënien e një vendimi të padrejtë lidhur me pushimin e çështjes dhe mosnjoftimin e tij për vendimin e marrë.

*Rrethanat e faktit* – shtetasi S. K. kallëzon se në vitin 1999 ka bërë një kontratë shitjeje pranë noteres D. Z., ku i ka shitur shtetasit V. L. një sipërfaqe toke prej 120 m<sup>2</sup> dhe shtetasit H. L. sip. prej 130 m<sup>2</sup>. Noterja e lartpërmendur ka falsifikuar dokumentet duke shënuar 250 m<sup>2</sup> shtetasit V. L. dhe 266 m<sup>2</sup> shtetasit H. L.

**42.** Në vendimin e tij subjekti arsyeton se bazuar në nenin 66 të Kodit Penal nuk mund të ushtrohet ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë

---

<sup>161</sup> "Pushimi i akuzës ose çështjes" 1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimi nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

kaluar 10 vjet për krimet që parashikojnë dënim nga 5 deri në 10 vjet burgim. Sa rezulton, vepra penale është shuar<sup>162</sup>, bazuar edhe në nenin 290/1, shkronja “d” dhe në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal<sup>163</sup>.

**43.** Për sa i përket pretendimit të denoncuesit se nuk është njoftuar për vendimin e marrë, Komisioni vëren se në dosjen penale ndodhet shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me lëndë: “Dërgohet një kopje e vendimit”. Kjo shkresë i është dërguar shtetasit A. Ll., me adresë: rruga “\*\*\*\*”, banesa pa numër, \*\*\*, Tiranë, shtetas ky që nuk figuron në dosjen penale, ndërkohë që kallëzuesi S. K. ka si adresë banimi: rruga “\*\*\*\*”, shtëpi private nr. \*\*\*, Tiranë.

**44. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se:** *Subjekti i rivlerësimit nuk e ka njoftuar kallëzuesin lidhur me vendimin e marrë dhe rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, duke i hequr të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit, bazuar në nenin 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.*

**45. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se:** Vendimi është marrë brenda afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale. Pas marrjes së vendimit dosja kalon në disa duar dhe vonesat e krijuara nuk kanë lidhje me punën e tij si prokuror. Duhet pasur parasysh në këtë drejtim edhe ngarkesa e jashtëzakonshme në punë si e prokurorit ashtu edhe e sekretarisë. Megjithatë, kjo vonesë, bazuar në nenin 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, nuk i heq të drejtën e ankimit palës, pasi e drejta për të bërë ankim lidhet me njoftimin e vendimit. Me marrjen e njoftimit brenda 10 ditëve, ankuesi mund t’i ishte drejtuar Gjykatës pa asnjë pengesë ligjore. Shkresa përcjellëse në emër të shtetasit A. Ll., e lidhur në dosjen që i përket kallëzuesit S. K., është një gabim teknik nga ana e sekretarisë.

**46. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – bazuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim, të cilët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit në prapësime ka paraqitur në cilësinë e provës kopjen e shkresës nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2018, dhe vendimin për mosfillimin e hetimeve të procedimit penal, dërguar shtetasit S. K. në adresën rruga “\*\*\*\*”, banesa nr. \*\*\*, Tiranë, vërtetuar kjo me zarfin e shërbimit postar kthyer në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shënimin “adresa e pasaktë”.

Referuar provave të paraqitura, rezulton se subjekti ka marrë masat e nevojshme për njoftimin e kallëzuesit në adresën e deklaruar nga vetë kallëzuesi, lidhur me vendimin e marrë dhe rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit.

---

<sup>162</sup> Edhe nëse do të ishim përpara elementeve të ndonjë figure veprë penale sikurse mundet të jetë ajo e “falsifikimit të dokumenteve” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, nisur nga koha e gjatë e kaluar (nga kryerja e mundshme e veprës penale, viti 1999), nuk mund të bëhen ndjekje penale për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit. Veprat penale të kryera në këtë fushë veprimtarie parashikojnë në maksimum një dënim me burgim që shkon deri në 7 vjet.

<sup>163</sup> Çështja është regjistruar në datën 25.9.2018, subjekti e ka marrë vendimin e mosfillimit brenda afatit ligjor.

**47. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

- ii. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2019, i paraqitur nga shtetasja A. S., e cila ankohet për moskryerjen e hetimeve të plota nga ana e subjektit, nuk ka zbatuar afatin ligjor për përfundimin e hetimeve dhe dërgimin e procedimit penal në gjykim.

*Rrethanat e faktit* – shtetasja A. S. kallëzon se është palë në proces gjyqësor civil përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me pronësinë e një apartamenti me sip. 113 m<sup>2</sup>, në katin e tretë të objektit në ndërtim nga firma ndërtuese “\*\*\*\*”, me vendndodhje në \*\*\*. Lidhur me pronësinë mbi apartamentin e lartpërmendur kallëzuesja pretendon se e ka fituar në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 4.10.2013, të lidhur midis shtetasesh Sh. I. dhe shoqërisë “\*\*\*\*” dhe kontratës premtim shitjeje nr. \*\*\*, datë 31.3.2014, të lidhur midis saj dhe shtetasesh Sh. I. Sa rezulton, është futur për të banuar në apartamentin e mësipërm dhe ka paguar rregullisht edhe faturat e energjisë elektrike. Pronësinë mbi këtë apartament e pretendon edhe shtetasi D. B., duke deklaruar se në këtë pallat ka përfutur disa apartamente sipas kontratës së lidhur me ndërtuesin.

**48.** Subjekti arsyeton se vepra penale e kallëzimit të rremë nga ana objektive kryhet në disa mënyra: (a) dhënia e informacioneve që nuk i përgjigjen situatës së vërtetë për kryerjen e një krimi që dihet se nuk është kryer; (b) dhënia e informacionit të rremë në dëm të një personi për kryerjen e një krimi kur dihet se nuk e ka kryer atë; (c) krijimi i provave të rreme për një krim të kryer ose që do të kryhet. Nga kallëzimi i shtetases A. S. nuk rezulton të ndodhet përpara asnjërës prej situatave të mësipërme. Shtetasi D. B., në kuadër të konfliktit të lartpërmendur, nuk rezulton të ketë paraqitur informacion të rremë që nuk i përgjigjet të vërtetës në dëm të shtetases A. S., pasi nuk ishte qëllimi i tij që t’i shkaktojë dëm kësaj shtetaseje, por të zgjidhë një çështje (civile) në favor të tij, në të cilën ndodhet si palë, me qëllim përfitimin e apartamentit të pretenduar prej tij dhe jo me qëllim të fillimit të ndjekjes penale mbi bazën e një informacioni të rremë. Në këto kushte, në veprimet e shtetasis D. B. mungojnë elementet e anës objektive e subjektive të figurës së veprës penale “kallëzimi i rremë”, parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal. Sa rezulton bazuar edhe në nenin 290/1, shkronja “ç” dhe në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti, me anë të vendimit datë 27.2.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Duke e njoftuar kallëzuesen lidhur me vendimin e marrë me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2018<sup>164</sup>.

**49.** Lidhur me pretendimet e denoncueses se nuk janë zbatuar afatet ligjore, rezultoi se kjo çështje është regjistruar në datën 12.2.2018 dhe vendimi është dhënë në datën 27.2.2018, brenda afatit ligjor prej 15 ditëve, bazuar në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale.

---

<sup>164</sup> Vendimi i subjektit është ankimuar nga kallëzuesja dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.5.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së A. S. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.7.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, shfuqizimin e vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, duke lënë si detyrë thirrjen për deklaram dhe ballafaqimin e shtetasis D. B. me shtetasen A. S., si dhe të përcaktohet se në çfarë faze ndodhet procedimi penal me kallëzues shtetasin D. B. Komisioni vëren se lidhur me kallëzimin e shtetasis D. B. ndaj shtetases A. S., për veprën penale “kallëzim i rremë”, subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2018. Ky vendim i subjektit është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 15.4.2019. Në datën 7.9.2018, subjekti ka bërë regjistrimin e procedimit penal, si dhe ka nxjerrë urdhër për delegimin e detyrave të lëna nga gjykata. Rezulton se është bërë ballafaqimi mes dy shtetasve të mësipërm në datën 7.11.2018 dhe në përfundim subjekti me vendimin datë 31.12.2018, ka vendosur pushimin e çështjes, në dosje ndodhen shkresat e dërguara shtetasve A. S. dhe D. B. lidhur me vendimin e marrë në datën 12.2018.

**50. Nga faktet e analizuara, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se:** Rezulton se vendimi për mosfillimin e procedimit penal i është njoftuar palës në datë 23.3.2018, pra rreth 1 muaj me vonesë, ndërkohë që neni 291/2 i Kodit të Procedurës Penale, përcakton se: “Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”.

**51. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij duke sqaruar se me marrjen e vendimit,** dosja përkatëse i është dërguar sekretarisë për sistemim, lidhje dhe inventarizim. Bazuar në nenin 291, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, mosmarrja e njoftimit menjëherë nuk i heq të drejtën e ankimit ankuesit, pasi e drejta për të bërë ankim lidhet me njoftimin e vendimit. Brenda 10 ditëve me marrjen e njoftimit, ankuesi mund t’i drejtohet gjykatës pa asnjë pengesë ligjore.

**52. Arsytimi ligjor i Komisionit** – referuar shpjegimeve të subjektit Komisioni vëren se mosmarrja e njoftimit menjëherë nuk i ka hequr të drejtën e ankimit ankuesit, me marrjen e njoftimit brenda 10 ditëve, ankuesi mund t’i drejtohet gjykatës. Sa rezulton, kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

iii. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2019, të shtetasit I. B., i cili ngre pretendime për zvarritje 10-mujore të pajustificueshme të procedimit penal.

*Rrethanat e faktit* – shtetasi I. B. kallëzon se në vitin 2013 ka blerë një dyqan nga shtetasi S. M.. Në datën 26.9.2017 i ka ardhur një faturues me emrin A. dhe i ka thënë se sahati i tij kishte pa likuiduar një shumë prej 300.000 lekësh. Nga verifikimet e bëra kallëzuesi ka mësuar se matësi i energjisë elektrike nuk ishte i tiji, por është gjetur në objektin e tij nga momenti i blerjes dhe deri në këtë moment nuk kishte bërë pagesa të energjisë elektrike, pasi ambienti ka qenë i mbyllur dhe nuk kanë faturat përkatëse. Ky matës ka qenë i montuar në ambientin në pronësi të kallëzuesit, por rezulton me numër tjetër dhe nuk është ai i sakti. Kallëzuesi pretendon se me veprimet e tyre të kundërligjshme, punonjësit e OSHEE-së kanë dëmtuar interesat e tij të ligjshme dhe se ky problem nuk ka gjetur zgjidhje.

**53. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti ka ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore të nevojshme<sup>165</sup> dhe duke qenë se veprimet e mundshme janë kryer të gjitha, por autori i veprës**

---

<sup>165</sup> Subjekti ka marrë dëshmitë nga shtetasi E. V.<sup>165</sup> me detyrën e lexuesit pranë OSHEE-së, Njësia Nr. \*\*\*; shtetasja S. P.<sup>165</sup> me detyrën e lexueses në këtë zonë; shtetasi K. H.<sup>165</sup>; shtetasi E. Ç.<sup>165</sup>, me detyrën e specialist elektrikist për verifikim - matje pranë OSHEE-së, Tirana nr. \*\*\*; shtetasi A. B.<sup>165</sup> me detyrën e inxhinierit të bilancit Njësia nr. \*\*\*. Nuk është bërë e mundur pyetja e shtetasit S. M. (ish-pronari i lokalit) në lidhje me faturimin e bërë pasi ky shtetas ka ndërruar jetë në datën 28.9.2013. Subjekti, në vendimin e tij, arsyeton se nga këqyrja e sistemit TIMS rezulton se shtetasi A. G. është larguar nga territori i shtetit shqiptar në datën 29.11.2017 dhe nuk ka hyrje. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2018, OSHEE-ja ka informuar se për verifikimin e kontratës së kallëzuesit, nga lexuesi është raportuar gjendja e leximit 13924 kwh në matës, gjendje e cila është pasqyruar edhe në sistem, së bashku me historikun e faturimit për abonentin, si dhe procesverbal i datës 18.6.2018 së bashku me foto të matësit, ku rezulton se kontrata me kod nr. \*\*\*; i përket abonentit E. B., e hapur në datën 15.5.1998 dhe ndryshimi i emrit është bërë në datën 26.8.2015. Nga materiali i mësipërm ka rezultuar se abonenti në fjalë i është faturuar e gjithë gjendja në kwh që është konstatuar në matës në datën 13.2.2018 dhe jo konsumi real për shkak të mosgjenerimit të të dhënave në sistemin e matjes periodikisht ndërkohë që nuk ka asnjë informacion se kur është zëvendësuar matësi dhe kush e ka zëvendësuar atë, sa kwh ka pasur në momentin e ndërrimit. Kur në zyrën e verifikim - matjes nuk ka një dokumentacion lidhur me këtë fakt, me gjithë hetimet e kryera nuk është bërë e mundur të gjendet personi që ka vendosur matësin me nr. serial \*\*\* në objektin e mësipërm, duke zëvendësuar matësin me numrin serial \*\*\*; i cili i përket abonentit.

penale nuk njihet, në mbështetje të nenit 326 Kodit të Procedurës Penale, subjekti në datën 21.5.2019, ka vendosur të pezullojë hetimet për procedimin penale nr. \*\*\*/2018.

**54. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se:** *Procedimi penal nr. \*\*\*, pa autor, që bën fjalë për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, është regjistruar në datën 30.3.2018, ndërkohë që vendimi “Për pezullimin e hetimeve” është marrë në datën 21.5.2019.*

**55. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë dëgjimore, duke sqaruar se:** janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, por autori i veprës penale nuk njihet, në mbështetje të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 21.5.2019, është vendosur pezullimi i hetimeve. Në rastin e regjistrimit të procedimit penal, në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk është shënuar emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale sipas nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi në gjendjen që janë aktet nuk dilte një emër i dyshuar. Sipas nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale, afati i përfundimit të hetimeve paraprake fillon pikërisht me regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale. Pezullimi i hetimeve ka qenë në pajtim me nenin 326, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale dhe vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme. I vetmi person që ka mbetur pa u pyetur dhe që mundet të japë informacion në këtë drejtim është shtetasi A. G., i cili është larguar nga territori i shtetit shqiptar. Në përfundim, subjekti deklaroi se ka ndjekur dhe kontrolluar veprimet hetimore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore, urdhrat dhe vendimet e tij janë të arsyetuara duke iu referuar shkakut ligjor përkatës dhe se deri në këtë fazë nuk ka cenuar të drejtat e asnjë pale në proces. Subjekti deklaroi se kallëzuesi është njohur me vendimin e pezullimit, duke paraqitur në cilësinë e provës një kopje të vendimit të regjistrimit të procedimit penal, urdhrat e delegimit të çështjes dhe vendimin për pezullimin e hetimeve.

**56. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – nga hetimi rezultoi e provuar se në rastin e regjistrimit të procedimit penal, në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk është shënuar emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale sipas nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi në gjendjen që janë aktet nuk dilte një emër i dyshuar. Referuar edhe shpjegimeve të subjektit, bazuar në nenin 323/1 të Kodit të Procedurës Penale, afati i përfundimit të hetimeve paraprake fillon pikërisht me regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale. Sa rezulton, nuk ka vend për marrjen e vendimit për zgjatjen e afatit të hetimeve.

**57. Në përfundim,** pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të dërguara, Komisioni vlerëson se subjekti ka shpjeguar bindshëm vendimmarrjen e tij, janë ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore të nevojshme lidhur me këtë procedim penal dhe nuk janë cenuar të drejtat e asnjë pale në proces. *Sa rezulton,* kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

iv. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 24.6.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2020, të shtetasit I. G., i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit ka hetuar një çështje ndaj tij, e cila ishte hetuar dhe gjykuar më parë dhe ishte shpallur i pafajshëm. Nuk është kryer asnjë veprim për të sqaruar rrethanat, faktet dhe provat mbi të cilat duhet të ngrinte përsëri akuzën ndaj denoncuesit. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2019, nr. \*\*\* prot., datë 8.1.2020, nr. \*\*\* prot., datë



3.8.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.5.2023, të shtetasit J. B., i cili e akuzon subjektin e rivlerësimit për korrupsion dhe njëanshmëri, si dhe pretendon se ka hetuar një çështje ndaj tij, e cila ishte hetuar dhe gjykuar më parë dhe ishte shpallur i pafajshëm.

*Rrethanat e faktit* – shtetasja R. K. ka kallëzuar dy denoncuesit e mësipërm, shtetasit J. B. dhe I. G. Ajo deklaroi se është pronare e pasurisë nr. \*\*\*, sip. trualli 258,6 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë dhe vila nr. \*\*\*, me sip. 332 m<sup>2</sup>, e cila ndodhet brenda sipërfaqes së këtij trualli. Me kontratën nr. \*\*\*, datë 21.5.2014, “Shitje pasurie e paluajtshme truall dhe bodrum - shitje me rezerve”, i shet shtetasve J. B. dhe O. B. pasurinë nr. \*\*\*, sipërfaqe trualli 258,6 m<sup>2</sup>, si dhe pasurinë nr. \*\*\*, me sip. 32 m<sup>2</sup>. Çmimi i shitjes në total është 400.000 euro, shumë e cila do të likuidohet brenda një viti nga nënshkrimi i kontratës. Sipas kallëzueses, me justifikime nga më të ndryshmet, shtetasi J. B. nuk iu përmbajt kushteve të kontratës dhe e ka mashtruar atë. Ndërkohë që përmbaruesi gjyqësor I. G., pa pasur asnjë vendim gjyqësor, ka cenuar të drejtat e kallëzueses, duke bërë që ajo të humbasë pronën e saj.

**58. Subjekti në vendimin e tij arsyeton se** siç konstatohet dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimet nr. \*\*\*, datë 16.1.2017 dhe nr. \*\*\*, datë 27.2.2017, përmbaruesi gjyqësor I. G. ka tejkaluar kompetencat ligjore duke ndërmarrë veprime për të cilat nuk ka pasur asnjë urdhërim apo vendim gjyqësor, duke kërkuar ekzekutimin e një kontrate për të cilën nuk ka asnjë urdhër ekzekutimi e që nuk është objekt i procedurës përmbarimore. Kjo pasojë e kundërligjshme është element material i anës objektive të figurës së veprës penale “shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Përmbaruesi rezulton të ketë vepruar me dashje, një element i rëndësishëm i anës subjektive. Ai e ka ditur që nuk ka pasur asnjë urdhër ekzekutimi në lidhje me kontratën për shitje me rezervë të pronës nr. \*\*\*, datë 20.11.2015, për të cilën janë ekzekutuar detyrimet, ndërkohë që shtetasi J. B. ka vendosur të përdorë gënjeshtren dhe të shpërdorojë besimin ndaj shtetasës R. K.

**59.** Në përfundim të vendimit të tij, subjekti thekson se me kërkesën e datës 23.4.2018, prokurorja A. Q. ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq për procedimin penal nr. \*\*\*/2016. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.6.2018, Gjykata ka vendosur dërgimin për gjykim pranë gjykatës kompetente. Nga sa më sipër shihet se pretendimet e shtetasës R. K. në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*/2017 janë hetuar dhe sqaruar në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*/2016, e cila është dërguar për gjykim. Sa rezulton, subjekti ka vendosur t’i njoftojë shtetasit I. G. akuzën për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndërsa shtetasit J. B. i është njoftuar akuza për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal dhe dërgimin në gjyq të çështjes nr. \*\*\*/2017. Të pandehurit janë njoftuar me përfundimin e hetimeve. Oficeri i policisë gjyqësore K. Ç., i deleguar për kryerjen e hetimeve paraprake të procedimit penal nr. \*\*\*, në relacionin mbi përfundimin e hetimeve datë 27.10.2018, ka sugjeruar pushimin e procedimit penal, nisur nga parimi i sigurisë juridike si pjesë përbërëse e gjësë së gjykuar, bazuar në nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale “Ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtën vepër penale”.

**60.** Nga hetimi i Komisionit lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2016, të hetuar nga prokurorja A. Q., rezultoi se ky procedim ka filluar mbi bazën e kallëzimit datë 4.11.2016, të bërë nga shtetasi J. B., i cili kallëzon shtetasin I. G. për shpërdorim detyre. Në përfundim të hetimeve është vendosur

dërgimi i çështjes në gjyq në ngarkim të shtetasit I. G., me akuzën për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, ndërsa shtetasit J. B. i është njoftuar akuza për veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal.

Çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.2.2019, ka vendosur: “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit I. G. për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit J. B. për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Më tej, procedimi penal nr. \*\*\*/2017, i hetuar nga subjekti Petrit Hysa, është iniciuar mbi bazën e kallëzimit datë 15.9.2017, të shtetasës R. K., ndaj shtetasit J. B. Në përfundim të hetimeve subjekti vendosi dërgimin e çështjes në gjyq me po të njëjtën akuzë si procedimi i parë në ngarkim të këtyre shtetasve.

**61.** Komisioni administroi me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2023, vendimin nr. \*\*\*, datë 12.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas të cilit është vendosur deklarimi fajtor i ankuesit në cilësinë e të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, dënimin e tij me 6 vjet burgim dhe deklarimi i pafajshëm i të pandehurit I. G. për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Në këtë vendim rezulton se nga ana e subjektit Petrit Hysa është kërkuar deklarimi fajtor i ankuesit dhe i të pandehurit I. G. për veprat penale të mësipërme dhe përkatësisht dënimin me 9 vjet dhe 2 vjet burgim.

**62.** Në arsyetimin e vendimit të saj, gjykata është shprehur ndër të tjera edhe lidhur me faktin e “gjësë së gjykuar”, duke arsyetuar se: “Gjykata konstaton se në lidhje me dy kallëzimet e mësipërme, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë zhvilluar paralelisht dy procedime penale, të cilat kanë marrë përkatësisht numrat \*\*\* dhe \*\*\*. Gjykata vijoi me shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi pavarësisht pretendimeve të të pandehurve, që ndodhet *përpara gjësë së gjykuar*, duke qenë se dosja ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe vendimi nuk ka marrë formë të prerë, bazuar në nenin 474 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata ishte e detyruar të vijonte gjykimin. Referuar nenit 474 të Kodit të Procedurës Penale kur ka vendime për të njëjtin fakt, do të ekzekutohet vendimi me dënimin më të lehtë dhe, për pasojë, të pandehurit kanë mundësinë që në fazën e ekzekutimit të parashitrojnë pretendimet e tyre...”. Nga ana e Gjykatës, përkundrejt veprimeve të subjektit nuk është konstatuar mosrespektim i legjislacionit procedural dhe material ose zbatim i gabuar i legjislacionit procedural dhe material referuar pretendimeve të ankuesve/denoncuesve.

**63.** Nga hetimi i Komisioni rezultoi se ndaj vendimit të kësaj gjykate është ushtruar ankim. Sipas denoncuesit është ushtruar ankim nga ana e tij në cilësinë e të pandehurit, ankim i cili nuk është shqyrtuar ende. Gjithashtu, ndaj vendimit (të parë) gjyqësor nr. \*\*\*, datë 6.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është ushtruar ankim nga Prokuroria në datën 20.2.2019 dhe se ky ankim nuk është shqyrtuar ende.

**64. Komisioni vëren se** bazuar në nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale, askush nuk mund të gjykohet rishtazi për të njëjtin fakt penal për të cilin është gjykuar me vendim të formë së prerë. Në rastin konkret, nga analizimi i fashikullit gjyqësor nuk rezulton të jetë dhënë një vendim i

formës së prerë, por rezulton se subjekti ka dërguar përsëri për gjykim të njëjtën çështje, me të njëjtën akuzë, ndaj të njëjtëve persona të pandehur.

**65. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se:** *Subjekti ka shkelur parimin ne bis in idem, duke mos marrë vendimin për pushimin e procedimit penal, të nisur dhe të gjykuar më parë nga po e njëjta prokurori dhe gjykatë në lidhje me dy të akuzuarit, të cilët janë gjykuar dy herë për të njëjtën akuzë, të njëjtat fakte dhe të njëjtën vepër penale, në kundërshtim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 4 “E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë” të Protokollit nr. 7.*

**66. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë dëgjimore, duke sqaruar se:** Ky procedim penal është nisur mbi bazën e kallëzimit të shtetases R. K., regjistruar në datën 3.10.2017, ndërkohë që rreth 10 muaj më parë, një kallëzim i tillë ishte bërë në organin e akuzës nga shtetasi J. B., regjistruar në datën 15.12.2016, fakt për të cilin subjekti deklaroi se nuk ka pasur dijeni dhe zyra e regjistrimit të regjistrimit të procedimeve penale nuk e ka evidentuar në kohë dhe nuk e ka njoftuar. Subjekti shpjegoi se është vënë në dijeni të këtij fakti vetëm në përfundim të hetimeve dhe ka administruar edhe kopjen e fashikullit të procedimit penal të mëparshëm. Subjekti deklaroi se kishte prova të mjaftueshme për ta dërguar çështjen për gjykim, sikurse edhe prokurori paraardhës. Në seancë gjyqësore, në parashtrimin hyrës dhe kërkesat për provat, subjekti sqaroi se ka theksuar qëndrimin e tij në lidhje me faktin e pasjes së një vendimi gjyqësor të mëparshëm për të njëjtin fakt dhe të njëjtët persona për të cilët ishte dhënë pafajësi në shkallë të parë dhe çështja ishte ankimuar në Apel. Gjykata, pasi dëgjoi palët, vendosi gjykimin e çështjes dhe në përfundim të gjykimit deklaroi fajtor të pandehurin J. B. Aktualisht këto dy çështje janë për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**67.** Në Kodin e Procedurës Penale, neni 328, pika 1, shkronja “e” parashikon se pushimi i çështjes vendoset kur *me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale.* Në rastin konkret nuk kishte një vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, pra nuk janë cenuar në mënyrë thelbësore në fazën përkatëse procedurale të drejtat e të pandehurit dhe as dispozitat urdhëruese procedurale penale që kanë lidhje me vendimet e prokurorit. Gjatë shqyrtimit gjyqësor u provua fajësia e të pandehurit dhe u vendos deklarimi fajtor dhe dënimi i tij. Ligjvënësi, në nenin 474 të Kodit të Procedurës Penale, ka parashikuar ekzistencën dhe zgjidhjen e konfliktit kur ka disa vendime gjyqësore të dhëna për të njëjtin fakt, duke urdhëruar ekzekutimin e vendimit me të cilin është dhënë dënimi më i lehtë për të pandehurit dhe deklaruar të pazbatueshëm të tjerët. Në përfundim, subjekti deklaroi se deri në këtë fazë, vendimet e tij procedurale për këtë procedim janë mbështetur nga gjykata.

**68. Vlerësimi ligjor i Komisionit – lidhur me parimin *res judicata* (gjë e gjykuar)** Komisioni analizoi vendimin nr. 2, datë 3.11.2014, ku Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në qëndrimin unifikues se<sup>166</sup> në legjislacionin procedural penal shqiptar, me shprehjen “vendim i

---

<sup>166</sup> Në vendimet e saj GJEDNJ-ja citon shprehimisht se një vendim merr statusin e gjësë së gjykuar (*res judicata*) nëse palët: (i) kanë shteruar ankimet në rrugë të zakonshme; ose (ii) kanë humbur afatet për të paraqitur ankim kundër vendimit të dënimit, duke marrë kështu vendimi formë të përvokueshme. Më posaçërisht, në disa vendime kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja ka vendosur shprehimisht se, edhe nëse vendimi i gjykatës së apelit është i ekzekutueshëm, për sa kohë ekziston mundësia për ta apeluar në një gjykatë të një instance më të lartë siç është edhe Gjykata e Lartë, atëherë ai vendim [i gjykatë së apelit] nuk do të konsiderohet si

formës së prerë” do të kuptohet, sipas rastit, vendim që ka marrë formën e “gjësë së gjykuar” ose “vendim i ekzekutueshëm”; vendimi penal merr “formën e prerë” në kuptimin e “gjësë së gjykuar” kur: (i) Gjykata e Lartë disponon sipas neneve 433 ose 441 (1)(a), 441 (1)(b), 441 (1)(c), 441 (1)(d) të Kodit të Procedurës Penale; ose (ii) palët humbasin afatet e parashikuara në nenet 415 (1) dhe 435 (1) të Kodit të Procedurës Penale mbi paraqitjen e ankimit në gjykatën e apelit ose rekursit në Gjykatën e Lartë; në çdo rast tjetër me shprehjen “formë e prerë” do të kuptohet “vendimin e ekzekutueshëm” të gjykatave të apelit.

**69.** Sipas referencave në nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale, askush nuk mund të gjykohet rishtazi për të njëjtin fakt penal për të cilin është gjykuar me vendim të formë së prerë. Në rastin konkret, nga analizimi i fashikullit gjyqësor nuk rezultoi të jetë dhënë një vendim i formës së prerë, por rezultoi se subjekti ka dërguar përsëri për gjykim të njëjtën çështje, me të njëjtën akuzë, ndaj të njëjtëve persona të pandehur. Ndërkohë që, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në neni 4 “E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë” të Protokollit nr. 7, parashikon se ndalohej ndjekja ose gjykimi i një personi për një “vepër” të dytë, për sa kohë që kjo e fundit ka si zanafillë fakte të njëjta ose fakte që janë “në thelb” të njëjta me ato të veprës së parë<sup>167</sup>.

**70.** Sa më sipër u analizua, rezultoi se të akuzuarit/denoncuesit J. B. dhe I. G. janë gjykuar dy herë për të njëjtën akuzë, të njëjtat fakte dhe të njëjtën vepër, në shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. \*\*\*, i cili ka për objekt që ta ndalojë përsëritjen e procedimeve penale të përfunduara me vendim të formës së prerë.

**71.** Neni 4 i Protokollit nr. \*\*\*, e ndalon përsëritjen e procedimeve penale të përfunduara me vendim të formës së prerë. Ai sanksionon jo vetëm të drejtën për të mos u dënuar dy herë, por edhe të drejtën për të mos u ndjekur ose gjykuar dy herë. Ai zbatohet edhe atëherë kur ndjekja nuk ka përfunduar me një dënim (*Sergueï Zolotoukhine kundër Rusisë [DhM], f. 110-111*), lidhur me një shpallje pafajësie në përfundim të procedimit të dytë<sup>168</sup>.

Vlen të përmendet se ka përjashtime në paragrafin 2 të nenit 4, të cilat nuk e pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale në rast se fakte të reja ose të zbuluara

---

*res judicata*. Gjykata vlerëson se ky qëndrim i GJEDNJ-së ka mbetur i pandryshuar dhe është pjesë e praktikës së konsoliduar të asaj gjykate në lidhje me përcaktimin e shprehjes “gjë e gjykuar”. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë se shprehja “gjë e gjykuar” (*res judicata*) përkon me shprehjen “formë e prerë” e përdorur nga legjislacioni shqiptar, për vendimet që marrin këtë status në rastet kur: 1. Gjykata e Lartë disponon sipas neneve 433 ose 441 (1) (a), 441 (1) (b), 441 (1) (c), 441 (1) (d) të Kodit të Procedurës Penale; ose 2. Palët humbasin afatet e parashikuara në nenet 415(1) dhe 435(1) të Kodit të Procedurës Penale mbi paraqitjen e ankimit në gjykatën e apelit ose rekursit në Gjykatën e Lartë. Nga interpretimi i këtyre dispozitave kuptohet qartë se shprehja “formë e prerë” e përdorur nuk përkon me konceptin e gjësë së gjykuar, por me ekzekutueshmërinë e vendimit. Në fakt, një vendim i paankimuar në gjykatën e apelit ka marrë formën e prerë në kuptimin e “gjësë së gjykuar”, ndërsa një vendim i gjykatës së apelit, kundër të cilit ushtrohet rekurs brenda afatit të 30 ditëve ka marrë formën e prerë në kuptimin e “ekzekutimit të tij”. Kjo “kontradiktë” në dukje e shprehjes “formë e prerë” lidhet, në kuptimin e Kolegjeve të Bashkuara, me vetë zgjedhjen e ligjvënësit, i cili ka parashikuar se një vendim dënimi mund të vihet në ekzekutim pa marrë ky i fundit domosdoshmërisht statusin *res judicata*. Vendimi i gjykatës së apelit është i ekzekutueshëm, por nuk përbën gjë të gjykuar. E thënë ndryshe, çdo vendim dënimi që është gjë e gjykuar është gjithnjë i ekzekutueshëm, por jo anasjelltas, pasi jo çdo vendim i ekzekutueshëm është gjë e gjykuar.

<sup>167</sup> Sergueï Zolotoukhine kundër Rusisë [DhM], f. 79-82.

<sup>168</sup> Neni 4 i Protokollit nr. 7 nuk e ndalon që të kryhen paralelisht disa procedime të njëkohshme (*litis pendens*). Në një rast të tillë, nuk mund të pretendohet që paditësi të jetë ndjekur disa herë “për arsye të një veprë për të cilën ai tashmë është shpallur i pafajshëm apo dënuar me një vendim të formës së prerë” (*Garaudy k. Francës (vend. pran.)*). Gjithashtu, nga pikëpamja e Konventës nuk është ndonjë gjë problematike që, në rastin e dy procedimeve të njëkohshme, nga i dyti të hiqet dorë pasi ka marrë formë të prerë vendimi që e mbyll të parin (*Zigarella k. Italisë (vend. pran.)*). Mirëpo, në qoftë se nuk hiqet dorë nga procedimi i dytë, Gjykata del në përfundimin se ka pasur përsëritje të ndjekjes e, për këtë arsye, shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 7 (*Tomasović k. Kroacisë, fq. 29-32, Muslija k. Bosnjë-Hercegovinës, fq. 36-37, Nykänen k. Finlandës, fq. 47-54, Glantz k. Finlandës, f. 57-64*).

rishtazi apo mangësi themelore në procedurën e mëparshme që janë të një natyre të tillë që mund ta cenojnë vendimin e dhënë<sup>169</sup>. Vetëm nëse dy vepra të veçanta mbështeten tek fakte identike ose tek fakte që në thelb janë të njëjtat, ka të bëjë me shkelje.

**72. Në përfundim,** Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shkelur parimin *ne bis in idem*, duke mos marrë vendimin për pushimin e procedimit penal, të nisur dhe të gjykuar më parë nga po e njëjta prokurori dhe gjykatë në lidhje me dy të akuzuarit, të cilët janë gjykuar dy herë për të njëjtën akuzë, të njëjtat fakte dhe të njëjtën vepër penale, në kundërshtim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 4 “E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë” të Protokollit nr. 7.

**73. Trupi gjykues vlerëson se** konstatimet e bëra për këtë çështje nuk përbëjnë shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por qasja e subjektit dhe arsyetimi i tij në vendimin e dhënë do të konsiderohet nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

- v. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 6.5.2022, i shtetasit Z. C., i cili e akuzon subjektin e rivlerësimit për korrupsion dhe dhënien e një vendimi të padrejtë.

*Rrethanat e faktit* – shtetasi Z. C. kallëzon se në muajin maj të vitit 2016, shtetasi G. N. i ka kërkuar bono privatizimi dhe në këmbim do t’i ofronte 2-3 apartamente banimi (në varësi të shumës) nëpërmjet shoqërisë “\*\*\*\*”. Bonot do të konvertoheshin me 30% të vlerës së tyre. Kallëzuesi pretendon se me gjithë premtimet për kthimin e shumave të mësipërme të bonove të privatizimit apo dhënien e apartamenteve të premtuara, shtetasi G. N. nuk i ka kthyer shumën prej 109.800.000 lekësh<sup>170</sup> dhe ndjehet i mashtruar gjithashtu nga ndërtuesi V. I. dhe noterja A. K.

**74. Në vendimin e tij,** subjekti deklaron se vepra penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, parashikon: *“Përvetësimi i pasurisë private ose publike nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme ose duke fshehur fakte të vërteta, gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit, për vetë ose persona të tjerë, përbën veprën penale të mashttrimit dhe dënohet...”*. Pra, është pikërisht përdorimi i gënjeshtërs dhe i shpërdorimit të besimit, mjete për të hedhur në dorë pasurinë e tjetrit si elementi kryesor që e dallon krimin e mashttrimit nga krimet e tjera kundër pasurisë apo marrëdhëniet juridiko-civile. Rasti konkret ka të bëjë me një marrëdhënie kontraktore midis palëve të kryera në formë noteriale. Marrëdhënia e krijuar midis palëve të mësipërme (deklarata noteriale), duke qenë një akt që përmban detyrime në para, është titull ekzekutiv dhe, si e tillë, është e natyrës juridiko-civile. Palët, bazuar në nenin 510/d të Kodit Civil, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes duhet t’i drejtohen Gjykatës (dhoma civile). Edhe mosmarrëveshjet e lindura në lidhje me kontratat e shitjes janë të natyrës juridiko-civile dhe, si të tilla, në bazë të nenit 705 e në

<sup>169</sup> Neni 4 i Protokollit nr. 7 bën një dallim të qartë midis ndjekjes ose gjykimit rishit të një personi, përçapje kjo e ndaluar nga paragrafi i parë dhe rihapjes së procesit në rrethana të jashtëzakonshme, masë kjo e parashikuar në paragrafin e dytë, ku parashtrohet shprehimisht mundësia që një individ duhet të përgjigjet përsëri për të njëjtat akuza, në përputhje me të drejtën e brendshme, në qoftë se një çështje rihapet si pasojë e daljes së fakteve të reja apo e zbulimit të një mangësie themelore në procedurën e mëparshme.

<sup>170</sup> Shtetasi Z. C. i ka dhënë shtetasit G. N. shumat sa vijon me anë të deklaratave noteriale respektive: nr. \*\*\*, datë 1.7.2016, shuma prej 5.000.000 lekësh; nr. \*\*\*, datë 8.7.2016, shuma 85.200.000 lekë bono privatizimi; nr. \*\*\*, datë 2.9.2016, shuma prej 17.000.000 lekësh bono; nr. \*\*\*, datë 31.12.2016, shuma prej 107.200.000 lekësh bono privatizimi (kanë rënë dakord që kjo shumë do të kthehet me këste deri më 31.1.2017); nr. \*\*\*, datë 17.4.2018, shuma prej 5.600.00 lekësh bono privatizimi (të cilat do t’ia kthente brenda 10 ditëve nga momenti i nënshkrimit të kësaj deklarate).

vijim të Kodit Civil, për zgjidhjen e tyre palët duhet t'i drejtohen gjykatës civile. Në rrethanat e mësipërme nuk krijohet bindja se në momentin e lidhjes së kontratave të ketë ekzistuar elementi psikologjik i anës subjektive në lidhje me veprën penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, nuk rezulton të ndodhet përpara elementeve të figurës së veprës penale “mashttrim”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Sa rezulton, subjekti e ka pushuar çështjen me anë të vendimit datë 4.11.2019.

**75.** Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti ka ndërmarrë këto veprime hetimore: të pyetet kallëzuesi Z. C.; të pyetet shtetasi G. N.; të pyetet shtetasi V. I.; nëse është e nevojshme të kryen ballafaqimet e mundshme midis palëve të mësipërme; të kryhen të gjitha veprimet e tjera që do të caktojë dinamika e hetimit. Çështja penale është regjistruar në datën 1.1.2019 dhe vendimi është dhënë në datën 14.11.2019, ndërkohë nuk rezulton të jetë marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimeve, referuar në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale. Komisioni vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.12.2019, ka vendosur kthimin e akteve të çështjes për vazhdimin e hetimeve.

**76. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me** veprimet e mëtejshme hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit pas kthimit të akteve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.12.2019.

**77. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë dëgjimore, duke sqaruar se** ky procedim penal është regjistruar në datën 1.1.2019 dhe në regjistër nuk është shënuar emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale sipas nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas nenit 323/1 të Kodit të Procedurës Penale, afati i përfundimit të hetimeve paraprake fillon pikërisht me regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale dhe nuk kërkohet zgjatja e afatit të hetimeve. Me kërkesën e datës 14.11.2019, është kërkuar në gjykatë pushimi i hetimeve të këtij procedimi penal. Gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, ka vendosur kthimin e akteve organit procedues për vazhdimin e hetimeve. Kundër vendimit të mësipërm është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Deri aktualisht nuk është vënë në dijeni të marrjes së ndonjë vendimi nga ana e kësaj gjykate. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti një kopje të vendimit dhe ankimit në Gjykatën e Apelit.

**78. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – referuar provave të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit paraprak, rezultoi e provuar se në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk është shënuar emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale sipas nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, bazuar në nenin 323/1 të Kodit të Procedurës Penale, afati i përfundimit të hetimeve paraprake fillon pikërisht me regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale. *Sa rezulton*, kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

vi. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2022, i shtetasve K. dhe L. M., të cilët ngrenë pretendime ndaj subjektit e rivlerësimit për favorizim të palës së pandehur, me qëllim lehtësimin e akuzës për veprën penale të vrasjes së djalit të denoncuesve.

*Rrethanat e faktit* – në datën 14.12.2021, rreth orës 00:20, në lokalin “\*\*\*\*”, në rrugën “\*\*\*\*”, është vrarë me armë zjarri shtetasi J. D. (M.). Viktima ka hyrë në market i shoqëruar edhe nga një person

tjetër i identifikuar me emrin O. D., i cili menjëherë pas vrasjes është larguar nga vendi i ngjarjes dhe nuk ka njoftuar në organet policore. Nga ana e organeve policore, pasi është bërë identifikimi i këtij shtetasi është bërë arrestimi i tij.

**79.** Subjekti, në vendimin e tij, arsyeton se akti i ekspertimi ka provuar shkencërisht gjendjen e tronditjes së fortë psikike që është shkaktuar si rezultat i dhunës dhe i fjalëve të rënda nga ana e viktimës. Në rastin e të pandehurit A. S. është provuar qartë dhuna fizike, në kuptim të dispozitës së nenit 82 të Kodit Penal, dhe ka pasur fyerje të rëndë, që kanë prekur thellë ndjenjën e dinjitetit njerëzor të të pandehurit. Nga akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor rezulton se shtetasi A. S., në momentin e kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet, ka qenë me vetëdije plotësisht të errësuar, ka qenë në gjendje të pamundur për të kontrolluar veprimet e tij dhe për të vlerësuar pasojat. Sa rezulton, subjekti ka konkluduar se i pandehuri A. S., duke qenë në gjendje të tronditjes së fortë psikike të çastit shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë e padrejtë e viktimës, ka vrarë me armën e zjarrit, të cilën e mbante me leje, shtetasin J. D., duke konsumuar në këtë mënyrë elementet e figurës së veprës penale “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”, të parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal dhe i pandehuri O. D., duke moskallëzuar në organet e ndjekjes penale një krim që është kryer, ka konsumuar elementet e figurës së veprës penale “moskallëzim i krimit”, të parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal.

**80.** Nga shqyrtimi fashikullit hetimor, Komisioni vëren se në datën 14.12.2021, subjekti ka regjistruar në ngarkim të të pandehurit A. S. veprat penale “vrasje me dashje” dhe “mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, si dhe ndaj të pandehurit O. D. veprën penale “moskallëzim i krimit”.<sup>171</sup> Në datën 14.6.2022, subjekti ka bërë ndryshimin e cilësimit të veprës penale në atë të “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje në seancë gjyqësore, gjykata ka ftuar prokurorin që të bënte korrigjimet lidhur me cilësimin e akuzës, duke e akuzuar të pandehurin A. S. për veprën penale “vrasje me dashje” e parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal në kombinim me nenin 48/b të Kodit Penal. Nga ana e subjektit u parashtrua se nuk është për ndryshimin e akuzës, duke qenë se prokurori i qëndroi kërkesës së tij, edhe pasi u ftua nga ana e gjykatës për të bërë korrigjimet dhe saktësimet e nevojshme në lidhje me akuzën. Në këto kushte, bazuar në nenin 332/d/3 të Kodit të Procedurës Penale<sup>172</sup>, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin nr.\*\*\*, datë 14.11.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorit, kthimin e akteve prokurorit duke urdhëruar të formulojë akuzën për veprën penale “vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, si dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes për këtë vepër penale.

**81.** Nga hetimi i Komisioni rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të vendimit nr.\*\*\*, datë 30.12.2021, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, për autorin e veprës penale A. S. Ekzekutimi i këtij vendimi është bërë i mundur vetëm në datën 1.3.2022. Vlen

<sup>171</sup> Në datën 14.3.2022, subjekti ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimit me tre muaj deri në datën 14.6.2022, duke arsyetuar se janë një sërë veprimesh hetimore për t’u kryer. Në datën 14.6.2022, subjekti përsëri ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të hetimit me një muaj, deri në datën 14.7.2022, duke analizuar veprimet hetimore që duhen të kryhen (pyetja e autorit të veprës penale, si dhe njohja me aktet dhe përfundimin e hetimeve në ngarkim të tij).

<sup>172</sup> Në bazë të nenit 332/d/ 3 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin parashikohet se: “...Kur gatë seancës paraprahe del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar ose kur akuzat nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t’i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë”.

të përmendet se i pandehuri qëndronte i fshehur dhe është vetëdorëzuar vetëm pas rreth tre muajsh e gjysmë nga ngjarja e ndodhur. Fakt i cili nuk është konsideruar nga ana e subjektit gjatë shqyrtimit dhe analizimit të kësaj çështjeje penale.

**82. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se:** *Ndryshimi i cilësimit të veprës penale ndikon dukshëm në masën e dënimit të parashikuar ndaj të pandehurit, pasi vepra penale “vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet, ndërkohë që “vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike”, të parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal dënohet me burgim deri në 8 vjet. Subjektit gjithashtu iu kërkuan shpjegime lidhur me formulimin e akuzës së veprës penale të kryer nga i pandehuri A. S., sipas urdhërimeve të gjykatës.*

**83. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë dëgjimore, duke sqaruar se në analizë të provave të administruara gjatë procedimit rezultoi se viktimja ka qenë në gjendje të dehur dhe nën ndikimin e lëndëve narkotike (kokainë), duke kryer veprime të dhunshme dhe një agresion të papritur e të pajustificuar. Nuk ka asnjë lloj njohje të mëparshme me viktimën, motivi i vetëm i vrasjes është afekti fiziologjik i shkaktuar nga dhuna dhe fyerja e rëndë e nderit dhe dinjitetit dhe, nën këtë afekt, ai merr një vendim të aty për atyshëm për të kryer vrasjen në çast. Me dhunë fizike, në kuptim të nenit 82 të Kodit Penal, kuptohet: *goditja, rrahja, shtytja, plagosja, kërcënimi serioz se do të përdoret dhunë fizike aty për aty, kërcënimi për vrasje, për plagosje etj.* Me fyerje të rëndë kuptohen: *fjalët poshtëruese dhe veprime të personit, të cilat janë veçanërisht fyese për nderin e dinjitetin e personit dhe, si rrjedhojë, e prekjës së nderit e dinjitetit personal, fyerja për nderin e nënës, gruas, motrës, personi pëson afektin fiziologjik dhe në këtë gjendje kryen vrasjen.* Të dyja këto elemente, dhuna dhe fyerja e rëndë janë të pranishme në rastin konkret. Subjekti deklaroi se do të ndodheshin përpara elementeve të figurës së veprës penale “vrasje me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, vetëm në rast se sulmi do të kishte përfunduar dhe i pandehuri ka kuptuar se nuk ka rrezik, por megjithëkëtë ai kryen vrasjen, (qëllon). Në përfundim, subjekti deklaroi se ndryshimi i akuzës është bërë pas një hetimi shterues, administrimit dhe analizimit të provave, me objektivitet, profesionalizëm dhe korrektësi, aspak për të ndikuar në favor të të pandehurit.**

**84. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – referuar jurisprudencës së Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, e cila, pasi analizon elementet që duhet të plotësojë tronditja psikike për të qenë rrethanë cilësuese e figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal, në lidhje me shkakun provokues të veprimtarisë vdekjeprurëse, dhunën ose fyerjen e rëndë nga ana e viktimës, shprehet se si e tillë nuk mund të konsiderohet “çdolloj dhune apo fyerje, por rast pas rasti, si dhe duke pasur parasysh çfarë konsiderohet fyerje e rëndë nga një njeri mesatar”.

Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin nr. \*\*\*, datë 14.11.2022, ka arsyetuar se fyerje si ato që viktimja i ka drejtuar autorit nuk i konsideron të përshtatshme për të shkaktuar tronditje të fortë psikike që errëson në shkallë të tillë vetëdijen dhe aftësinë e personit për të kontrolluar veprimet e veta sa dikton sjelljen e tij. Tronditja psikike që ka pësuar i pandehuri në rastin konkret, do të duhet të konsiderohet e tillë që përkon me tronditjen psikike si rrethanë lehtësuese, sipas shkronjës “b” të nenit 48 të Kodit Penal.



**85. Komisioni vëren se** subjekti, në prapësime dhe në seancë gjyqësore, nuk paraqiti shpjegime apo prova lidhur me formulimin e akuzës së veprës penale të kryer nga i pandehuri A. S., sipas urdhërimeve të gjykatës. *Sa rezulton*, qasja e subjektit dhe arsyetimi i tij në ndryshimin e cilësimit të veprës penale do të konsiderohet nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

vii. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2023, i shtetasit M. P., i cili e akuzon subjektin për fillimin e paligjshëm të procedimit penal nr. \*\*\*/2021, në ngarkim të shtetasit K. D.

**86.** Ky denoncim është paraqitur në Komision pas dërgimit të rezultateve të hetimit paraprak dhe kalimit të barrës së provës. Në këto kushte, trupi gjykues, me anë të *email*-it datë 18.5.2023, ora 14:29, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit, duke i vënë në dispozicion materialin e administruar dhe duke e ftuar të japë shpjegime në seancë dëgjimore lidhur me pretendimet që ngrihen në këtë denoncim.

**87. Rrethanat e faktit** – shtetasi S. R. ka bërë kallëzim në Komisariatin nr. \*\*\*, Tiranë, ndaj të pandehurit K. D., pasi në datën 12.12.2020, ndërsa bashkëshortja e tij F. R. po qarkullonte me automjet në afërsi të kryqëzimit “\*\*\*”, është goditur nga mbrapa nga automjeti i drejtuar nga i pandehuri K. D. Si rezultat i përplasjes, automjeti kishte pësuar dëmtime në anën e pasme të tij. Në këtë moment është afruar një punonjës policie i qarkullimit rrugor, mirëpo palët ndërgjyqëse i kanë komunikuar që problemin do ta zgjidhnin me marrëveshje midis tyre. I pandehuri kishte pranuar të dëmshpërblente të dëmtuarit për rregullimin e automjetit dhe për këtë kishin shkëmbyer numrat e telefonave. Duke qenë se kishin kaluar disa ditë dhe i pandehuri nuk i ishte përgjigjur thirrjeve të kallëzuesit për dëmshpërblimin e dëmeve, ka bërë kallëzim penal.

**88.** Më tej, nga deklarimet e të pandehurit, të kallëzuesit S. R., si dhe të bashkëshortes së këtij të fundit F. R., rezulton që i pandehuri, në datën 6.1.2021, i ka dëmshpërblyer për dëmtimin e automjetit nga ana e tij. Ndërkohë që subjekti ka vazhduar hetimet, ka marrë provat shkresore, janë pyetur personat që kanë pasur dijeni për veprën penale, është pyetur i dyshuari, etj. Pas marrjes së këtyre provave, organi i Prokurorisë ka krijuar bindjen se shtetasi K. D. është larguar nga vendi i aksidentit, pasi në bazë të nenit 187/1/2 të Kodit Rrugor, i pandehuri kishte detyrimin të njoftonte policinë rrugore për kryerjen e veprimeve dhe administrimin e dokumentuar të ngjarjes. Në arsyetimin e vendimit subjekti ka argumentuar se i pandehuri ka konsumuar plotësisht elementet e kësaj vepre penale duke e akuzuar për veprën penale “largim nga vendi i aksidentit”, të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal.

**89. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij dhe prova në seancë dëgjimore, duke sqaruar se** kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*/2021 është pranuar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, plotëson të gjitha elementet e vlefshmërisë së saj, ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës, hetimet janë të plota dhe nuk janë konstatuar akte të pavlefshme apo të papërdorshme. Në cilësinë e provës, gjithashtu, subjekti paraqiti vendimin nr. \*\*\* akti, datë 6.3.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, si dhe njoftimet për pjesëmarrje në seancën e gjykimit të çështjes penale me nr. \*\*\* me të pandehur shtetasin K. D.

**90. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – referuar provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancë gjyqësore, rezultoi se Gjykata së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 6.3.2023, ka pranuar kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes me të pandehur K. D., i akuzuar për veprën penale “largim nga vendi i aksidentit”, të parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal. Lidhur me pretendimet që ngrihen në denoncim, Komisioni vëren se në arsyetimin e saj gjykata shprehet se kjo çështje nuk mund të pushohet në seancën paraprake, pasi nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga nenet 332/dh dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale. Në cilësinë e provës, gjithashtu, subjekti paraqiti vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, si dhe njoftimet për pjesëmarrje në seancën e gjykimit të çështjes penale me nr. \*\*\* me të pandehur shtetasin K. D.

**91. Në përfundim**, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të dërguara, Komisioni vlerëson se subjekti ka shpjeguar bindshëm vendimmarrjen e tij, sa rezulton, kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

### **Në përfundim të rivlerësimit të aftësive profesionale**

**92.** Bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me anë të kriterit të aftësisë profesionale të prokurorit vlerësohet aftësia në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor<sup>173</sup>. Komisioni çmon aftësitë profesionale pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

**93.** Sa më sipër, pas analizimit të denoncimeve të mësipërme, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se në disa nga denoncimet e trajtuara ka problematika, të cilat lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, por, duke marrë në konsideratë: (i) numrin e çështjeve të analizuar ku janë konstatuar mangësi në aspektin e aftësive profesionale në raport me kohën e gjatë të ushtrimit të profesionit; (ii) mangësitë e konstatuara si më lart nuk janë të një niveli të tillë që të konsiderohen serioze dhe as të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme për njohuritë profesionale; (iii) nuk rezultoi ndonjë rrethanë apo fakt mbi të cilat të provohej qëllimi i këtyre problematikave; (iv) kërkesat e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59, i cili përcakton se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet: [...] kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale [...] – vlerëson se problematikat e rezultuara në rivlerësimin e aftësive profesionale, të përshkruara më lart në arsyetimin e këtij vendimi, nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr.

---

<sup>173</sup> Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **KONKLuzion PËRFUNDIMTAR**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit çmon se subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, të cilat të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**Në përfundim**, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit Petrit Hysa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Petrit Hysa, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 24.5.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
Kryesuese

**Etleda ÇIFTJA**  
Relatore

**Olsi KOMICI**  
Anëtar

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*